

Zbulohet nga Lucia Nadin dhe Aurel Plasari teksti i dorëshkruar në latinisht *Libërth fort-i-shkurtër i Luftës së Shkodrës (De Bello Scodrensi brevissimus libellus)* të Marin Barletit (rr. 1450- rr. 1512)

NJË DËSHMI DOKUMENTARE E VYER DHE VENDIMTARE

Nga Matteo Mandalà



**SUKSESE PANAIRIT
XXV TË LIBRIT
NË TIRANË
(16-20 NËNTOR)**

SHËNIME MBI LIBRAT

“VJESHTA E PATRIARKUT” - NJË
MREKULLI E MUNGUAR
E LETËRSISË MARKEZIANE
NË SHQIP

Nga Arben Veselaj (fq. 4)

Sprovë leximore në hartën e maleve poetike të
Kristoffer Leandoeri-t

MALI SI NDODHI DHE NJERIU SI
KOHA PËRBALLË NDODHISË

Nga Alisa Velaj (fq. 9)

DHIMITËR KAMARDA, PËR NJË
SHQIPE “TË GJITHAKUSHME
EDHE TË GJITHAKUNDME” & TË
TJERA VEPËRZA

Nga Anila Omari (fq. 10)

Studimi “Poezia e Kosovës në tri kontekste” i autores
Mimoza Hasani Pllana

STUDIMET PËR POEZINË
SHQIPE NË KUADËR TË
STUDIMEVE BALLKANIKE

Prof. Dr. Ekaterina Tarpomanova (fq. 12)

Romani “Gryka e kohës: Nji histori mbulue me shall” e
Migjen Kelmendit

“GRYKA...” E MIGJENIT

Nga Adil Olluri (fq. 13)



PËRKTHIMI SI AKT LIRIE

Nga Ermira Xhomaqi-Godo

Kjo vepër e Victor Hugo-së kushtuar Shekspir, vjen në shqip për herë të parë. Vjen si një amanet e një dëshirë e fundit e tim gjyshi, si një akt lirie më shumë se letërsi. Ajo shënon në dy rrafshë konvergjente kohën dhe realitetin e pamundshëm në të cilin u realizua dorëshkrimi i këtij përkthimi e mbi të gjitha përzgjedhjen kuptimplote të tij, prej një intelektual vizionar të mbrujtur me etjen për liri, me dëshirën e arratisjes prej një bote të prangosur, duke i dhënë kuptim fillit të shprehjes së një të vërtete e cila mori udhë mes atyre ditëve që jetonte, e të tjerave që Abdulla Rami kish lënë pas në internimin e tij... (fq. 5)

LASGUSH PORADECI
SI ETNOGRAF I MUZIKËS,
RASTI I KËNGËVE TË USTA
ISUF MYZYRIT (fq. 6)
Nga Akademik Vasil S. Tole



HARUKI
MURAKAMI
Romancierët janë bujarë me
shkrimtarët e rinj (fq. 22)

BIBLIOTEKË

- Besnik Mustafaj (fq. 18)
Fajtori
- Ridvan Dibra (fq. 15)
*Histori të thjeshta,
krejt të thjeshta*
- Shkëlqim Çela (fq. 14)
Hotel Bahnhof
- Ndue Ukaj (fq. 16)
Retë prej drite
- Josif Papagjoni (fq. 19)
Hije në shtratin e mortit
- Ardian Vehbiu (fq. 17)
Qortimet e zotit Shyti
- Ag Apolloni (fq. 20)
Kësulkuqja
- Rexhep Qosja (fq. 21)
Sfinga e gjallë
- Ferit Lamaj (fq. 11)
Satira dhe Sarkazma Kadareane

BOTOHET NË SPANJË ROMANI
“VAJZAT E MJEGULLËS”
I NAMIK DOKLES (fq. 19)

Zbulohet nga Lucia Nadin dhe Aurel Plasari teksti i dorëshkruar në latinisht *Libërth fort-i-shkurtër i Luftës së Shkodrës (De Bello Scodrensi brevissimus libellus)* të Marin Barletit (rr. 1450- rr. 1512)

NJË DËSHMI DOKUMENTARE E VYER DHE VENDIMTARE

Nga Matteo Mandalà



Gjetja e një vepre që mbahej e humbur, ose së cilës as që i dihej ekzistimi, është ngjarje që përbën shkak kënaqësie të madhe jo vetëm për atë që e ka promovuar, por edhe për shumë të tjerë, në veçanti për studiuesit që tanimë do të mund të shfrytëzojnë të dhëna të siguruar nga zbulimi i ri. Me zbulimin e tekstit të dorëshkruar në latinisht *Libërth fort-i-shkurtër i Luftës së Shkodrës (De Bello Scodrensi brevissimus libellus)* të Marin Barletit (rr. 1450- rr. 1512) në Departamentin e dorëshkrimeve të Bibliotekës kombëtare të Francës, Paris, ka përfutur padyshim historia e kulturës historiografike shqiptare duke u pasuruar me një dëshmi dokumentare të vyer dhe, sikurse do të thuhet, vendimtare.

Lajmi për zbulimin që bërë i ditur qysh më 2018, kur Lucia Nadin dhe Aurel Plasari dhanë një njoftim publik paraprak duke zgjedhur për këtë rast një përkim tejmase domethënës: Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut në 550-vjetorin e ndarjes nga jeta të heroit kombëtar shqiptar, i cili pati për jetëshkrues të parë e më të rëndësishëm pikërisht Marin Barletin.

Me këtë punim dhe botimin anastatik të dorëshkrimit në fjalë kurorëzohet me sukses faza nistore e një projekti studimi të cilit, sikurse do të kuptohet, i është dashur të kapërcejë jo pak vështirësi para se të mbërrijë këtë arritje me vlerë të veçantë shkencore. Nga kjo pikëpamje, nëse nuk është e tepërt të saktësohet që suksesi i kërkimit nuk ka qenë aspak i rastit, është me vend të vihet në dukje, nga ana tjetër, se ai duhet të konsiderohet si përfundimi fatlum i një rrugëtimi të gjatë e të mundimshëm, në shtratin e të cilit puqen së toku hulumtimet erudito-bibliografike të kryera në mënyrë të pavarur nga dy protagonistët e shquar të zbulimit. Aftësitë dhe kompetencat e tyre, jo të zakonshme e madje mjaft të vlerësuara, si dhe njohja e tyre solide e temave dhe problemeve kryesore historiografike të periudhës më të trazuar të historisë civile dhe kulturore shqiptare, ofrojnë një provë të mëtejshme në të mirë të sukseseve që studimet albanologjike, nëse përsëriten në bazë të këtij modeli, do të ishte e dëshirueshme të arrijnë në të ardhmen.

Ky libër, që në fakt vetëm në rend kohor është dëshmia e fundit e raportit të konsoliduar profesional e miqësor mes Lucia Nadin dhe Aurel Plasarit, konfigurohet nga njëra anë si një vërtetim i qartë i dobive që bashkëpunimi shkencor i siguron përparimit të dijes albanologjike dhe, nga ana tjetër, shërben si paradigmë pluridisiplinore prej së cilës brezat e rinj të studiuesve do të mund të përfitojnë duke gjetur në të zbatime të rrepta heuristike dhe me besueshmëri të sigurt metodologjike. Jo më kot këtyre të fundit u është lënë nga autorët "barra" për ta vijuar studimin e *Luftës së Shkodrës* duke u përkujdesur për botimin kritik të tekstit dhe për një përkthim të tij të mundshëm në shqip.

Gjetja e vendndodhjes së veprës në dorëshkrim të Barletit, po thoshim, nuk ka qenë e lehtë dhe, madje, ka përbërë të parën sfidë të fortë që i detyroi dy studiuesit t'i vihen një analize të rrasët kritike të dokumentimit që kishin për duarsh. Duhej kapur filli i lëmshit të ngatërruar të referimeve në akte dokumentare private dhe të citimeve bibliografike. Duheshin përzgjedhur dhe ndarë në mënyrë kritike informacionet

e larmishme, ndonjëherë kontradiktore e ndonjëherë të pështjelluara, dhënë në momente të ndryshme historike dhe larg njëri-tjetrit. Njëpërmjet këtij procesi mund të mbërrihet tek arsyet të cilat, në vend që ta lehtësonin gjetjen e dorëshkrimit, prodhuan hipoteza të pabaza ose shpunë në shtigje të gabuara derisa të shkaktonin harresën për të ardhur keq të zgjatur gjer në ditët tona, si edhe pamundësinë e një rishikimi historik sa të nevojshëm, aq edhe të ngutshëm të çështjes.

Do të mjaftonin këto arsye për të pohuar që nxjerrja në dritë e *Luftës së Shkodrës* është për bashkësinë e historianëve shkas vlerësimi: duke davaritur mjegullën e dendur që, në mënyrë të pabesueshme, e pati mbështjellë veprën në fjalë, Nadini dhe Plasari ia dolën të ngjiten te zanafillat e interpretimeve të diskutueshme, të cilat tanimë pa frikë zhgënjimi mund të cilësohen të gabuara. Fjala është për tezën e një vargu historianësh të djeshëm e të sotëm që, ndonjëherë duke u bazuar në sugjerime të çastit dhe të tjera herë në vlerësime të pambështetura prej dokumentimit të nevojshëm, jo vetëm pati hedhur dyshime mbi origjinalitetin

dhe autenticitetin e të parit punim historiografik që Barleti dërgoi në shtyp me titullin *Rrethimi i Shkodrës (De obsidione scodrensi)*, por edhe e pati trajtuar me ndërdyshje identitetin, profilin intelektual si studiues dhe integritetin moral të vetë historianit, duke mbërritur deri te vënia në dyshim e rolit të tij prej dëshmitari syptomës të fakteve të ndodhura gjatë rrethimit të mirënjohur të Shkodrës.

Pa dashur të ripërshtojmë argumentet që autorët e librit parashtrajnë me të dhëna të shumta, është rasti t'i kushtohet vëmendje një çështjeje me rëndësi të veçantë filologjike, që ka qenë rrahur për një kohë të gjatë dhe që tanimë *Lufta e Shkodrës* ndihmon të zgjidhet në mënyrë përfundimtare. Sikurse dihet, në qendër të asaj që mund të quhet *querelle* lidhur me figurën dhe veprën e Barletit kanë qenë një numër përkimesh tekstuale, sa objektive edhe të veçanta, mes *Rrethimit të Shkodrës* dhe *Panegjirikut* që shkodrani Marin Beçikemi (rr. 1470 - 1526), i së njëjtës kohë me bashkëqytetarin e tij ndonëse disa vite më i ri, ia doli ta botonte dy herësh radhazi: së pari në shtypshkronjën e Angelo Britannico-s nga Breshia, pa datim dhe me gjasë i gjysmës së dytë të 1504-s,- në mos edhe i 1505-s siç të bëjnë të mendosh datat përfund dy letrave përkushtuese të vendosura në fund të librit, - dhe së dyti më 1506, kësaj radhe në shtypshkronjën e Bernardino de Vitalit, botues me prejardhje shqiptare që pati fatin të botonte edhe dy veprat kryesore të Barletit. Pasiguria për datën e botimit të parë të *Panegjirikut* ka pas qenë bërë pengesë filologjike e pakapërcyeshme aq sa, në orvatje e sipër t'u gjetur një shpjegim të pëlqyeshëm "huazimeve tekstuale", sikundër i përcaktoi historiani Francisc Pall në një sprovë të tij rinore të mirënjohur, që e nevojshme të mëtohej me ngulm se hartimi i *Panegjirikut* të qenkësh kryer në një ndërkohë para botimit të *Rrethimit të Shkodrës* që, sikundër dihet, u krye më 10 janar 1504. E gjitha buronte nga bindja paragjyquese se një personalitet si ai i Beçikemit, emërmadh mes humanistëve të kohës së tij falë një karriere të shquar



akademike dhe punimeve retorike të vlerësuara mbi tekstet latine, në asnjë mënyrë nuk mund të ishte ai që të kishte kryer në veprën e tij “huazime tekstuale” nga Barleti. Kështu historianit rumun dhe ndjekësve të tij iu desh t’ia atribuonin Barletit përgjegjësinë e “huazimeve”. Duke mos u zgatur këtu me analizën e rindërtimit nga Pall-i në të gjitha hollësitë e tij të koklavitura, është rasti të vihet në dukje se pikërisht te ky impostim deduktiv e ka burimin zgjidhja befasuese e problemit të datimit të veprës së Beçikemit: hartimi i saj u pasdatua më 1503, ndërsa shtypi i saj – e shumta – në fund të atij viti. Një hipotezë e tillë mbështetej vetëm tek ato pak përkime anësore mes *Panegjirikut* dhe një ligjërate që Beçikemi mbajti më 30 korrik 1503 para senatit të Breshias. Kaq u quajt e mjaftueshme për “të dëftuar” që vepra e Beçikemit i takonte me domosdo një ndërkohe para botimit të *Rrethimit*, duke ia cenuar kësajsoj autenticitetin kësaj vepre, dhe jo *Panegjirikut*.

Është ky një nga ato raste në të cilat parimi epistemologjik galileian, siç duket sheshit, tradhtohet nga pamundësia për të verifikuar hipotezat teorike me demonstrime objektive e të pakundërshtueshme, prej atyre që shkencëtari nga Piza do t’i kishte quajtur “të vënies në provë”, dhe që tani *Lufta e Shkodrës* e sapogjetur na i vë për duarsh duke na lejuar të përmbysim vlerësimet e gabuara të bëra tokicë me kalimin e kohës, të rivendosim të vërtetën e fakteve, të rindërtojmë një histori korrekte të traditës historiografike e, më në fund, t’i kthejmë Marin Barletit meritat që i takojnë.

Falë analizës së vëmendshme tekstuale, vënies në diskutim të referimeve ndërtekstuale dhe rindërtimit të kujdesshëm të kontekstit historik, Nadin dhe Plasari sqarojnë se dorëshkrimi i Barletit është hartuar vite më parë se botimi i hamenduar më 1503 i *Panegjirikut* të Beçikemit dhe, më saktësisht, mes dyvjetëshit 1498-1499 dhe 1501-shit, dy skajet *post* dhe *ante quem* që regjistrojnë, përkatësisht, vitet e acarimit të konflikteve mes Republikës së Venedikut dhe turqve, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër vdekjes së dogjës Agostino Barbarigo, të cilit *Lufta e Shkodrës* i kushtohet.

Barleti, sikurse saktësojnë dy studiuesit, me gjasë e shkroi veprën me synimin për t’i bërë thirrje Senatit të Republikës dhe dogjës së saj që të ngulmonin në politikën e qëndrës ndaj mësymjes osmane pikërisht në një ndërkohë kur Republika pësonte mundje të përsëritura në luftime. Teksti, që nuk mbërriti në shtyp, duhet të ketë pasur qarkullim të gjerë, siç e dëftojnë citimet e nxjerra nga studimi propedeutik i burimeve. Asgjë nuk e përjashton, madje mund të hamendohet me shumë të drejtë që Beçikemi, si shkodran i mirë, ta ketë pas lexuar dorëshkrimin dhe ta ketë përdorur atë sikurse u vu në dukje, duke ngjallur reagimin legjitim të Barletit që vendosi të botojë menjëherë, duke iu drejtuar shtypshkronjës, një version të ri të përditësuar të atij që kishte qenë në fillim *Libërth fort-i-shkurtër i Luftës së Shkodrës*.

Nuk ka dyshim që, nëse Francisc



Pall-i dhe studiues të tjerë me vlerë do të kishin pasur dijeni për këto të dhëna kontekstuale dhe, sidomos, nëse do të kishin pasur për duarsh dorëshkrimin parizian, gjykimet e tyre kritike do të kishin shpënë në të tjera hipoteza dhe, me siguri, drejtim krejt të ndryshëm do të kishte ndjekur orvatja e tyre – e lavdërueshme gjithsesi – për të rishkruar një faqe aq vendimtare të historisë së humanizmit shqiptar në tokë italiane. Lypset shtuar, në qoftë ende e nevojshme, se një konfirmim të plotë të autorësisë së të dyja veprave, përkatësisht *Luftës*

së *Shkodrës* dhe *Rrethimit të Shkodrës*, na e japin ballafaqimet tekstuale, të cilat në mënyrë paradigmatishtë davarisin edhe më të fundmet pasiguri duke i dhënë Marin Barletit meritën e padiskutueshme të themelimit të historiografisë shqiptare.

Figura e historianit humanist shkodran, e tillë siç është skicuar në kreun e dytë të këtij punimi, shfaqet jo vetëm e qartë dhe, për më shumë arsye, interesante, por edhe në simbiozë të përkryer me kontekstin historik dhe kulturor të Qytetit që e priti së

bashku me të tjerë mërgimtarë të shumtë shqiptarë dhe ballkanikë në ikje e sipër nga luftërat. Hulumtimet e hollësishme arkivore të kryera viteve të fundit nga Lucia Nadin dhe Aurel Plasari e kanë pasuruar njohjen tonë në një epokë historike të përshkuar prej shndërrimesh rrënjësore në kulturë, në ekonomi, në politikë, në marrëdhëniet mes popullsisë ndëradriatike. Venediku dhe territoret e tij jo vetëm i pranuan aleatët e tyre besnikë të detyruar t’i braktisnin qytetet e veta të rëna në duar armike, por ditën të zhvillojnë politika mirëpritjeje dhe të mbështesin sisteme të përparuara për integrimin e bërthamave të konsiderueshme të të huajve që banonin në to. Në ndryshim nga sa ndodhte në të njëjtën kohë në rajonet më jugore të Gadishullit italik, ku procesi i pakontrolluar migrator në grupe të dendura të mërguarish ballkanikë, shqiptarë më së shumti, përfundoi me një përzgjedhje formash dyndjeje në qendra të vogla rurale mesjetare të braktisura, forma që përcaktuan edhe një izolim të dallueshëm i cili e vonoi e pakta për rreth dy shekuj formimin e një elite intelektuale, në territoret e Republikës sistemimi i elementit të huaj shqiptar, ndonëse u përdor edhe për të populluar zona moçalore ose të pashëndetshme ose edhe për të përballuar sulmet osmane në kufijtë e Friulit, mundësoi formimin e një shtrese kulturorisht mjaft të gjallë, që ia doli të përfshihej e të merrte pjesë aktive në jetën civile, ekonomike, kulturore, madje edhe politike të Qytetit të madh lagunar.

Përgjatë shekullit që shkon nga themelimi i së njohurës si *Scuola degli Albanesi* (1442-1448) te botimi shqip i *Mesharit* të kryer nga Gjon Buzuku (1554/1555), në Venedik dhe territoret e tij bashkatdhetarët e Skënderbeut dëftuan një ndjenjë besnikërie e përkushtimi ndaj gjuhës së tyre, ndaj identitetit të tyre kulturor, ndaj atdheut të tyre, për fatet e të cilit nuk reshtën kurrë së interesuari. Qenë shumë ndër ta që kontribuuan për t’u mbajtur gjallë vëmendja ndaj atdheut të tyre të martirizuar, i cili për një çerek shekulli ia kishte dalë t’i vinte ledh ekspandimit turko-osman. Mes tyre qe edhe Marin Barleti, jeta e të cilit në mërgim u shenjua nga një ngjitje sociale dhe intelektuale e mundimshme, por e pandalshme: prej veprimtarisë rastësore tregtare të viteve të para te studimet e mëtejshme të përfunduara me dorëzimin priftëror dhe, më së fundi, te botimi i dy kryeveprave me vlerë të madhe historiografike që patën meritën e padiskutueshme t’i ngrenë një monument – *de imperitura memoria europea* – Qytetit të tij të lindjes dhe heroit të tij Skënderbe. Nga të dhënat e reja për jetën dhe për veprën e tij, të cilat i shtohen sot njohjes sonë të rikuperuara në mënyrë mjeshtërore, Barleti mund të konsiderohet tanimë pa mëdyshje prototipi madhor i intelektualit shqiptar militant që jetoi dhe veproi në kapërcyell të kalimit nga epoka e humanizmit të vonshëm në agimin e Rilindjes së parë. Këtë prototip na e ka ofruar të gjallë libri i këtushëm.

Hora e Arbëreshëvet,
korrik 2022



Pak javë më parë shtëpia e mirënjohur botuese, “Onufri”, e nxori nga botimi, për herë të parë në gjuhën shqipe, njërën nga kryeveprat e letërsisë së shekullit XX – romanin “Vjeshta e patriarkut” nga nobelisti kolumbian Gabriel García Márquez. Ardhja në shqip e kësaj kryevepre të letërsisë botërore është një kontribut i jashtëzakonshëm i përkthyeses dhe shkrimtares së mirënjohur Mira Meksi. “Lulja pirate e Gabos” (Mira Meksi) në një intervistë deklaroi se ideja për ta sjellë në shqip këtë roman-sintezë të letërsisë së realizmit magjik ishte sikur t’ia mësyje oqeanit në këmbë. “Me sa duket, ishte kryqi im”, - kishte deklaruar ajo.

Botimi në shqip i këtij romani paraqet vërtet një ngjarje kulturore për botën shqiptare. “Babai” i realizmit magjik, Gabriel García Márquez, ishte bërë pjesë e gjuhës shqipe shumë kohë më parë, me disa nga romanet e tij monumentale, si: “Njëqind vjet vetmi”, “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar”, “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë”, “Dashuria në kohërat e kolerës”, “Dymbëdhjetë tregime pelegrine” etj., por “Vjeshta e patriarkut” (që jo rrallëherë është konsideruar si romani më i arrirë i këtij autori) ka qenë, deri më tani, një hallkë e shkëputur në vargorin e letërsisë markeziene në gjuhën shqipe.

Po çfarë është ajo që këtë roman e bën shumë të vlerësuar, tash e më se 50 vjet?


“Vjeshta e patriarkut” rrëfen ngjarje të pabesueshme, fantastike, me parashenjë të qartë të një realizmi kritik, social, politik e historik. Shumë kritikë dhe studiues mendojnë se “Vjeshta e patriarkut” i përket tipit të ashtuquajtur “romani i ri historik”, por saga historike e këtij romani është dendur mirë në “vajrat” e realizmit magjik, ku realja (historikja dokumentare) shkrihet e bëhet një me të çuditshmen, e ndonjëherë edhe me të mrekullueshmen e me të mbinatyreshmen.

Struktura narrative e këtij romani është shumë komplekse. Rrjedha e ngjarjeve asnjëherë nuk mund të parashikohet. Lexuesi çdo herë befasohet me situata të reja, të papritura. Edhe pse shpesh e humbet fillin e rrëfimit, edhe pse zëri rrënimtar zhvendoset nga një gojë e një personazhi në tjetrën, edhe pse vija narrative po ashtu zhvendoset në kohë (në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen), leximi i kësaj proze atij ia mban frymën. Duke ua dhënë sharmin shqip “kolumbianizmave”, siç shprehet përkthyesja Meksi, mund të thuhet se kjo prozë e Gabos së madh erdhi së fundmi në shqip si një mrekulli e munguar.

Nga “shëllira” historiko-politike e Amerikës Latine, Márquez-i e ndërton botën e pështirë – një “Republikë” e vogël në Karaibe, ku një udhëheqës ushtarak (patriarku) krejtësisht i papenguar e ushtron dekadencën dhe egërsinë maçoiste mbi shtetasit

“VJESHTA E PATRIARKUT” - NJË MREKULLI E MUNGUAR E LETËRSISË MARKEZIANE NË SHQIP

Nga Arben Veselaj



e varfër. Në pjesën e parë të romanit Márquez-i e përshkruan pushtetin e “të pavdekshmit” – personazhit diktator, “Republika” e të cilit, edhe pasi rrënohet sërish përtërihet si pas një uragani, me tërë egërsinë dhe brutalitetin.

Ndonëse vendet dhe personazhet e këtij romani kryesisht janë imagjinare, në fakt në to fare lehtë identifikohen vende të vërteta dhe po ashtu edhe njerëz të vërtetë. Thuhet se gjenerali (personazhi diktator) i këtij romani është përfytyrimi real mbi ish-udhëheqësin kolumbian, Gustavo Rojas Pinilla, madje disa të tjerë këtë përfytyrim e çojnë edhe më tej – deri në Spanjë – te figura e diktatorit Franko.

Gabo na shfaq disa karaktere personazhesh imagjinare përmes të cilave i zhvillon temat e tij të preferuara, si: imperiumi (pushteti mbi jetën dhe mbi vdekjen), paranoja

(frika nga asgjëja), e deri te sindroma e “optimizmit të detyrueshëm” që i çon turmat në brohoritjeve.

Gjenerali i Márquez-it na shfaqet si një autokrat mizor, herë-herë me tipare të mbinjeriut, si një gjysmëzot, të cilin turmat e brohorasin deri në adhurim. Si një maço-burrë (lexo: maniak seksual) “Presidenti i Përjetshëm” shquhet sidomos për pushtetin mbi gratë e Republikës. Ai mban në robëri me qindra konkubina, po ashtu dhe fëmijë të panumërt të lindur nga “industria” e prostitucionit, të cilët nuk i honeps për pjellë të vet. S’ndien mëshirë e as turp kur gratë e botës i sulmon seksualisht në rrugë, në shtëpitë e tyre, kudo, sepse “pa lejen e tij nuk jeton askush në Republikë dhe se vetëm ai mund të shpërndajë lumturi për njerëzit e Republikës”. Nga rrëfimet e personazhes së çuditshme të romanit, Bendición Alvarado, lexuesi mëson se edhe vetë gjenerali

ishite fëmijë i lindur nga një akt i dhunimit seksual.

Bendición Alvarado, në fakt, është vetë nëna e gjeneralit, e cila, si pa të keq, zbulon anën e dobët dhe të ligë të “Udhëheqësit të Republikës”. Jeta dhe vdekja e personazhes, Bendición Alvarado, e dhënë në këtë roman përmes përshkrimesh simboliste, mund të thuhet se paraqet njërën nga tablotë tipike mbi personazhin e letërsisë së realizmit magjik (arketipin), themelues i të cilit është vetë Gabriel García Márquez-i. Kur vdes Bendición Alvarado, i biri – pra “Presidenti i Përjetshëm” – për nder të saj mban një funeral të paparë e të padëgjuar: organizon një eskortë shëtitëse disajvare me arkivolin e saj, duke shkuar fshat më fshat. Menjëherë pas ceremonisë së varrimit gjenerali kërkon nga autoritetet e kishës që t’ia nisnin papës në Romë një parashtrësë kanonizuese për shenjtërimin e saj, por kur përgjigja e papës vjen negative ai nxjerr urdhër për t’i mbyllur të gjitha kishat dhe vendos t’i dëbojë të gjithë priftërinjtë nga Republika.

Në gjysmën e dytë të romanit “Vjeshta e patriarkut” sikur ndizen motorët e “fantazisë markeziene”. Gjenerali i dikurshëm egërshan, të cilit nuk i shteronin dot fuqitë dhe pushteti, gradualisht dhe disi pahetueshëm i nënshtrohet një shpërfytyrimi grotesk. Me një mjeshtëri të pasqur Gabo sakaq e shndërron imazhin mitik të gjeneralit nga një maço-burrë autoritar, siç ishte, në një palo-plak për të cilin në shtëpinë presidenciale askush më s’çan kokën. Shpërfytyrimi që i ndodh “Presidentit të Përjetshëm” – prej një gjenerali udhëheqës me pushtet të pakufishëm, në një figurë groteske e qesharake, si pasojë e humbjes së fuqive fizike dhe mendore – është befasues. Po aq befasues është edhe përshkrimi simbolik i katandisjes së “Rendit të vjetër të Republikës”. Në një kthinë të shtëpisë presidenciale, ashtu siç dergjet në vetmi njeriu – adhurimi për të cilin ngrihej deri afër Zotit – dergjet për vdekje edhe rendi i vjetër politik. Kishte ardhur koha që bëmat e liga që kishte bërë ta vrisnin ngadalë. Dikur gjeneralin e plotfuqishëm – tani patriarkun matuf – e vrasin përnjëherësh të gjithë armiqtë e padukshëm: paranojat, tradhtitë, dyshimet, komplotet.

Mbase duke mos dashur që kësaj vepre t’ia vetatribuojë vlerat e vërteta kritike (të cilat i ka në të vërtetë), vetë autori, Gabriel García Márquez, këtë roman e kishte quajtur “një poemë mbi vetminë e pushtetit”. Sidoqoftë, përveç kënaqësisë estetike që na jep leximi i kësaj “poemë” të letërsisë së madhe (çfarë dhe është letërsia markeziene), romani “Vjeshta e patriarkut” trand lexuesin sidomos me nëntekstin (mesazhin) që shenjon në sfond, duke e fshikulluar pa mëshirë ndërgegjen historike e politike të Amerikës Latine, për mizoritë dhe diktaturat, të cilat i prodhoi me tepri përgjatë gjithë shekullit XX.

Kjo vepër e Victor Hugo-së kushtuar Shekspir, vjen në shqip për herë të parë. Vjen si një amanet e një dëshirë e fundit e tim gjyshi, si një akt liricë më shumë se letërsi. Ajo shënon në dy rrafsh konvergjent kohën dhe realitetin e pamundshëm në të cilin u realizua dorëshkrimi i këtij përkthimi e mbi të gjitha përzgjedhjen kuptimplote të tij, prej një intelektual vizionar të mbrujtur me etjen për liri, me dëshirën e arratisjes prej një bote të prangosur, duke i dhënë kuptim fillit të shprehjes së një të vërtete e cila mori udhë mes atyre ditëve që jetonte, e të tjerave që Abdulla Rami kish lënë pas në internimin e tij...

Dhe imagjinata më sjell përpara syve imazhin e atij burri në të 60-tat i cili ngrihej herët në mëngjes, kur të gjithë ende flinin, i paqtë, e i pazhurmët, zinte vend në tavolinën e drunjtë, ulur në një karrige të vjetër atje në fundin e dhomës, ai fillonte të shkruante nën dritën e feksur të agut, me frymën e shpresës së delirë, me ëndrrën e pritjes së një dite të re, me kujtimet e Montpëljesë në zemër, nën kërcitjen e llozeve a rënkimin e çelësave të qelisë struktur dikur në mendje, vazhdonte të përkthente Hygonë në ritualin e tij.

Dita i zbriste ngadalë ndër fletët e lidhura me fije spango dhe ai kujtohej se duhej të merrte saora shatin e të shkonte të hapte kanale e të prashiste në vreshta. Dhe nisej sërish me Hygonë në trastën e bukës, në mendje e në mendime, mbetur në fillin e një vegimi të cilit nga rraskapitja dhe lodhja e orëve të gjata, s'mundej t'ia kuptonte më kthjelltësinë.


Ky përkthim nisi në vitet e internimit të Ramit dhe dorëshkrimet e para të lëna prej tij u takojnë fundit të viteve '60, kur i sapo liruara nga burgu i Burrelit, dhe i detyruar të punojë në punë tejet të vështira, ai projektoi sjelljen në shqip të kësaj vepre. I dëbuar në Gosë të Kavajës, në një shtëpi të zbrazët, të zymtë e të trishtë, në pamundësinë totale të botimit apo edhe të deklarimit të kësaj pune, dorëshkrimet e tij u ruajtën prej vajzave të tij për vite e vite me radhë në një sënduk të vjetër prej druri dhe u rikopjuan tërësisht me shkrim dore nga teza ime e mirë. Është kjo një përpjekje shumëvjeçare për t'ju përcjellë pasardhësve jo vetëm një kryevepër të Hugo-it por edhe gjurmë e një pjese të shpirtit të tij, të cilat shënojnë arratisjen e një mendjeje drejt një bote të lirë, drejt një bote të munguar por të ëndërruar, shënojnë mundin e tij për të reflektuar veten në trajtën e fjalës së Hugo-së, si një varg dëshirash, idealesh e ëndrrash të pashprehura të cilat kërkojnë të mbijetojnë, të mos humbasin e të pulsojnë... Dhe pikërisht kështu të mund të mbetet ajo më e mira, më e vërteta, e ndoshta më e bukura e asaj kohe të trazuar e të vështirë.

Mërgimi i Hygoit dhe internimi i Ramit, këto dy realitete paralele të cilat në harkun kohor të 150 viteve ngjizën ardhjen e kësaj vepre fillimisht në frëngjisht e më pas në shqip, i japin kësaj vepre simbolikën e një homazhi të dyfishtë dhe e bëjnë atë të mbërrijë si një dhuratë e çmuar ardhur prej një nxënësi të Liceut Francez të Korçës, një studenti të Montpëljesë, një juristi të së drejtës kombëtare, një intelektual e avokati antikonformist, një burri qëndrestar e të palodhur të cilit, njëzet vitet më të shndritshmet të jetës së tij iu grabitën padrejtësisht. Vjen si një dhuratë falur atdheut e kombit të vet, me dëshirën e detyrën fisnike për t'ia shtuar thesarit të përkthimeve të shqipes, ndonëse shkruar mes dhimbjesh e pamundësish, kjo vepër mbart në çdo paragraf, në çdo fletë e në çdo kapitull diçka përtej reales, përtej materiales dhe letërsisë.

Të përkthesh Hugo-në me besim, me thjeshtësinë e ndershme dhe krenarinë

PËRKTHIMI SI AKT LIRIE

Nga Ermira Xhomaqi-Godo



entuziaste, duke u lëshuar i tëri mbi të, pa iu trembur asgjëje, pa anashkaluar e fshehur detajin, duke ia zhveshur mendimin deri në lakuriqësi, pa ia përdorur penën për të gënjer nën të, larg zbulimeve të panevojshme, e duke ia drejtuar çdo gërme, çdo fjale, çdo paragraf e fjalie pareshtur pyetjen: *Ajam prej tij, a jam e tij?* Pa u tkurrur përballë penës së këtij gjeniu e kësaj mendjeje kolosi, të pranohet sikur vetë Hugo të fliste në shqip, duke e derdhur në forma transparente mendjen dhe gjuhën e tij, të përkthehet frëngjishtja e vitit 1864, duke mos i vënë aspak maskën kirurgjikale përkthimit, e duke i mbetur besnik urnës së madhësisë së tij, e cila në këtë ese mbart njëkohësisht e të shtresëzuar krejt përkufizimin individualist e kolektiv të artit të angazhuar si thelb të demokracisë! Ç'ndërmarrje e bukur, por sa e vështirë!

Çfarë ndjesie të lexosh Hugo kur shkruan: *"Lajkatimi i popujve është më i keq se lajkatimi i mbretërve. Njëri është i ulët, tjetri është i poshtër... Jo, popujt s'kanë të drejtë t'ua hedhin gjithnjë fajin qeverive! Pranimi i shtypjes nga i shtypuri përfundon në bashkëfajësi... ka solidaritet të konsiderueshëm dhe turp të ndarë midis qeverisë që e bën të keqen dhe popullit i cili ia lejon atë. Vuajtja është për t'u nderuar, ndërsa nënshtrimi për t'u përbuzur. Viojmë."*

Vdekja e papritur e Abdulla Ramit, në 29 Janar 1973, nuk i dha atij mundësinë ta rishikonte dorëshkrimin, megjithëse edhe në hartimin fillestar të tij, ai transmeton qartazi, elementet thelbësorë të kësaj vepre-manifest,

rëzohesha në pafundësinë e proverbeve, anekdotave, lojërave të fjalëve, përmrave pronorë, prapashtesave, fleksioneve "-onjëse", etj, etj, pasi ky dorëshkrim ishte punuar përpara vitit 1973, domethënë përpara Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Dhe puna kërkonte sërish hulumtime, përfaqje në kohë, e përsëri reflektime, pse këto janë probleme të cilat padyshim i dalin përpara çdo përkthyesi, e bëhen edhe më komplekse pasi kjo vepër, përpos gjithçkaje, është një nga më të vështirat, e më filozofiket të Hugo-së. Arsye për të cilën një konsultim me kritikën franceze dhe një ripunim me versionin anglisht të saj m'u paraqit mjaft frytdhënës dhe produktiv. Rrafshi i këtyre dy gjuhëve nuk është i njëjtë: anglishtja është saksone, frëngjishtja është latine. Aksi i padukshëm i valëvitjes së reve në përkthim qëndron shpesh i pakapshëm në fjalinë frënge, dhe bota e ndjesisë anglosaksone i jep asaj, pa e shpërndarë e deformuar, një fllad qartësimi duke e integruar në mënyrë të rafinuar në frymën e shqipes. Sepse në fund të fundit çfarë është përkthyesi? Nëse është fjala për ta nderuar, - pak; nëse është fjala për ta persekutuar, - gjithçka. Ndaj të kesh lexuar Homerin nuk mjafton, duhet lexuar Jobi, të kesh lexuar Eskilin nuk mjafton, duhet lexuar Isaiu, të kesh lexuar Ezekjelin nuk mjafton, duhet lexuar Lukresi, të kesh lexuar Juvenalin nuk mjafton, duhet lexuar Tasiti; të kesh lexuar Pavlin nuk mjafton, duhet lexuar Jani, të kesh lexuar Danten nuk mjafton, duhet lexuar Rabële, të kesh lexuar Servantesin nuk mjafton, duhet lexuar Shekspiri, të kesh lexuar Shekspirin nuk mjafton, duhet lexuar Hugo, të kesh lexuar "Të mjerët", "Njeriu që qesh", «Katedralja Notre-Dame», "Viti 93"... nuk mjafton, duhet lexuar domosdoshmërisht "Uiliam Shekspiri"!

Të rrokësh gjeninë, të kapësh fillin e gjigantit është tronditëse. Një thirrje e hapur për luftë, një dëshirë e pamatë dhe sfiduese, pasi në duar ke jo vetëm dorëshkrimin e një përkthimi, por edhe një emër, një histori, një ndjesi, një përjetim. Hugo është kolos, Hugo është stoik, Hugo është i saktë e i përplotë, Hugo të ikën, Hugo të shpëton, Hugo në ekstazë të rrjedh si ai lumi i rrëmbyeshëm i emocioneve njerëzore që derdhet pafundësisht e vrullshëm në thellësinë e urnës së lotëve. Hugo duhet ndjekur... Për shkrimtarët viganë duhen lexues e përkthyes atletë... Hugo të tejmbush me idenë, me shprehjen e pamatë, me klithmën kumbuese të një Olimpiani, përmes stilit, përmes gjuhës, përmes kepave mes oqeanit, mes vetmive të flohta, mes hapësirave të errëta e plot silueta të papërcaktuara, mes vendeve të nxehta, të shndritshme e të zbehta; thurur mes hënës e diellit të tij, ku spikat jugun mes veriut, ditën mes natës; rrezon mes mjegullnajës, kuptimin metafizik, filozofik e politik, kundrejt atij historik e legjendar. E gjithë kjo përpjekje për të transmetuar në më të mirën e mundshme këtë manifest hygoian, ku nga fleta e parë e deri tek e fundit, mbi tastierën e kompjuterit, më mbetet gjithnjë e pranishme pesha e përgjegjësisë së madhe, si ajo mjeshtëria në farkëtimin e një çelësi të artë shkence, për të çelur portën e kësaj proze-poetike në gjuhën shqipe e mundësisht në nivelin e saj më të mirë.

E gjithmonë me besimin në zërin e heshtur të tim gjyshi, i cili në përzgjedhjen e kësaj vepre shfaq njëkohësisht mirënjohjen ndaj dy kombeve e dy gjenive: Francës me Hugo-në dhe Anglisë me Shekspirin; admirimin ndaj dy gjuhëve: asaj burimore tek e cila qëndron admirues e i ftuar, dhe asaj pritëse në të cilën banon dhe mbetet biri. Ky përkthim përcjell një mesazh të përshpirtshëm dhe hyjnor, mesazhin e një akti liricë, të një bashkëbisedimi në heshtje, midis dy kohëve, dy epokave, dy botëve, me dëshirën dhe punën e një Sfinksi, me guximin dhe vullnetin e përbashkët, sepse për ta sjellë këtë vepër të Victor Hugo-së në shqip, u deshën jo pak, por një gjysëm shekulli... dhe Tre Breza!

Paris, Janar 2022

filozofinë e saj, e cila, duke shpalosur një letërsi hygoiane krejtësisht të angazhuar, fshikullon mbarë mbështetësit e sistemeve diktatoriale e autoritare, diktatorët e tiranët, mbretërit e lakejtë e tyre. Kjo vepër është e vetmja ese dhe reflektim i Hugo-së mbi letërsinë.

"Uiliam Shekspir" shënon në rrjedhën e shekujve pikëtakimin e mendjeve më të ndritura me të vërtetën dhe historinë. Ndaj për të hyrë në botën hygoiane e në frymën e saj, të duhet një bibliotekë e tërë. Duhet shfletuar gjenitë e kohërave: nga Homeri, tek Jobi, nga Eskili, tek Isaiu, nga Ezekjeli, tek Lukresi e Juvenali, nga Tasiti, tek Pavli, Jani, e Dante, nga Rabëleja, tek Servantesi, e Shekspiri, duke përshkuar kritikë, botues, komentatorë, novela, romane, kronika, drama, komedia, mbarë veprat e tyre... Dorëshkrimi duhej plotësuar e përmblyllur. E kështu mbi bazën e tij, fillova punimin dhe redaktimin e çdo kapitull i cili është punuar disa herë mbi origjinalin në frëngjisht, e kompletuar me shpjegime dhe footnotes të nevojshme në zbardhjen e kuptimësisë së të plotë të tij, duke u bërë njësh me idenë e Ekos (Umberto Eco) se përkthimi është një "proces vendimesh e negociimi".

Puna ka qenë e vështirë, e lodhshme dhe thujse e frikshme... Në brendësi të këtij dorëshkrimi sa të koduar po aq edhe të ndriçuar ku shfaqej historia, filozofia, gjenia, shpirti, ringjallja, mbreti e mbretëria, ajo që prekja në duar ishte një thesar i brishtë, në aspektin brendatekstor të të cilit herë lëkundesha e vallëzoja në morinë e kohës së foljeve të cilat përplaseshin lirshëm në ndjeshmërinë e spektrit të shqipes, e herë pengohesha e gati

1 "Të thuash gati të njëjtë gjë" - Umberto Eco.

Dy botimet më të fundit me autor Lasgush Poradecin, "Vjersha (këngë) popullore grarishte Pogradec dhe të fshatit Dardhë, Korçë"- Vëllimi I dhe "Vjersha (këngë) popullore grarishte krahinash të ndryshme"- Vëllimi II, që të dyja me shënimin mbledhur prej gojës së popullit, të përgatitura nga Marie Gusho-Poradeci dhe të botuara nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, janë ngjarje e veçantë kulturore në vitin e 50-të jubilar të themelimit të Akademisë së Shkencave dhe të 35-vjetorit të ndarjes së Tij nga jeta. Rasti i mbledhjes së këngëve të Isuf Myzyrit (1881-1956) prej Lasgush Poradecit (1899-1987) është ndoshta procesi etnografik më i dokumentuar dhe më i strukturuar, që tregon se si Lasgush Poradeci, ky personalitet i jashtëzakonshëm i letërsisë shqiptare, ia doli të dokumentojë dhe të regjistrojë këtë trashëgimi muzikoletrare të mjeshtrit Isuf Myzyri, e cila sot bën pjesë në "Listën Kombëtare të Kryeveprave të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore", shpallur nga Ministria e Kulturës. Lasgushi e konsideronte me të drejtë traditën si "fuqinë e një kombi", e kësaj edhe për veten e tij si krijues ai thoshte "unë jam tradicionalist", pasi tradita për të ishte "fuqija shpirtërore dhe materiale e kombit".

Këngët e Usta Isuf Myzyrit² janë mbledhur drejtpërsëdrejti të kënduara nga goja e tij në 2 ditë shtatori të vitit 1940, përkatësisht në datat 26 dhe 29 shtator, kohë kur poeti Lasgush Poradeci qëndronte për kurim në "Banjat e Elbasanit", ose siç njihen edhe si "Llixhat e Elbasanit". Në shënimin hyrës, para paraqitjes së këtyre këngëve, gjendet teksti i mëposhtëm i bërë nga vetë Lasgushi: këngë të Isuf Myzyrit, vjershëtorit popullor elbasanas. Sot n'ja pesëdhjetë e tetëvjeçar, lindur në Elbasan. Të dëgjua prej gojës së tij. Isufi ishte bektashi. Është bërë myhyp para 26 vjetësh në teqen e Elbasanit prej Baba Ahmet Elbasanit, në teqenë e madhe të Elbasanit. I vëllaj i Baba Ahmetit është Baba Mustafaj-I teqesë së Elbasanit. Baba Mustafaj është gjysh³.

Vitet 1930 dhe fillimi i viteve 1940, kohë kur Lasgushi u mor intensivisht me mbledhjen e folklorit, ishin vite të rizgjimit të interesit publik e shtetëror për trashëgiminë kulturore dhe për shkencën albanologjike në veçanti. Me krijimin e Institutit të Studimeve Shqiptare⁴ në vitin 1940, institut i cili kishte si synim edhe botimin e përmbledhjeve të punimeve për folklorin, Lasgushi u bë një nga pjesëtarët kryesorë themelues të tij, së bashku me personalitete të tjera të artit dhe shkencës si Aleksandër Xhuvani, Ekrem bej Vlora, Eqrem Çabej, Ernest Koliqi, Odhise Paskali, Zef Valentini etj.

Në këtë kohë, e cila kishte zgjuar interesimin për trashëgiminë shpirtërore të shqiptarëve, botohet i pari libër i quajtur "Udhëheqësi i vogël për mbledhjen e Thesarit Folkloristik"⁵, nga folkloristi i shquar shqiptar i shek. XX Stavro Th. Frashëri (1900-1965), në të cilin një vend të veçantë zinte kujdesi që duhet treguar për mbledhjen e folklorit e posaçërisht të muzikës popullore shqiptare. Ky botim i parë në këtë fushë gërshtonte

1 Shih Poradeci Lasgush, "Vjersha (këngë) popullore grarishte krahinash të ndryshme", vëllimi II, Tiranë, 2022, f. 7. Libër i perifrastuar.

2 Për Usta Isuf Myzyrin shih: Ceka, H. "Usta Isuf Myzyri, muzikant i dëgjuar i Shqipërisë së Mesme", gaz. "Bashkimi", 1957, 12 korrik; Bebeti Mehmet, Shëngjerri Rrapush, "Luftëtar dhe këngëtar i lirisë", gaz. Shkumbini, 1982, 12 shtator; Filja Hysen, "Isuf Myzyri, krijues i njohur i këngës popullore", "Drita", 1986, 9 mars; Dedej Sulë, Balliçi Alfons, "Isuf Myzyri", Onufri, 1996; "Isuf Myzyri", broshurë, Elbasan; Shuteriqi Dhimitër, "Nga kënga e popullit", Tiranë, 1991; Poradeci Lasgush, "Vepra 3", Tiranë, 200; Meksi. Thanas, "Mjeshtër i këngës popullore", Elbasan, 2001 etj.

3 Po aty f. 497. Libër i cituar. Shënim i datës 26 shtator 1940.

4 Shih për më shumë "50 vjet Akademi e Shkencave e Shqipërisë", Tiranë, 2022, f. 15.

5 Botuar në tre numra radhazi të gazetës "Tomorri", më 18, 19, dhe 21 korrik të vitit 1942.

LASGUSH PORADECI

SI ETNOGRAFI I MUZIKËS,

RASTI I KËNGËVE TË USTA

ISUF MYZYRIT

Nga Akademik Vasil S. Tole



përvojën më të mirë të krijuar nga vetë autori në mbledhjen e folklorit, me atë të studiuesve të huaj. Eksponenti tjetër, Ai që Stavro Frashëri kërkonte "të lartësonte muzikën tonë në shkallën e merituar", ishte Lasgushi, i cili kishte vite që i kishte paraprirë reagimit shtetëror me mbledhjet e tij vetjake të folklorit, e që përmes personalitetit të tij tërhoqi vëmendjen e duhur ndaj trashëgimisë europiane të shqiptarëve pikërisht atëherë kur nuk bëhej fjalë për ekspedita të organizuara nga institucionet e specializuara ose ato arsimore të shtetit për ta mbledhur dhe dokumentuar atë.

Në thelb të tyre, dokumentimi i këngëve të Usta Isuf Myzyrit është një tekst etnografik, pasi etnografia nuk është gjë tjetër veçse të shkruash për njerëzit (nga greqishtja *ethnos*-popull dhe *graphien*-shkruaj). Dihet se etnografia, e posaçërisht ajo e muzikës, nuk përcaktohet përmes perspektivave apo linjave të tipit teorik. Më së shumti ajo lidhet me elementet përshkruese të muzikës, të cilat kalojnë nga shkrimi i thjeshtë i tingujve drejt mënyrës se si këta tinguj janë konceptuar, si janë realizuar, si janë kombinuar me fjalët, si janë vlerësuar dhe si ndikojnë mbi individë të tjerë, mbi grupet shoqërore, deri edhe te vetë proceset muzikore. Pra, etnografia e muzikës merret para së gjithash me mënyrën se si njerëzit bëjnë muzikë e për këtë arsye, shpesh, ajo mund të ngjasojë me analizimin e ngjarjeve, sesa thjesht me analizimin e tingujve muzikorë.

Për të kuptuar "etnografinë e muzikës" së Lasgush Poradecit, në ndihmë na vjen ditari i tij i cili është mjete i analizimit të ngjarjeve etnografike. Rithekojmë se këngët e Usta Isufit janë mbledhur që të gjitha gjatë kohës që Lasgushi qëndronte për pushime në "Banjat e Elbasanit", te të cilat u nis nga Poradeci në datën 16 shtator 1940⁶. Në datat 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24 shtator 1940, Lasgushi ndjek një procedurë standarde që përfshin kryerjen e banjave të sqfurit disa herë në ditë, ngrënien e drekës që zakonisht e konsumonte në natyrë pranë krojeve (kroi i Lindjes ose i Juglindjes, ose në mal nën drurë, ngrënien e zemërherës etj.). Në shënimin e datës 25 shtator 1940, e mërkurë, Lasgushi shkruan: ... *ardhi në Lixhë vjershëtorit-violinist popullor Isuf Myzyri nga Elbasani, u poq me mua (me qënë që siç më tha, nuk mundi të vijë vjet kur e thirra). Kish sjellë dhe violinë dhe i ra disa këngëve të tija*⁷. Në këtë shënim dalin qartë

6 Shënim nga ditari personal i Lasgush Poradecit. Aty shkruan: ... *sot u nisa prej Poradecit për në Banjat e Elbasanit. Vajta në nëna i putha dorën, po zemrën e kam të thyer që nuk jam ngopur as simvjet me nënë, (sepse simvjet ndenja fare pak, vetëm 6 javë). Vinja 2 herë në ditë të nëna, i bëra dhe gjithë mvshjet dhe hamjet që ka nevojë, po ajo simvjet ka rënë shumë dhe mua zemra m'u coptua. Zoti më faltë!*

7 Shënim nga ditari personal i Lasgush Poradecit.

dy elemente. Së pari, fakti që Usta Isufi⁸ i ka kënduar këngët të shoqëruara me violinë e në prezencë të Lasgushit e po ashtu, edhe interesi i Lasgushit për trashëgiminë muzikore të Usta Isufit, të paktën prej vitit 1939, kohë kur po në "Llixhat e Elbasanit", Lasgushi kishte mbledhur nga goja e Kíma (= Jaqim) Bueadân, nga Elbasani (aromën), dy nga këngët më të njohura të Usta Isufit: "Moj fullanxe moj mitare" dhe "Iku nata, agun malet". Këngën e dytë e kishte mbledhur si motërzim edhe nga një tjetër bartëse, zonja Shaqë Zef Llupi, nga Shkodra, po në Llixhat e Elbasanit, më 26 shtator 1939.

Në lidhje me takimin e parë nga afër me Usta Isufin, kemi edhe një shënim tjetër të Lasgushit, i shkruar pasi ata ishin takuar, i cili i bën akoma më të qarta synimet e tij: ... *Isuf Myzyrin nga Elbasani e kam takuar kur shkova njëherë në Llixhë. I dërgova të vinte të më takonte dhe më erdhi. Ishte veshur me brekushe të bardha, shumë të pastra. Ndenjmë e biseduam. Unë desha të di poezitë që bënte ai. Isuf Myzyri vetë i bënte fjalët e këngëve, vetë i këndonte dhe vetë i shoqëronte me violinë. Për atë kam shkruajtur dhe një artikull atëherë*⁹. Lasgushi e ndien dhe e di fare mirë se muziktarët si Myzyri kanë sjelljen dhe qasjen e tyre për atë që po ndodh gjatë takimit dhe interpretimit, i cili shoqërohet edhe me aspekte psikologjike e emotive, e për më tepër në kushtet kur ata, bartësit që intervistohen, nuk kanë dëshirë që të flasin për to.

E duke i ditur të gjitha këto, thelbi i interesimit të Lasgushit qartazi fokusohet në dy elemente të rëndësishme:

Nga buron aftësia krijuese muzikore e Usta Isufit?

Cili është roli i tij si pjesë dhe kontribues në traditën e madhe të muzikës popullore qytetare?

Në vitin 1940, Usta Isuf Myzyri ishte kryemjeshtri i muzikës qytetare të Elbasanit

8 Për Usta Isufin shih gjithashtu Minga Mikaela, "Tinguj që rrëfejnë, tinguj që rrëfehen", Tiranë, 2020, f. 163-165.

9 Shënim nga ditari personal i Lasgush Poradecit. Deri më tani nuk kemi mundur ta identifikojmë artikullin që Lasgushi përmend më sipër dhe as organin se ku mund të jetë botuar.

dhe një ndër mjeshtrit më të njohur të muzikës qytetare shqiptare. Ndikimi i muzikës së krijuar dhe interpretuar prej tij dhe orkestrinës së përbërë nga Mitat Stringa, Leksi Vini, Mustafa Bodini, Rustem Serica, Mahmut Ashiku, Arif Topalli, Met Balashi, Demir Shore, Ali Zena etj., i kishte kaluar kufijtë e qytetit të Elbasanit, për të shkuar në qytetet kryesore shqiptare e më tej, në Kosovë e Maqedoni. Ai kishte mundur që krijimtarinë e tij ta shndërronte në një gjuhë komunikimi mes njerëzve, pasi muzika popullore nuk mund të ekzistojë e ndarë nga krijuesi, interpretuesi dhe publiku i saj.

Dihet p.sh. se në vitet 1920-1930, një vend të posaçëm në formatimin e tipareve të këngës popullore qytetare të qytetit të Tiranës zunë lidhjet profesionale dhe miqësore të Usta Isuf Myzyrit me Tiranën dhe muziktarët popullorë të Tiranës¹⁰, miqësi e cila ka ndikuar fort në tiparet e muzikës popullore të kryeqytetit të ri të Shqipërisë. Një këngë popullore e ahengut tiranas e ka përjetuar këtë miqësi në vargje e melodi:

Po kënoj një kong të vjetër, për arshikët në Tiron,
i kujtojmë ne për gjith jetën, asihet s'do t'i harrojm.

Sa i bukur osht Uqini, lezetlliku osht m'Tiron,
e ka thon Mustafa Budini dhe Myzyri n'Elbason.

Nëpër kafe nër mihone, kongët tona tuj kenu,

Liu i Nushit me qemone, xhevahir që s'ka të ç'mu.

Vje Isufi prej Elbasoni, bon ahengun n'tabakhon¹¹,

10 Për më shumë shih Tole Vasil S, "Trashëgimia Shpirtërore e Tiranës në muzikë", Tiranë, 2020.

11 Dyqan i regjies dhe përpunimit të lëkurëve të kafshëve të buta dhe të egra. Sipas Dizdarit tabak, tabaku është ai që ka mjeshtëri të regjje lëkurë, lëkuraregjës. Te Dizdari Tahir, "Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe", Tiranë, 2005, fq. 978. Sipas Gazmend A. Baku, tabakhana konsiderohej edhe si "shtëpia e lëkurëve". Në Tiranë regjia e lëkurëve kryhej në vende ku kishte ujë, dhe bëhej pranë Lanës dhe Urës së

Me Bet Shyrben e Dull Dërhem, arshiket jon m' Tiron.

Në fotot që njohim nga Usta Isuf Myzyri, ai mbante në kokë një qeleshe tiranase, të cilat ishin më të lartat që mbaheshin në Shqipëri¹², dhe se ai ishte vetë një zanatçi që punonte qeleshe. Zanatin e qeleshexhiut-qeleshepunuesit ai e mësoi në Tiranë nga miku i tij Rexhep Murthi dhe e ushtronte atë paralelisht me muzikën, të cilën e kishte filluar rreth vitit 1905. Nuk është e tepërt të pohojmë se, Tirana ishte një nga qendrat kryesore për punimin e qelesheve¹³, ku ka dhe një grumbull zejtarësh që kët zanat e ushtrojnë pothuaj den-babaden¹⁴. Janë këto vitet të cilat e njohën atë në rrethet e artizanëve të Tiranës edhe si muzikant popullor¹⁵. Me të drejtë është pohuar nga studimet tona muzikologjike se krijimtaria e tij, e mbështetur në trashëgiminë e këngëve tradicionale elbasanase si dhe më gjerë, të Shqipërisë së Mesme, edhe pse mjaft personale është e mbrujtur fort me këtë traditë¹⁶.

Ditët kur Lasgushi ka dokumentuar këngët e Usta Isufit janë ato të 26 shtatorit 1940 (e enjte) dhe 29 shtatorit 1940 (e diel). Në ditarin e datës 26 shtator, Lasgushi shkruan: ... *hëngra drekë ne kroj i Jug-Perëndimit (krua në lloj pusi). Sot përpara dhe pas dreke shkroja 9 këngë të Isuf Myzyrit prej gojës së tij (në Lixhë)*¹⁷; dhe shënimi tjetër i datës 29 shtator, që thotë: ... *u fjalosa për herën e fundit me këngëtorin popullor Isuf Myzyri. Ardhi që në mëngjes (ora 7.30') në hotel "Park". Pasdreke shkoj në Elbasan*¹⁸.

Edhe pse nuk ka sqarime konkrete për këngët që ka mbledhur ditën e dytë, është e qartë se atë ditë janë mbledhur 5 këngët e tjera të tij. Pra, 14 këngët që gjithsej janë mbledhur drejtpërsëdrejti prej Usta Isuf Myzyrit, të cilat i gjejmë të publikuara në librat për të cilët po flasim, u përkasin 26 dhe 29 shtatorit të vitit 1940. Dimë se Lasgushi ka shkruar edhe herë të tjera në Elbasan apo edhe te *"Banjat e Elbasanit"*, por ai nuk është takuar më me Usta Isuf Myzyrin. Për këtë na ndihmon një tjetër shënim i bërë prej Lasgushit, ku rikonfirmohet se takimi i tij i fundit me të ishte ai i datës 29 shtator i vitit 1940. Lasgushi shkruan: ... *më vonë desha ta takoj përsëri. Shkova te kafeneja ku rrinte zakonisht. Pyeta - ishin ca pleq bektashinj. Ka kalue - më thanë. Shiko sa bukur! Nuk më thanë vdiq apo ka vdekur, por ka kalue d.m.th. ka kaluar në jetën tjetër. Isuf Myzyri ka kalue, por poezinë e tij e mbaj mend: Sevdaja në pleqëni S'asht memqym me u durue/ S'më besojn as miqt e mij/ Mjeri un si kam pësue*¹⁹.

14 këngët e mbledhura nga goja e Usta Isuf Myzyrit²⁰ janë ato me titujt: *"Ah më*

Tabakëve. Madje, e gjithë lagjia juglindore e Tiranës së atëhershme mori emrin Lagjia e Tabakëve. Shih *"Tirana e vjetër"*, Tiranë, 2014, f. 113-114. Studim i cituar.

12 Shih Gjergji Andromaqi, *"Veshjet popullore në rrethin e Tiranës"*, te *"Veshje Popullore Shqiptare"*, Volumi 3, Tiranë, 2004, fq. 80. Studim i cituar.

13 Qelesha është një kësulë e bardhë prej plisi, e punueme në vend, në forma të ndryshme sipas krahinave. Për llojet e qelesheve të përdorura në Tiranë shih Dizdari Tahir, *"Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe"*, Tiranë, 2005, fq. 793.

14 Sipas Dizdari Tahir, *"Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe"*, Tiranë, 2005, fq. 793. Studim i cituar.

15 Shih Dedej Sulë, Balliçi Alfons, *"Isuf Myzyri"*, ONUFRI, 1996, f. 12.

16 Koço Eno, *"Kënga lirike qytetare shqiptare në vitet 1930"*, Tiranë, 2002, f. 8. Studim i cituar.

17 Shënim nga ditari personal i Lasgush Poradecit.

18 Shënim nga ditari personal i Lasgush Poradecit.

19 Shënim nga ditari personal i Lasgush Poradecit.

20 Usta Isuf Myzyri lindi në Elbasan më 8 mars 1880 dhe vdiq po në Elbasan, më 21 tetor 1956. Mban titullin "Artist i Popullit" - pas vdekjes. Mjeshtër popullor i njohur gjithandej me emrin Usta. Krijues, këngëtar-tenor dhe interpret i shquar popullor në veglën e violinës, i gjysmës së parë të shek. XX. Në fëmijëri, Isuf Myzyri punoi në zanate të ndryshme. Martohet në moshë të re dhe ndahet pas disa vitesh. Tërë jetën e tij e kaloi së bashku me motrën e tij, dhe nuk u martua përsëri. Më 1905 formon formacionin e tij me vegla popullore të përbërë nga Simon Vela me çyr, Mahmut Ashiku me lahutë, Arif Çerma-Topalli me dajre, Thoma Prifti me gërnëtë, Mehmet Gurra me ud, Ibrahim Zaimin me çyr bishtëgjatë, Myrteza Gracenin dhe Riza Beratin me violinë. Megjithëse

paç në qaf që më vrave mu", "Iku nata, agun malet", "Si bilbili në pranverë", "Kënga e shokut t'im Ali Bilalit", "Nji lulisht me trandafila", "U dëshirush me të pa", "E paskim pas fatn e zi", "Kumrija bën gu-gu", "Spaske pas moj pik mëshire", "Dashënija si rrufe", "Përse më rri kaq vranu", "Errësin' e pyllit", "Ma mir në pyll se në qytet", dhe "Harap u bash un' i mjeri".

Të mbledhura prej një këngëtori dhe instrumentisti të vetëm siç ishte Usta Isufi, referuar Kurt Sachsit (një studiues i kualifikuar si në historinë e artit, ashtu edhe në historinë e muzikës), pohojmë se tipari mbizotërues i natyrës së këtyre mbledhjeve prej Lasgushit është dokumentimi i «stilit patogjenik», me origjinë në *"pasionin dhe impulset motorike"*, që ndjek relaksimim e energjisë së këngëtarit i cili pason çdo shpërthim të emocionit të fortë. Për këtë arsye, të gjitha këngët shoqërohen me sqarime të natyrës shpjeguese të historisë së krijimit të tyre dhe kujt i kushtohet kënga, të fjalëve të përdorura në to, të vitit kur ato janë krijuar si dhe të mënyrës se si vargjet e këtyre këngëve janë mbledhur. Dokumentimi i këngëve popullore mbledhur nga Lasgush Poradeci prej këndimit dhe interpretimit të Usta Isuf Myzyrit duket se do të shenjojë një precedent pozitiv në etnomuzikologjinë shqiptare. Edhe pse këto këngë janë mbledhur vetëm si vargje dhe jo si notizime, ky rast dëshmon se sa e rëndësishme është për vërtetësinë e procesit të dokumentimit që vargjet të mblidhen si të kënduara kur vijnë prej këngës, dhe si të folura kur vijnë prej rrëfimit. Duket se Lasgushi e ka pasur shumë të qartë këtë gjë,

veprimtarinë e tij si krijues "Usta Isufi" e filloi në moshë të madhe, në fillim të viteve 1920 Usta Isufi i njihet merita e ndërtimit të një repertori me këngë popullore elbasanase, ku spikatin bukuria e frazës muzikore si dhe orientimi për nga vlerat e vërteta të kulturës muzikore të Elbasanit. Për të mund të thuhet se i hoqi perçen e orientit muzikës qytetare të Elbasanit. Si besimtar bektashian, Usta Isufi ka kënduar edhe një pjesë të repertorit muzikor fetar të këtij besimi, në ndonjë rast të njohura edhe si këngët e ashikisë. Në vitin 1950 i jepet titulli *"Dervish nderi"* nga ana e Kryegjyshitës Botërore Bektashiane. Këngët e tij kanë kaluar gojë më gojë dhe nga njeri këngëtar në tjetrin jo vetëm në Elbasan, por në gjithë Shqipërinë, në Kosovë dhe te shqiptarët e Maqedonisë. Në vitin 1950, në qytetin e Elbasanit, formacioni muzikor i Usta Isufit ka regjistruar disa disqe me këngë popullore në një shtëpi diskografike të ish-Bashkimit Sovjetik. Më 31.08.1978 (pas vdekjes), i jepet titulli i lartë "Artist i Popullit", me motivacionin: *Si këngëtar popullor, ka dhënë një ndihmë të shquar në pasurimin dhe zhvillimin e këngëve folklorike. Një meritë të veçantë në grumbullimin dhe sistemin e krijimtarisë së Usta Isufit ka dhënë muzikarti elbasanas Mitat Mehmetali Stringa (Elbasan 1924 - Tiranë 14.11.1989). Emri i Isuf Myzyrit është përjetuar në Shtëpinë e Kulturës të Elbasanit. Traditën e mrekullueshme të krijuar nga Isuf Myzyri, pas viteve '50 e vazhduan këngëtarët të tjerë, pasues të tij si vëllezërit Zena, Albert Tafani, Agim Saliu, Mustafa Mehja etj. Një pjesë e madhe e këngëve të tij janë kënduar edhe nga këngëtarët lirikë shqiptarë si Tefta Tashko Koço, Marie Kraja etj.*

derisa thekson disa herë, duke filluar prej titullit të librit *"Vjersha (këngë) popullore... mbledhur prej gojës së popullit"*.


Para se Lasgushi të mblidhte trashëgiminë kulturore shpirtërore, mbledhje dhe botime të këngëve popullore duke filluar nga shek. XVIII kanë bërë Reinholdi, Hani, Pukëvili, Dozoni, Mitkoja, Hekardi, Basile, Camarda, Crispi, Staffa, Biondelli, Schiroi, De Rada etj. Gjithashtu, një lëndë të pasur do të gjejmë edhe në veprat e para të letërsisë së vjetër shqipe duke filluar me Buzukun, Budin, Bogdanin, Frang Bardhin, Marin Barletin etj. Pas tyre ishte Mitko e më pas françeskanët, që kishin hedhur hapat e parë edhe për botimin e mbledhjeve të folklorit. Ajo që ndryshon te Lasgushi në raport me ta është pikërisht informacioni plotësues-shtesë e i detajuar që ai sjell sa u përket rrethanave të mbledhjes së materialeve burimore folklorike, gjë të cilën e gjejmë akoma më të konkretizuar te mbledhjet me nota të folklorit muzikor mbarëshqiptar, si te *"Lyra"*²¹ e Pjetër Dungut-1940 dhe ato të folklorit muzikor shkodoran që Gjon Kujxhia²² transkriptoi dhe botoi në Itali, në vitin 1943. Vdekja e parakohshme e Kujxhisë i ndërpreu:.....*planet guximtare me mbledhë e komentue folklorin muzikuer shqiptar dhe m'e shfrytëzue në krijesa origjinale ku të ndihej fryma autoktone*²³, ndër to edhe punën e pambaruar "Hengu Shkodran", të cilin autori e la në dorëshkrim.

Janë me shumë interes shënime plotësuese të bëra prej Lasgushit për rrethanat se si këngët e Usta Isufit u krijuan, për shpjegimet e fjalëve, e sidomos për kohën e krijimit të këngëve. P.sh. për këngën shumë të njohur "Si bilbili në pranverë" shkruan se *"kjo këngë ka nja 13 vjet që është bërë"*; për këngën "Ah më paç më qaf që më vrave mu" shkruan se *"Isuf Myzyri ia ka vënë edhe melodinë vetë dhe mund të ketë qenë nja 14-15 vjeç"*; për "Kënga e shokut tim Ali Bilalit" shkruan se *"ka nja pesë vjet që e ka bërë, në parëverë"*; për "Nji lulisht me trandafila" thotë *"mund të ketë nja 4-5 vjet që e ka bërë"*; për këngën "U dëshirush për me të pa" dhe "E paskim pas fatn e zi" shkruan se *"nuk mban mend kur e ka bërë"*; për këngën "Kumrija bën gu-gu"

21 Në vitin 1940, kompozitorit Pjetër Dingu i përket merita kryesore e botimit të parë me nota të muzikës popullore shqiptare. Botimi i tij *"Lyra shqiptare"* përmbledhte 50 këngë popullore shqiptare, ndër to: 19 këngë popullore shkodorane, 15 korçare, 7 kosovare, 5 beratase, 2 elbasanase, 1 vlonjate dhe 1 durrsake.

22 Për më shumë shih *"Gjon Kolë Kujxhia "një ilir i ndezun"*, Tiranë, 2018.

23 Shih Koliqi Ernest, *"Vepra 6"*, Prishtinë, 2003, f. 535. Studim i cit.



pohon se *"e ka bërë para 4,5, ose 3 vjetësh"*; për këngën "S'paske pas moj pik mëshire" nuk ka informacion për kohën e krijimit; për këngën "Dashënija si rrufe" pohon se *"ka nja 7-8 vjet që e bëri"*; për këngën "Përse më rri kaq vranu" - *"mund të ketë nja 10-12 vjet që e ka bërë"*; për këngën "Errësin' e pyllit" - *"krijuar para 5-6 vjetësh"*; për kryekëngën "Ma mir në pyll se në qytet" shkruan *"bërë para tre vjetësh"* dhe për këngën "Harap u bash un' i mjeri" bën shënimin *"Këtë vjershë e ka bërë simvjet, 1940. Nuk e di asnjëri tjetër, vetë shoku Aliu e ka dëgjuar një herë. Vetëm një herë, por Aliu nuk e di me gojë"*.

I theksuam sa më sipër pasi koha e krijimit të këngëve ka shumë rëndësi, sepse përmes njohjes së saj kuptojmë shpejtësinë e përhapjes si dhe zonën e përhapjes së tyre. Këtë fenomen e ka konstatuar edhe Eqrem bej Vlora kur shkruante:... *del një këngë, poeti dhe kompozitori i saj në më të shumtën mbeten anonim, ndonjë nga këngëtarët e pëlqyera e benë të njohur dhe atëhere, këndohet e këndohet pa pushim*²⁴. Pasi njihesh me këto dy volume të mbledhjeve folklorike prej tij, bëhet shumë e qartë situata sa i përket vendit që zë krijimtaria popullore dhe ndikimi i saj në gjuhën e tij poetike. Në jetën e tij Lasgushi pati kontakte dhe bëri përpjekje të rëndësishme për të njohur e më pas studiuar trashëgiminë kulturore shpirtërore të popullit. Në dy botimet për të cilat po flasim, gjejmë trashëgimi shpirtërore nga e gjithë Shqipëria: nga Labëria, Toskëria e Gegëria, polifoni me iso e njëzërësh, këngë lahute e këngë çiftelie, folklor muzikor qytetar dhe folklor muzikor të fshatit etj. Ai, qysh fëmijë, u mësua me këngët dhe vartet e vendlindjes, jo më kot një pjesë e bajeve të dokumentuar janë pjesëtarë të ngushtë të familjes së tij. Më pas, në periudhën e studimeve në Athinë, bie në kontakt me librin e A. Kulluriotit me vjersha, fabula e rrëfime të mbledhura nga goja e popullit, i botuar më 1882. Vite më pas, studimi i tij i doktoraturës *"Mihal Eminesku, lidhja e tij me filozofinë popullore"* (1933), ishte një qasje madhore e shkencore e Lasgushit mbi rëndësinë e folklorit te krijuesi, rasti i Emineskut, e jo vetëm për të.

I pari që theksoi rëndësinë e Lasgushit si poet ishte Eqrem Çabej, dhe këtë e bëri përmes një shkrimi që mbarte brenda një thirrje: *"Djalëri shqiptare, lexo Lasgushin dhe vdis"*. Po në këtë shkrim të botuar më 1929, disa vite përpara se Lasgushi të botonte vëllimet e tij poetike, Çabej bëri pohimin emblemantik se stili i Lasgushit ndryshon nga shkrimi i një Naimi a Fishte si, bie fjala, një pjesë mozartiane nga një pjesë beethoveniane²⁵. Më 1933 botohet VALLJA E YJEVE në Kostancë të Rumanisë dhe më 1937, "Ylli i zemrës" në Bukuresht. Këto dy vëllime kryesore të krijimtarisë së tij janë shkruar e botuar në dhjetëvjeçarim që përfshin vitet 1930-1940, kohë kur Lasgushi ishte tërësisht i fokusuar edhe si mbledhës folklori, gjë e cila është konstatuar edhe në studimet e tjera kushtuar veprës së tij, kur pohohet se: ... *arti i Lasgushit ushqehet nga disa burime. Imagjinata e lindur dhe pasioni i ndezur u fuqizuan nga kultura e gjerë dhe arti popullor. Arti popullor nuk erdhi në poezinë e tij si një material i përpunuar, por si element strukturor i rëndësishëm. Kështu poezia e tij nisi të tradita më e mirë e letërsisë sonë popullore, te folklori i Jugut*²⁶, se ... *një numër i konsiderueshëm i poezive të Lasgushit ka një strukturë që përgjithësisht na kujton strukturën e këngëve popullore*²⁷, etj. Fjala në poezinë e Lasgush Poradecit, me mënyrën

24 Cituar nga Dervishi Fatbardh, "Muzika popullore e qytetit muze të Beratit", Berat, 2011, f. 35.

25 Çabej, Eqrem, "Mbi poezinë e Lasgush Poradecit", tek "Gazeta e re", 23 shkurt 1929, f. 3.

26 Poradeci Lasgush, "Vepra letrare", Tiranë, 1990, f. 37. Hyrje e cituar.


27 Matoshi, Hysen, "Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane", Prishtinë, 2000, f. 139. Libër i cituar.

e veçantë të formimit dhe përdorimit, ka peshë të madhe e cilësi të rralla. Në të, ashtu si harmonizohet mendimi me bukurinë, harmonizohet edhe shqetësimi i brendshëm me qetësinë e jashtëm, tingulli me ritmin. *Muzikaliteti i saj është i pandarë nga atributet e tjera*¹; apo ... *aktivizimi melodik dhe muzikor i interpunkcionit*² si dhe ... *muzikaliteti i vargjeve të Lasgush Poradecit ... nuk mund të jetë i pavarur nga fondi i poezisë, madje ai përbën një kusht parësor të vlerës poetike*³.

Lasgushi, përveçse një poet i dorës së parë, një shkencëtar i historisë së gjuhës dhe letërsisë kishte një formim dhe afinitet të veçantë për muzikën. Në djalëri, në liceun rumun të Manastirit i binte flautit, ndërsa kur shkoi në liceun francez, në Athinë, mësoi të luante në klarinetë⁴, duke qenë edhe pjesëtar i orkestrës së shkollës. Dimë se kur ishte në Bukuresht, pas vitit 1920, ndoqi për 6 muaj konservatorin e muzikës dhe se kishte formuar dije thelbësore për historinë e muzikës e për lëndët teknike të saj, si për solfezhin, harmoninë e polifoninë. Pas kthimit nga Graci, Austri në Shqipëri, dimë se solli me vete një klarinetë në sib⁵ me të cilën ushtrohej rregullisht në kopshtet e jeshiluara të Pogradecit. Një provë më shumë për formimin muzikor të Lasgushit është edhe një dorëshkrim muzikor i tij që përmban një këngë në notizim, me fjalë e muzikë të krijuar prej tij.

Nga ana tjetër, në vitet 1930 ai kishte shkruar vargjet më të bukura për disa këngë e romanca të cilat ishin muzikuar nga kompozitorët e kohës, miq të tij, si Kristo Kono (1907-1991), që shkroi muzikën e "*Kur m'u rite vogëloshë*" dhe "*E mora shoqezën për kra*"; "*Marshi i djalërisë*" kompozuar nga Dhimitër Mihaillesku-Toskani në Rumani; "*Kroi i fshatit tonë*", "*Të ritit e viteve të mi*", "*Fryni veriu në Mal-të-thatë*", "*Foli nëna me vajtim*", "*Ku shtrohet vala përmi zall*", melodi të krijuara prej shokut të tij, Eftim (Miçe) Kovaçit etj. Sipas Lasgushit: ... *këto 5 poezi të muzikuara prej Miçe Kovaçit që ish një artist-baritor shumë idealist korçar dhe një atdhetar shumë idealist rilindas bukureshtjan, i pat kënduar gjithnjë në koncertet e saj personale që jipte në Tiranë, Korçë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe qytete të tjera të Shqipërisë, sopranoja lirike, e famëshmjja Tefta Tashko, e akompanuar në piano prej Lola Aleksit*⁶.

Duke u përpjekur të kuptojmë se përse Lasgushi mbetet një figurë ideale si etnograf i muzikës, na duhet të ritheskojmë talentin dhe formimin e tij të veçantë jo vetëm si poet, por dhe aftësinë e tij në kuptimin dhe zbrërthimin e gjuhës muzikore, pasazhe të mrekullueshme të të cilave i gjejmë në korrespondencën e tij me këngëtarët tona të njohura dhe me kompozitorin Kristo Kono. P.sh., në letrën⁷ e vitit 1931 drejtuar sopranos Jorgjije Truja, ai i drejtohet asaj si "*këngëtarja shqiptare gryk ergjëndi*" dhe "*zëri me vala të florinjta*", ndërkohë që me këngëtarën Tefta Tashko Koço kishte vendosur marrëdhënie profesionale të ngushta, kishte shkruar dhe përkthyer disa materiale sipas kërkesave të saj, ndër to tekstin e "*Serenatës*" së Franc Shubertit, "*Pensee d'automne*" të Jules Massenit etj. Në korrespondencën e vitit 1937 me Tefta Tashko Koçon, ajo ndër të tjera i kërkon Lasgushit "*zgjatimin e këngës popullore shqiptare "Kur më vjen burri nga*



stani

⁸, si dhe i pohon faktin se "*do të jetë e para herë që do më epet rasti të këndoj fjalët e një poeti shqiptar që gjithë atdheu ynë e njeh dhe admiron talentin e tij*". Nga kjo pjesëz e shkëputur nga letra, kuptojmë shumë si për raportin e Lasgushit me këngët popullore e po ashtu procesin e ndikimit të saj në krijimtarinë e tij poetike të atyre viteve.

Në një tjetër letër, tashmë drejtuar kompozitorit Kristo Kono¹⁰, Lasgushi përshfaqet si muzikolog i thekur në analizën që i bën romancës së Konos "*E mora shoqezën për kra*", mbi poezinë e tij. Ai shkruan: ... *i ke dhënë Kono muzikës shumë fond poetik dhe një stil të kulluar, të drejtuar me serenitet përmes kadencave të ndryshme dhe modulacioneve të variuara të saj. E kuptoj mendimin t'ënd, temën e përgjithëshme të ndarë trimëzaj, të përbërë prej tri idesh muzikale që konkordojnë me njëra tjetrën drejt efektit kryesor: melodija e përmallëshme me taktet e mbëdhja të pjesës së parë - hovi i intesifikuar me shpejtimin ritmik të së dytës - ekspansioni i pasionit në të tretën që kulminon me atë akord largo të masës finale. Më pas, në të njëjtën letër, shkruan raportin e artë që ekziston mes tingullit dhe fjalës, ky i konkretizuar në raportin mes Konos si kompozitor dhe Poradeci si poet: ... *kështu Kono, muzikant hije-rëndë, me tonet valonjëse dhe fluturonjëse nër qiej harmonish të pasosura. Kur se unë vargëtar fat-plumb, i lidhur prej materjes së fjalës, prej fjalës fizike, lëndore, së dheshme - lëndë e rëndë kjo, e shkrumbtë, e plumbtë o Kono - i lidhur unë kështu prej kësaj martirizonjëse për të shprehur atë përmyet saj, harmoninë e padëgjueshme sepse vetëm të ndërë të zemrës - luftoj me fjalën e lëndtë luftë mizore, mundohem, digjem, ndizem, piqem edhe përpiqem, zjef dhe brej, flas e buças, mëndem e çmëndem, vdes po prapë nuk vdes fare dyke rrojtur i vdekur i gjallë - gjer sa me kaq luftë dhe kaq kotësi mund të nxjerr më në fund një harmoni të pakët: të cilën lavdi Zotit, ja se ku vjen muzikanti sepse ndryshe ajo mbetet e dergjur dhe e cekët, ja ku vjen muzikanti për t'a shumuar dhe fuqizuar; për t'a ngritur dhe vërsulur lart qiejve si me kraha të leta me fuqinë dhe magjinë e toneve fluturimtare.**

Ndërkohë, Lasgushi nuk ka nguruar që afinitetin dhe lidhjen e tij me muzikën ta bëjë publik edhe në shtypin shqiptar, fillimisht me një artikull për historikun e krijimit të Himnit tonë Kombëtar, të titulluar "*Himni kombëtar Flamurit pranë të bashkuar dhe*

8 Shih Koço Eno, "Tefta Tashko Koço", familja dhe bashkëkohësit e saj në imazhe", Tiranë, 2016, f. 95. Letër e datës 5 maj 1937. Letër e cituar.
9 Po aty, f. 95.
10 Letër e datës 18 shkurt 1948. Letër e cituar.

gjenezë e tij", botuar fillimisht në gazetën "*Tomorri*", në vitin 1942. Në rrëfimin e tij të tërheq vëmendjen një hollësi: ... *me fjalë të tjera, himni nuk u përgatit me qëllimin e posaçmë që të shërbejë si "Himn Kombëtar", të përmbushë misionin e shenjtë të këngës simbolike zyrtare të popullit. Kjo ngjau se populli e gjeti të pëlqyer; vetë e dëshiroi ai ashtu, nga gjiri i tij i dha trajtën dhe frymën, vetë e shënjtëroi, duke e dashur me zemër gjer në therori dhe më shumë e përtejvetëtherorisë. Me të luftuan çetat e kryengritjes që ishin nëpër gjithë viset e Atdheut, dhe vdiqën vdekjen e ëmbël dëshmorët e lirisë. Me të u ngrit Flamuri në Vlorë*¹¹.

Në një tjetër artikull të shkruar me titullin "*Koncerti Konstantin Papajorgji*", i botuar në revistën "*Bota e Re*", nr. 4, viti 1945, për të konstatohet se "*nuk është thjesht një raportim gazetaresk për një koncert harqesh, por një tekst që i përmban të gjitha elementet e kritikës muzikore*"¹². Aty, ndër të tjera, Lasgushi thekson se: ... "*Rapsodia shqiptare, për hirin e motivit popullor "Trandafil në Shkodër", të zhvilluar më së miri në stilin e kompozicionit modern, gjë e cila vërteton mundësinë e rikrijimit të muzikës popullore shqiptare*"¹³ etj.

Referuar botimeve me mbledhje folklori të Lasgushit, ripohojmë se vitet 1930-1940 ishin vitet më intensive kur ai u përkushtua mbledhjes së folklorit drejtpërsëdrejti nga goja e popullit. Janë disa krijime që provojnë praninë e tij fizike gjatë mbledhjes së folklorit. Po sjell dy prej tyre. I pari, një krijim popullor që quhet "*O Ky Lasgushi mor seç ri fshetur*" dhe i dyti, një krijim letrar i Lasgushit me titullin "*Kënga Pleqërishte*". Te krijimi i parë kuptojmë se sa familjar ishte Lasgushi me bartësit e folklorit, saqë prezenca e tij në ambientet ku këndohej dhe kërcëhej është përjetuar tashmë edhe në krijimin popullor "*O Ky Lasgushi mor seç ri fshetur*"¹⁴. Kurse tek i dyti, kuptojmë jo vetëm atmosferën ku Lasgushi gjendet, pra në mes të një grupi polifonik, por

11 Poradeci Lasgush, "Vepra", Tiranë 1990, fq. 356-373. Lasgushi nuk ka qenë dëshmitar i zhvillimit të ngjarjeve që përshkruan në punimin e tij, por burimi i tij kryesor i informacionit duhet të ketë qenë vetë Asdreni, me të cilin e lidhte një miqësi e gjatë, çka e bën këtë punim dokumentim më të besueshëm në lidhje me krijimin e himnit tonë kombëtar dhe rrethanat e lindjes së tij.
12 Shih Yzeiri Ili, "Semiopragmatika e realizmit socialist", Onufri, Tiranë, f. 119-129. Libër i cituar. Sipas Yzeirit: ... *Poradeci na shfaqet si gazetar brilant, kritik muzikor klasi. Me një stil konciz, përndryshe karakteristik edhe për poezinë e tij, ai e ndërton rrëfimin duke i dhënë çdo fjalë një histori më vete.*
13 Shih Pogradeci Lasgush, "Koncerti Konstantin Papajorgji", revista "Bota e Re", nr. 4, viti 1945, f. 55. Artikull i cituar.
14 Shih Poradeci Lasgush, "Vjersha (këngë) popullore grarishte krahinash të ndryshme", vëllimi II, Tiranë, 2022, f. 166. Libër i cituar.

edhe faktin se duke qenë mes tyre është frymëzuar për këtë poezi unike, e cila në thelb është përshkrimi poetik i këndimit polifonik popullor, nisur nga mënyra si zërat solistikë dhe iso e grupit komunikojnë mes tyre në kontekstin e peizazhit tipik malor shqiptar.

*Këngë pleqërishte! Ti vjersh' e Vendit tem!
Ti fjalë që më dhimbshesh e që më bën ujem!*

*Tani jam dëshëruar së largu të më vish:
Dëgjoju, as dëgjoju! Moj këngë pleqërisht!*

Pa u zgjatur më tej, dokumentimi i këngëve të Usta Isuf Myzyrit ka vlerë të shumëfishtë, pasi:

1. Për të parën herë, prej vetë Usta Isufit dëshmohet se cilat janë këngët e krijuara prej tij, këto në raport me një repertor më të gjerë këngësh që i atribuohen Atij si autor, si në muzikën qytetare të Elbasanit, ashtu edhe në atë të Tiranës.

2. Provohet katërçipërisht origjinaliteti i vargjeve të këngëve të krijuara prej Usta Isufit, kjo përmes vargjeve të kënduara, të dëgjuara në prezencë e më pas të dokumentuara prej Lasgush Poradecit, me kompetencë e korrektesë letrare si dhe me saktësi shkencore. Për këtë arsye, këto këngë duhen konsideruar si vullneti i Usta Isufit, dhe si të tilla ato duhen respektuar në këndimet e mëpastajme sipas variantit që Lasgush Poradeci mblodhi prej gojës së tij.

3. Mbledhja e këngëve të Tij nga Lasgush Poradeci dëshmon se procesi i krijimit të muzikës popullore qytetare të Elbasanit¹⁵ ishte aktiv në vitet 1939-1940 dhe se Usta Isuf Myzyri pranohej dhe konsiderohej nga të gjithë si emblema më e re e kësaj trashëgimie muzikore qytetare.

4. Këngët e Usta Isuf Myzyrit janë prova e qartë e rikrijimit të muzikës popullore të qytetit të Elbasanit pas një periudhe të gjatë shumëshekullore të ndikimit otoman, duke shënuar reformimin e praktikave të ahengut qytetar elbasanas. Në muzikën qytetare këto këngë shenjojnë një kthesë drejt veçorive muzikore paraosmane, drejt shkallëve modale hemitonike, me fare pak kromatizma, me përdorimin e metrave dhe të masave muzikore të lidhura me mendimin poetik e individual të krijuesit dhe jo me krijime të prejardhura, të ndikuara apo të mbishtesuara e të huazuara.

Përmes këtij botimi, Lasgush Poradeci e rendit veten në më të mëdhenjtë mbledhës të folklorit shqiptar të të gjitha kohëve, prej Frang Bardhit, Thimi Mitkos, Spiro Dines, Dozonit, Hahnit, Majerit, Pedersenit e deri te Jeronim de Rada e Ramadan Sokoli.

Njohja e kësaj pune kolosale të kryer nga Lasgush Poradeci në lëmin e mbledhjes së trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar do të sjellë një interesim të çdo kategorie lexuesi ndaj këtyre librave, për t'u njohur me pasurinë e folklorit tonë e, padyshim, një qasje të re të studiuesve të veprës së Tij, për të parë tanimë konkretisht marrëdhëniet e pandashme të Lasgushit me folklorin, ashtu siç ai shkruan te poezia "Përjetësia":

*Nër shteg-bashkimi, që ti sdi sesi,
Bashkohesh brenda me përjashtësi,
Bashkohesh jashta me përbrendësi,
Bashkohesh fellë me përjetësi!*

15 Përpara se Isuf Myzyri të hynte në jetën muzikore popullore të qytetit të Elbasanit, tradita e këngëve të vjetra popullore elbasanase ishte mbledhur dhe sistemuar nga Spiro Papajani më 1859 dhe Harallamb Papajani më 1877. Sipas prof. Shuteriqit, në Elbasan dëgjoheshin sidomos ato që i quajnë "këngë të vjetra". Janë këngë qyteti, plot melizma. I përdorin edhe pak fshatra veriore pranë, ku melizmat ua shtojnë, si në krahinën e Zaranikës. Cituar sipas Tole Vasil S, « Fjalori i muzikës popullore homofonike », Tiranë, 2012.

(Vijon nga numri i kaluar)

Vëllimi me poezi “Gjashtëmbëdhjetë udhë përpjetë malit” ndahet në dy pjesë: pjesa e parë përbëhet nga ndodhia (në shtatë akte) plus epilogu dhe pjesa e dytë nga prologu plus ndodhia (po me shtatë akte). Shumatorja (gjashtëmbëdhjetë) përmban: shtatë akte të ndodhisë (ose shtatë udhë përpjetë malit), një epilog (akt soditje në pikën më të lartë malit), një prolog (lutje në mal) dhe shtatë akte të ndodhisë tjetër. Ndërsa ndodhia tjetër është nga e kundërta e ngjites së parë. Ndërsa e para e merr udhën nga pika zero e malit në të tatëpjetë, e dyta e merr me rënie të përsëritura prej drejt të tatëpjetës së maleve të zhytura. Në ndodhinë e dytë mali/malet janë të zhytura në det. Për pasojë, rëniet tona (si humbje e ngadaltë e shpirtit) janë ngjitje drejt të përpjetës së maleve të përmbysura. Duke rënë nëpër detin e pa-shpirtërisë ne ngjism të tatëpjetën e maleve të zhytura. Të ngjitesh drejt të tatëpjetës së një mali të ngjitur, do të thotë se qenia vazhdimisht fundoset në të vërtetë. Efekti i të kundërtave hyn përsëri në rol. Pjesa e dytë e librit, ose prologu me shtatë akte të ndodhisë tjetër përshkruan aktin e rënies së pamarimit. Është pra e kundërta e pjesës së parë. Ndërkohë që ndodhia e parë ndjek trajektoren papërsosmëri-purgator-parajsë, e dyta ndjek shtatë rrahët e ndodhisë së dytë (ferrit) nga pika më e lartë e parajsës (ose prologut ku gjithçka jepet e kryer). Rënia është ajo çka shmanget në pjesën e parë dhe ajo çka vjen si kujtesë e ndodhisë së shmangur në pjesën e dytë. Për pasojë, ferri mbetet përherë pjesë e së shkuarës, ose e një të ardhmërisë së paralajmëruar. Sepse më e keqja nuk ndodh në ndodhinë e parë. Duke i mëshuar kujtesës së të keqes si një *deja vu*, kalohet prej papërsosmërisë në purgator, kurse tani në ndodhinë e dytë rrefehet ajo që mund të kish ndodhur. Pra edhe s’ka ndodhur sepse është shmangur, edhe jepet përmes iluzionit të strehimit tek e shkuara (na rrefehet prej parajsës), edhe bëhet një e tashme faktike përmes rikujtesës.

Rrëfimi i parë poetik pas prologut mbarë në thelb një paradoks faktik. Në njohuritë astrologjike të gjithkujt, hëna e merr dritën nga dielli dhe po këtë dritë e reflekton në tokë. Në rrëfimin e Leandroit dielli (pjesërisht i zi) i vjedh dritën hënës, hëna është e uritur dhe ana e saj e errët është dielli. Paradoksi faktik vjen në funksion të një lënde shumë tragjike. Demiurgu i përndritur, ose uni lirik që preku kufijtë e përsosmërisë në prolog, ai që paratha se tashmë gjithçka është ashtu si duhet, po na zbulon prej vendndodhjes së tij, se andej nga iku asgjë nuk është ashtu si duhet. Lexuesi sheh një efekt të çuditshëm dhe frikësues. Një dritë që përthith dritë të zezë. Dielli nuk ka se çfarë drite t’i marrë hënës, sepse ajo është vetë një e uritur për dritë. Është një foshnjë që mëkohet me dritën e tjetërkujt. Si mund ta ngopë urinë e dikujt një i uritur? Si mund hëna e uritur/bija e pangjinur, të shuajë urinë për dritë të diellit/atit diell e për më tepër atit të dritës? Alegoria vjen e fuqishme, por shumë e nëndheshme, duke e bërë rrëfimin e parë dhe aktin e parë të tragjedisë. Dielli është pjesërisht i zi, dhe jo plotësisht. Në fund të fundit çdo metamorfozë vjen e përshkallëzuar. Kur reflekton “dritë” nga diku ku s’ka dritë, nuk ndodh gjë tjetër veçse prodhon dritë të zezë. Krijon errësirë.

*“ndërkohë hëna
bën sa mundet
si hënë”*

Po cilat janë kufijtë e mundësisë së krijimit të dritës prej një trupi qiellor që vetëm e reflekton atë? Mundësia këtu është vetëm pamundësi.

Akti i dytë i tragjedisë merr përsipër të identifikojë zërin rrëfyes. I kujt është ky zë, falë të cilit po thellojmë njohuritë tona mbi gjithçka të dukshme dhe të padukshme, të errët dhe të ndritur? Teksti na jep disa cilësi të qenies. Deklaron se *“Emri im është i pashqueshëm”*, ndërsa më parë na adreson të hëna dhe të mali për të pyetur se i kujt është ky zë (*“Fol me hënë, fol me malin”*). Mjegulla e misterit duket se do të përhapet pas një dialogu me qenie reale hënë dhe mal. Po cilën hënë do pyesim për sa kohë ajo është një skelet i padritë? Hënë nuk paskemi. Po mal a kemi? Patjetër se po, por cilin mal? Malin përballë nesh, malin e fshehur në qiell, malin e fshehur në det, malin e fshehur në kohë, malin përtej malit apo malin brenda malit?

(Sprovë leximore në hartën e maleve poetike të Kristoffer Leandroit)

MALI SI NDODHI DHE NJERIU SI KOHA PËRBALLË NDODHISË

Nga Alisa Velaj

Qenia enigmatike duket se po na ndihmon pandërprerë për shquarjen e saj ndërsa jep udhë të rrugon.

“Me tynin ngjitem.

Me urdhëresat zbrës.”

Është pra një qenie e kudondodhur: në lartësi dhe thellësi. Zbret me urdhëresat, ndërsa ngjitet me shkak e pashkak, ose me shkaqe që vetëm ajo i di. Emri i pashqueshëm me këmbëngulje do të shquhet ndërsa na urdhëron: *“Pyet udhën për ku është nisur”*. Tashmë njohuria shtohet dhe misteri nis të zbulohet. Qenia e pashqueshme është qenie superiore derisa ngjitet drejt qiellit, zbret prej tij dhe *as pylli nuk mundet ta fshehë, as zjarri ta kapërdijë, as çeliku ta gdhendë dhe as era ta ndjekë*. Ajo zbrdet me urdhëresa dhe këto urdhëresa janë për ne qeniet e prekshme dhe që kemi emra të shqueshëm. Në hapësirën midis qenies së pashqueshme superiore dhe qenies së pashqueshme të urdhëruar qëndron udha. Udhë që jemi të urdhëruar të ndjekim.

“Jam mali që ri poshtë malit.

Hija ime mjafton, edhe për ty.”

Mos kërkë më se cili jam unë, thotë zëri. Mali poshtë malit është mali i fshehur në kohë, mali që nuk mund të shohim, sepse ne nuk kemi asnjë fuqi mbi kohën. Po dëgjojmë zërin e ardhur nga kudo, që di tërë të fshehtat e gjithçkaje që duket dhe nuk duket. Zërin e një qenie që di gjithçka, që shquan çdo mister të lindur a të palindur ende. Prandaj patjetër dhe pa asnjë dyshim duhet t’i besojmë se gjithë ç’na rrëfen është e vërtetë. Ai zë është UNË JAM-i apo UNË JAM AI QË JAM,¹ një emër pra i pashquar që na shquan ne dhe na urdhëron të mos kemi lëkundje në çdo kumt të dërguar. Leandroit e rimer kaq bukur mitin biblik në këtë akt të dytë tragjedi. Uni i tij lirik e ka të domosdoshme të besohet në rrëfimin e tij aspak të zakonit dhe për ta fituar këtë mirëbesim të lexuesit, mvesh cilësitë e një zëri hyjnor. Gjithë ç’rrefehet bëhet plotësisht e mjaftueshme vetëm kur shterohet çdo hije dyshimi në vërtetësinë e të rrëfyerit. Vargu përmblyllës: *“Hija ime, mjafton edhe për ty”* është një urdhër i hapur për çdo hije dyshimi të lexuesit spektator të tragjedisë. Është dhe një lloj lutje përtej urdhërimit. Në rrëfimin e parë pamë se po shumëfishohej vetëm errësira. Në këtë atmosferë ku është mekur, ne qeniet tokësore nuk jemi në gjendje ta lëshojmë hijen tonë. Atëherë le t’i besojmë malit të fshehur në kohë dhe hijen e tij ta pagëzojmë si hijen tonë. Le t’i ndjekim dhe pesë aktet e tjera të tragjedisë duke parë, dëgjuar dhe kuptuar çdo gjë që na vjen si e tillë përmes zbulësës së malit.

Në rrëfimin e tretë jepet më në fund shkaku pse unë-jam-i na jep së pari pamjet e kateklizmës në rrëfimin e parë dhe arsyt pse duhet t’i bindemi urdhëresave në rrëfimin e dytë.

“Nga mali i purgatorit dëgjohej brohoritje sa herë një shpirt çlirohet dhe ngjitet.”

Shkaku është dashuria për shpirtat e paçliruar. Duke e besuar zërin e qenies superiore, do të shpëtojmë prej errësirës së shumëfishuar nga dielli i zi, nga koha e ngrirë e maleve të përkapshëm nga sytë (si kohë e papërsosur), nuk do të jemi të huaj me zbulimin e të vërtetave supreme dhe do të bëhemi pjesë e malit. Duke u bërë një me malin e dukshëm, më lehtë i kuptojmë të pathënat, pasi jemi më afër zërit rrëfyes që vjen nga përpjetë malit. Të çlirohemi nga kujtesa e kohës së ngrirë dhe yjeve të vdekur,

1 Perëndia i tha Moisiut: “UNË JAM AI QË JAM”. Pastaj tha: “Do t’u thuash kështu bijve të Izraelit: “UNË JAM-i më ka dërguar tek ju”. Bibla. *Dhata e Vjetër dhe Dhjata e re*. (2002). *Libri i Eksodit*, Kapitulli 3, Vargu 14. Tiranë: Shoqëria Biblike Shqiptare Sh.B.Sh.

duke u ringjallur si shpirtat prej purgatorit në parajsë, ky është misioni i shenjtë i rrëfimit. Rrefehet tragjedia para se të ndodhë, sepse vetëm kështu shpirti e pëson katharsisin pa asnjë pendim për çfarë lë pas.

Rrëfimi i katërt poetik është një trajektore lineare e të vërtetës së zbuluar në rrëfimin e tretë. Një zbulim më i mëtejshëm i saj. Orakulli i rrëfimit është fare i qartë në kumtin e tij. Zëri profetik është shndërruar në zë kaq miqësor për tërë shpirtat e humbur. Arsyeja? Duhet kuptuar nga gjithkush, pasi gjithkush duhet shpëtuar. Brohoritjet nga mali i purgatorit janë njësoj të hareshme për çdo qenie, pa asnjë dallim. Në një rrafsh social, unin lirik e tmerron tëhuajzimi i botës së sotme dhe egoizmi që e mban të ngujuar secilin prej nesh në një botë të vogël, të padritë, të pangjyër.

“Me kalimin e viteve mësohesh me atë hapësirë që i ke krijuar vetes,

atë korridor gjithnjë e më të ngushtë që gjarpëron midis unit dhe botës,

pa i merituar hiret e emrit tëhuajzimit.”

Sarkazëm vrastare. Njeriu modern paska shkuar dhe më përtej tëhuajzimit. Aq larg sa tëhuajzimi me hiret e tij paska qenë një shtëpi ende më e mirë se burgu ku ndodhemi tanimë.

Duhet patjetër të kthehemi pas, me hir a pahir. Askush nuk na e ka mohuar pjesëmarrjen në kohën e malit. Mali ka qenë aty, ikanakët jemi ne. Pa mallin për malin nuk rilindemi dot. (*“Mali, më i vjetër se ti, por më i ri se malli yt”*). Malli ynë për një mal përherë të lartuar është zbehur. Të bëhemi mal, të rilindemi në pikën ku mali prek të pamërritshmen, të jemi pemë e lartuar kah qielli, të jemi shtëpi pranë konstelacionit të yjeve, ky është misioni ynë dhe jo korridor i ngushtë gjarpërues që helmon diellin e të parit, bebëzën e syrit të shpirtit. (*“Kurora të zhveshura pemësh kapen për qiell, thua se jemi në shtëpi”*).

Rrëfimi i pestë poetik s’është tjetër veçse lutje e unit lirik në askundnjën e lulëzimit: në dimër. Duhet të rilindemi, duhet të jemi pranverë kur kurorat e zhveshura të pranverohen nga qiejt. Sërisht i njëjti zë, që tani vetëm na lutet: *Kthehuni, bëhuni mal, bëhuni shtëpi e gatshme për ringjallje. Jeni bërë shpirtat ku vetëm ftoh bora, ndërsa përreth nesh kemi vetëm male.*

“Asgjë nuk është e kryer, urdhëro e shkruaj!”

Zëri i Qenies superiore lutet, rrëfen të vërteta njerën pas tjetrës, na thotë se na e ka dhënë ndodhinë e kryer që duhet t’i ngjajmë.



Na tregon me zë, na shpalos me pamje një shtëpi të rrethuar me male. Shtëpinë tonë që duhet ta rimëkëmbim, ta kryejmë si shtëpi, sepse po bëhet ngrehinë.

Rrëfimi i gjashtë mbulohet me një tis balade. Tashmë njohuria është zbuluar e tëra dhe për të tërë. Varet si do e kuptojë gjithsecili. Në rrëfimin e parafundit, përmes një poezie të plotë majtas dhe një refreni përplotësues djathtas, jepet ngjitja e qenies me njohuri të zbuluara drejt malit-zot ose zotit mal (në poezi) dhe mënyra se si duhet ta bëjmë ngjitjen më të lehtë, të përpjetën më të mundimshme. Në anën formale duket se kemi dy poezi, por në fakt është një këngë e vetme dhe refreni i saj. Kënga xhit ngjitjen. Refreni i shkruar me shkrim kursiv urdhëron mënyrën e ngjitjes dhe arsyen pse ngjitja duhet të jetë e tillë. Shkrimi kursiv, sikurse në prolog, nënkupton një zë të ardhur nga hapësirat qiellore. Gjysma e refrenit ka fjalët: pa kazan, pa dru, pa ujë, pa qymyr, pa kazan, pa dru, pa zjarr, pa bukë. Gjysma tjetër e refrenit janë tri fjalitë e të fundit zbulësë (në të gjashtëmbëdhjetë rrëfimet): fosile notojnë në gur, guri është formë ere dhe edhe zjarri këtu është gur. Rimerret metamorfoza e gurëzimit në aktin e tretë të tragjedisë bash në rrëfimin e tretë nga mali i purgatorit, ku shkruhet: *“Zog a peshk: këtu lart të dy janë prej guri”*. Rrëfimi i parafundit mund të lexohet si një këngë me një refren, si këngë me pjesën e parë të refrenit, ku ky i fundit shpjegon se në rravimin drejt malit shpirti duhet të jetë i zhveshur nga çdo gjë tokësore dhe së mbrami, si këngë me pjesën e dytë të refrenit, ku marrja e të tatëpjetës shoqërohet me tri zbulësat e fundit. Rrëfimi i gjashtë është ftesa, zbulësia dhe paralajmërimi i fundit për rravimin e domosdoshëm.

Rrëfimi i shtatë ka në dukje për një lexues empirik dy poezi me nga katër strofa secila, njëra në të majtë, tjetra në të djathtë. Në të vërtetë, për një lexues model të poezisë, mund të gjendet një numër i papërcaktuar rrëfimesh hipotetike. Ja disa syresh për parantezë: leximi i dy poezive si një e njëjtë, duke i përfytyruar të dyja poezitë si pjesë koherente e një poezie, me lexim nga e majta në të djathtë dhe nga e djathta në të majtë për çdo varg, secila strofë ose secili varg i poezisë në të majtë të bashkëshoqërohet me poezinë e plotë në të djathtë dhe anasjelltas etj. Në të gjitha leximet vargu kyç mbetet: *“Dheu përpëlitet në dhimbje lindjesh”*. Ka kaq shumë lexime dhe po kaq rrëfime brenda rrëfimit mëmë pasi e gjashtëmbëdhjeta udhë përpjetë malit është dhe më e mundimshmja. Ajo ka nëpër trupin e saj gjurmët e zvetënimeve, vdekjeve dhe rilindjeve. Udhë e gjashtëmbëdhjetë është udhë e kryer për cilin shpirt mundi dhe për cilin nuk mundi ta kryejë rravimin e përtejme. Është shtegu i ngushtë prej nga kush e pa dhe kuptoi dritën, u bind se askush s’ka parë mal ndonjëherë. Ngase mali në të vërtetë jemi ne shpirtat e çliruar dhe të ngjitur në majë.

Leandroit ka krijuar me këtë libër një superstrukturë poetike, për të na ndihmuar të thellojmë njohjen e botës reale në rrafshet epistemologjike psikologjike dhe sociale. Një tjetër poet i madh para tij, amerikani Wallace Stevens, do të jepte i pari modelin se si një fenomen, gjësend i shpirtëzuar apo shpirt frymues në një kohë dhe hapësirë të dhënë, mund të vështrohet në pamje të ndryshme dhe thelbe të ndryshme apo të njëjta. Mjafton të përmendim ciklin gjerësisht të përkthyer në gjuhën shqipe “Trembëdhjetë mënyra për të parë një mëllënjë”. Leandroit e rimerr këtë teknikë poetike të të analizuarit fenomenit nga këndvështrime të njëjta apo të kundërta, por me një ndryshim thelbësor: sivëllai suedez i Stevens e rifunksionalizon fenomenin e shpirtëzuar në kontekst të një makrostrukture poetike, duke krijuar një tërësi makrokozmosesh paralele për ndriçimin e rravimit tonë sa racional, aq dhe irracional. Është pikërisht ai rravim që Bachelard na e përshkruan kështu: “Endërrimi poetik na jep botën e botëve. Endërrimi poetik është një përumbje kozmike. Është një hapje drejt një bote të bukur, drejt botëve të bukura. I jep unit një jo-unë që i përket unit: jo-uni im. Është ky “jo-uni im” që magjeps unin e ëndërrimtarit dhe që poetët mund të na ndihmojnë ta ndajmë”.²

2 Bachelard, Gaston. (1971). *The Poetics of Reverie: Childhood, Language, and the Cosmos*. Trans by Daniel Russell, USA: Beacon Press.

Vepra e vëllimshme e përgatitur nga Dhori Qirjazi, tashmë e botuar nën logon e QSPA-së, u kushtohet disa kontributeve minore të Kamardës, që kanë mbetur në hijen e veprave të tij madhore “Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese” (Livorno, 1864) dhe “Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese” (Prato, 1866), por që kanë rëndësi për t’i vendosur në një kontekst më të plotë idetë e tij për gjuhën letrare shqipe dhe alfabetin e përgjithshëm të saj.

Qëllimi parësor i punimit ka qenë ndriçimi më i plotë i figurës së intelektualit të shquar arbëresh, Dhimitër Kamardës, në 200 vjetorin e lindjes së tij (tetor 2021), ku së pari vëmendja përqendrohet në përkthimin e studimit të Dora D’Istrias mbi kombin shqiptar sipas këngëve popullore, me titullin shqip “Fyletia e arbënore prej kënkëkatë laoshima”. Për të arritur në përkthimin e Kamardës dhe ndriçimin e problematikës që lidhet me të, autori e ka parë me vend të paraqesë në libër materialet që çuan deri te ideja e Kamardës për përkthimin në shqip të këtij studimi dhe pastaj edhe gjuhës që përdori ai në këtë përkthim. Kështu në vëllim janë përfshirë origjinali frëngjisht i studimit të Dora D’Istrias, përkthimi shqip i tij prej Drita Siliqit si dhe përkthimi në italisht prej E. Artomit në 1867, i cili, siç vëren autori, duhet t’i ketë shërbyer si nxitës dhe model Kamardës për përkthimin e tij në gjuhën shqipe. Vijon ribotimi i përkthimit të Kamardës, i paraprirë nga parathënia e tij si shkrim origjinal prej 20 faqesh, në dy mënyra: faksimile e origjinalit dhe transkriptim në alfabetin e sotëm. Transkriptimi shoqërohet me shpjegime të natyrës leksikore që ndahen në dy pjesë: “e para shpjegon fjalë të tekstit të panjohura për lexuesin e sotëm, kryesisht neologjizma të Kamardës, duke iu referuar zakonisht origjinalit frëngjisht apo burimesh të tjera, ndërsa e dyta përqendrohet te greqizmat e shumtë të Kamardës”. Duhet theksuar se Kamarda është shumë e vështirë, madje e pamundur të lexohet e të kuptohet pa njohur greqishten. Sipas parimeve që ai vetë kishte përvijuar në parathënien e përkthimit të tij të punimit të Dora D’Istrias, Prekallëzimë, për fjalët abstrakte e diturore që nuk gjendeshin në shqipe, ai përdori së pari fjalëformimin me brumin e shqipes, dhe së dyti huazimin. Këtu u mbështet kryesisht në gjuhën greke, sipas idesë së tij të afërisë së shqipes me greqishten në kuadrin e teorisë “pellazgjike” të prejardhjes së të dy gjuhëve, dhe duke zgjedhur këtu ato fjalë që mendonte se kanë rrënjë të përbashkët me shqipen, pra që nuk ishin krejt të huaja. Siç konstaton autori, “greqizmat që përdor Kamarda nuk u përkasin përgjithësisht greqizmeve specifike të të folmeve arbëreshe”, pra janë greqizma që përdoren në greqishten e re. Së dyti, siç pohon me të drejtë autori: “përkthimi i Kamardës përfaqëson pas shumë gjasash ndërmarrjen më të thellë e më të gjerë neologjike që njohu shqipja e shkruar e shek. XIX dhe një nga pikat kulmore të neologjisë në mbarë historinë e shqipes”, gjithsesi neologjizma “të pafanë”, pasi nuk patën jehonë në lëvrimin e mëtejshëm të shqipes. Por ai

Përkujdesja e botimit dhe studimi krahasues nga Dhori Qirjazi
Qendra e Studimeve dhe Publikimeve Arbëreshe, Tiranë 2022

DHIMITËR KAMARDA, PËR NJË SHQIPE “TË GJITHAKUSHME EDHE TË GJITHAKUNDME” & TË TJERA VEPËRZA

Nga Anila Omari



shumë nga neologjizmat e formuara me brumin e shqipes, i krijoi sipas modelit semantik të greqishtes, pra në formë kalkesh kuptimore nga fjalët gjegjëse të greqishtes. Për këtë arsye, Dhori Qirjazi ka qenë studiuesi i duhur dhe ndoshta i vetmi ndër albanologët që mund të merrte përsipër të realizonte një ribotim të përkthimit të Kamardës në alfabetin e sotëm, duke shtuar dhe shënimet e nevojshme për fjalë të caktuara, pa të cilat leximi i veprës në kohën e sotme do të ishte i pamundur.

Parathënien e Kamardës, që është krijim origjinal i tij dhe me shumë vlerë për të njohur e kuptuar metodën që përdori Kamarda në krijimin e “idiolektit” të tij letrar, autori e ka përkthyer në shqipen e sotme, duke i qëndruar sa më pranë gjuhës dhe stilit të origjinalit autorial. Për sa i përket gjuhës letrare që krijoi Kamarda në këtë përpjekje të tij përkthimore, autori i vëllimit e ka parë me vend të botojë dy artikuj të studiuesve Gëzim Gurga dhe Anila Omari për këtë çështje, të cilët plotësojnë nga ana studimore parashtresën e Kamardës duke analizuar parimet dhe metodën e tij eklektike të krijimit të një gjuhe letrare të përbashkët për shqiptarët.

Në vijim autori i vëllimit, duke dashur të përcjellë jehonën që pati përkthimi i Kamardës ndër bashkëkohësit e tij dhe ndikimin që pati në kohë, sjell katër variante të përkthimit të parathënies së Kamardës nga Thimi Mitko të përshtatura në shqipen “ballkanike” të kohës së tij, të kryera në kohë të

ndryshme që përfshijnë periudhën para vitit 1875 e deri në kohën pas vitit 1878. Vetë ky mbledhës e hulumtues i pasionuar i folklorit dhe i shkrimeve shqipe saktëson se e ka ripërshtatur punën e Kamardës në të folmen dangëllishte-toskërishte. Autori i ka ndjekur gjurmët e këtyre përshtatjeve dhe i ka mbledhur qoftë nga “Bleta shqiptare” qoftë në dorëshkrim nga Arkivi i Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë në Tiranë. Një hipotezë e goditur e autorit është se studimi i Dora D’Istrias ka qenë për Mitkon “hyrja ideale për “Bletën shqiptare” që ai po përgatiste, madje “Bleta” do të mund të konsiderohej si një vazhdim i natyrshëm, me lëndë folklorike, i sprovës së njohur të Helenës së Gjokajve”. Mitkoja, siç ka vënë në dukje autori, ishte një urë lidhëse mes kolonive të reja të shqiptarëve, themeluar në shek. XIX, me atdheun mëmë, dhe, në anën tjetër, me arbëreshët e Italisë dhe arvanitët e Greqisë. Këto variante apo motërzime të Mitkos autori i sjell në alfabetin e sotëm të shqipes, të transliteruara nga alfabeti grek i origjinalit, dhe në një kapitull të veçantë që mbyll pjesën e parë të librit, i bën objekt të një studimi krahasues me përkthimin e Kamardës, duke vënë në çdo rast për ballafaqim edhe tekstin përkatës të origjinalit të Dora D’Istrias. Në këtë studim ai ndalet sidomos në përpjekjet e Thimi Mitkos për ta kthyer gjuhën eksperimentale “in vitro” të Kamardës në një shqipe të kuptueshme nga shqiptarët e Shqipërisë, një shqipe të gjallë, “in vivo”. Autori vë në dukje


këtu një aspekt të pavënë re të punës së Mitkos me përkthimin e Kamardës dhe të autorëve të tjerë arbëreshe, faktin se ai ka përfshirë në veprën e vet leksikografike prurjet leksikore të tyre. Nga krahasimi me fjalorin e Mitkos që autori e ka përgatitur e botuar më parë, atij i rezultojnë se Mitko është ndoshta “i vetmi që regjistroi sistematikisht fjalë të arbërishtes, dhe madje nuk la jashtë fjalorëve të vet edhe neologjizmat e “pafanë” të Kamardës, marrë kryesisht nga “Fyletia...”, në mënyrë selektive”. Që këtej del dhe një perspektivë studimi që shtroni autori për sa i përket hartimit të një fjalori të neologjizmave të shqipes të periudhës së Rilindjes, në të cilin kjo veprë e Kamardës ka për të qenë burim i pasur, dhe, nga ana tjetër, vetë Fjalëtorja shqip-greqisht e Mitkos do të konsiderohet ndër veprat e para që i pasqyrojnë neologjizmat në këtë masë.

Në pjesën e dytë të veprës paraqiten tri vepërza pak të njohura të Kamardës.

E para është një letër e gjatë në greqisht e Kamardës, botuar në gazetën greke Elpis në vitin 1861, pra më herët nga kontributet e tjera më të mëdha të tij. Kjo letër na bën të njohur me idetë dhe pikëpamjet e studiuesit arbëresh si dhe me faktin se ndërkohë ai e kishte gati veprën e tij të gjuhësisë historike-krahasuese në fushë të shqipes dhe pret mundësinë e botimit të saj. Që këtej mësojmë se Kamarda e kishte përfunduar që në vitin 1861 veprën madhore të tij “Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese” e cila u botua në vitin 1864.

Përmes kësaj letre mësojmë evoluimin e ideve të Kamardës në çështjen e gjuhës së përbashkët letrare shqipe. Në këtë letër, në përputhje me idenë e tij për rrënjët e përbashkëta pellazgjike të shqipes dhe greqishtes, ai shkruante:

“Gjuha e shqiptarëve, duke qenë dialekt i kryehershëm i greqishtes së qëmoçme, mund të selitet dhe të drejtshkruhet më tej; sigurisht, jo për t’u bërë gjuhë letrare, çka është e pamundur dhe e padobishme për shqiptarët, por për t’u ruajtur, sa i lejohet, e gjallë dhe e pacenuar, si një jehonë e moteve pellazgjike, dhe për t’u përdorur si mjet përvetësimi të kulturës greke, në dobi të atyre që e flasin”. Me kalimin e kohës, siç vë re dhe autori, “Kamarda do t’i rimarrë këto ide dhe më 1869 do të botojë një broshurë të shkurtër, me të cilën



propozon që shqipja të shkruhet, sipas rastit, me dy lloj alfabetesh, mbështetur gjegjësisht në alfabetin grek dhe latin”.

Këtë lloj evolucioni kanë përjetuar edhe përfaqësues të tjerë të Rilindjes kombëtare, si Thimi Mitko apo Jani Vreto. Nga adhures të gjuhës dhe kulturës greke në fillimet e veprimtarisë së tyre kulturore-letrare, me përparimin e Rilindjes dhe rritjen e ndërgjegjes kombëtare ata u shndërruan në patriotë të flaktë shqiptarë e madje kundërshtarë të helenizmit.

Një vepër tjetër e Kamardës që është përfshirë në vëllim është ajo mbi Alfabetin e përgjithshëm të shqipes (Alfabeto generale albanano-epirotico) i vitit 1869, i riprodhuar në mënyrë anastatike.

Vepërza e tretë është një përmbledhje e tri këngëve popullore shqipe të Epirit (Shqipërisë së Jugut) që i kushtohen kryengritjes greke të vitit 1821-27, botuar në Livorno në 1875. Edhe kjo vepër është riprodhuar si faksimile e origjinalit. Vjershat, dy nga të cilat i kushtohen vdekjes së Marko Boçarit dhe njëra kryengritjes greke, janë përshtatur në italisht në prozë dhe janë pajisur me shënime shpjeguese nga Kamarda. Kjo vepër është përkthyer në italisht nga Vilma Proko.

Autori i vëllimit që kemi në dorë i ka kushtuar një paragraf problemit të kërkimit të vjershave origjinale shqip dhe, në bazë të një njoftimi të Vilma Prokos, ka rënë në gjurmë të këtyre vjershave të botuara nga Thimi Mitko në Bletën shqiptare të botuar në Aleksandri. Vjershat riprodhohen si faksimile të origjinalit dhe të transkriptuara.


Më në fund, në vëllim është përfshirë edhe një broshurë e Kamardës me titull “Pochi versi in greco”, botuar në Livorno në vitin 1874, edhe kjo riprodhuar si faksimile e origjinalit dhe e përkthyer në shqip prej Anna Shkrelit.

Autori vë në dukje në një paragraf më vete edhe një kontribut gjuhësor të Kamardës për një përkim të tipologjisë “ballkanike” mes greqishtes dhe shqipes, po edhe gjuhëve të tjera si bullgarisht e arumanisht, për sa i përket formimit të së ardhmes me *do*, duke riprodhuar edhe dy faqet origjinale të Kamardës nga vepra “Saggio di grammatologia comparata...” ku trajtohet kjo çështje.

Vepra e përgatitur nga Dhori Qiriazhi hedh një dritë më të qartë e më të plotë në figurën e Dhimitër Kamardës, i cili me veprën e tij albanologjike dhe me idetë e përpjekjet e veta për një gjuhë të përbashkët të letërsisë shqipe, në funksion të bashkimit të shqiptarëve për pavarësim nga sundimi turk, mund të renditet me plot të drejtë ndër pararendësit e veprimtarëve të Rilindjes kombëtare shqiptare. Paraqitja e plotë e përkthimit të tij të studimit të Dora D’Istrias në alfabetin e sotëm dhe me shpjegimet e neologjizmave dhe huazimeve të tij të shumta, sidomos nga greqishtja, si dhe kthimi në gjuhën e sotme i parathënies së tij origjinale, për herë të parë këto në studimet tona filologjike, i japin lexuesit dhe studiuesve të ardhshëm një lëndë të gatshme për studime të mëtejshme mbi gjuhën e tij letrare. Në këtë drejtim kontribuojnë edhe shkrimet e tjera minore të Kamardës të paraqitura në këtë vëllim.

SATIRA DHE SARKAZMA KADAREANE

Nga Ferit Lamaj



Nisa të lexoj “Kohë e pamjaftueshme” të Helenës dhe libri nga faqja në faqe po më tërhiqte si me magnet. Shijoja artistikisht gjithçka: njohjen e çiftit, madje edhe paranjohjen në distancë aq të largët, Tiranë – Moskë; më tej takimet e para joshëse, gëzimet, kënaqësitë shpirtërore të moshës, po si në çdo dyshe të re të porsadashuruar, edhe “ngërçet”, cingërisjet, qejfmbetjet e trillet.

Por ajo çka zbulova i befashuar që në fillim ishte humori i mprehtë, satira dhe sarkazmi përvëlues i shkrimtarit Ismail Kadare, rrëfyer me ndjenjë parësore dhe emocion të veçantë prej bashkëshortes së tij.

Romanet e botuar së pari të Kadaresë: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kronikë në gur”, “Dimri i vetmisë së madhe”, “Koncert në fund të dimrit” etj. i kam lexuar në adoleshencë. Vetëkuptohet, në kushtet e rrethanat e kohës, ku përgjithësisht letërsia shqiptare notonte në detin e trazuar të socrealizmit e ku pak zëra të rinj, premtues, krejt të ndryshëm në konceptim të artit letrar sapo qenë shfaqur në sytë dhe mendjet e lexuesve.

Ishte pikërisht koha e izolimit tërësor jo vetëm të kufinjve shtetërorë fizikë e politiko-ideologjikë, po edhe e atyre letraro-artistikë. Të dilje përkundër dallgëve të rrymës detare, stuhive ajrore, “klonit” letrar tokësor, përbënte pa dyshim një akt të tepruar e të vërtetë guximi dhe vetëfljimi. Nëse do të flisja me gjuhën ezopiane e lafonteniane: në tokë të përndiqte Qeni i kufirit së bashku me qentë dykëmbësh, në det Peshkaqeni grabitqar e në ajër Skifteri kthetravrasës.

Ja që tani, në moshën time të tretë, u desh një rilexim i përthelluar i veprës kadareane në prozë, për të gjetur e qëmtuar një thesar të rrallë humori, satire e sarkazmi të këtij gjeniu mbarëbotëror.

Të jem i çiltër me lexuesin, i hyra me kënaqësi të veçantë punës hulumtuese, e më tej asaj krijuese mirëfilli me aq dëshirë e pasion për të pikasur e për t’i dhënë lexuesit në vargje, në stilin e fabulistit rreth 50 satirat e sarkazmat më të fuqishme të shkrimtarit tonë të shquar Ismail Kadare.

Në ndërkohë pata edhe një sërë takimesh tepër miqësore e frytdhënëse me z. Kadare në lokalitë e tij të preferuar në Tiranë, Bar “Juvenilja”.

Porse tashmë “i kisha hyrë detit më këmbë”. Nga libri në libër, nga romani në roman mademet ismailiane ishin të shumtë e të larmishëm. E si mund të anashkaloheshin?! Mbi 230 satira e sarkazma përfshihen, doemos në mënyrë joshteruese, në këtë vëllim të titulluar “Satirë dhe Sarkazëm Kadareane”.

Vetë lloji fabulor me figuracionin e larmë letraro-gjuhësor, si: aliteracionin, alegorinë, antitezën, homoniminë, metoniminë, sinekdokën, paradoksin, pasthirrmën, përsëritjen, përshkallëzimin, po edhe retorikën e ritmin muzikor të vargut, bën që të dalë më në pah forca satirike dhe sarkastike e prozës së I. Kadaresë.

Kjo satirë dhe sarkazëm e gdhendur në veprën e tij monumentale letrare e publicistike rrok një spektër e tematikë të gjerë, si atë shoqërore, psikologjike, diplomatike, erotike, e sidomos politika është fusha më e preferuar e shkrimtarit. Politika me të gjitha problematikat e saj: luftën klasore, dhunën, diktatin e shpallur e të pashpallur, izolimin e plotë, mjerimin intelektual etj.

Autori shprehet stilistikisht përmes metaforave universale herë tërthoras e herë drejtpërdrejt. Luan logjikshëm si një shahist i përkryer me kuajt e “Trojës, të Moskës, të Pekinit, të Beogradit e të Tiranës”, duke kapur mat: Faraonë, Sulltanë, Perandorë, Carë e Sekretarë të Parë, Diktatorë bashkëkohorë.

Ngjarjet shtjellohen e pasqyrohen në hapësirë e në kohë: në ajër, mbi tokë e nën tokë, në “ferr e parajsë”, ku humori, satira dhe sarkazmi janë përherë të pranishëm. Por le ta ilustrojmë mendimin vetëm me pak shembuj.

“Ndaj porosia e Padishahut sovran është e tillë, që asnjë ëndërr, e parë qoftë edhe në kufinj të më të largët të shtetit, qoftë dhe në ditën më të kurrfartë, qoftë

edhe nga robi më i humbur i Allahut, të mos mbetet jashtë shoshitjes së Tabir Sarajit.” (Pallati i ëndrrave).

“Një tjetër folës, ...nxori tezën se Çajupi ishte i pari në botë që kishte hedhur parullën e kthimit të luftës imperialiste në luftë civile. Ky pohim, që e vinte Çajupin mbi Leninin, u prit me skepticizëm nga të pranishmit.” (Qyteti pa reklama).

“Një varr kaq i madh në mes të Egjiptit s’ka si të mos ndjellë prapësinë, thoshin me zë të ulët. Dhe veç kësaj, një varr jo për së mbari, si gjithë varret me gropën poshtë, por një varr me gropën përpetetë, shkurt, një varr i kthyer përmbys.” (Piramida).

“Që kishte diçka që s’shkonte te Stalini, këtë do ta tregonte e qara për vdekjen e tij: Qanin ata që vite me radhë kishin brohoritur nëpër festa dhe mitingje, siç ishin punëtorët e fabrikave, oficerët, kooperativistët, organizata e gruas, shkurt qanin gjithë të qeshurit. Dhe pas tyre nxënësit e shkollave, të burgosurit, jetimët, skuadrat e volejbollit, minoritarët, rrobaqepësit, estonezët, mongolët, byrotë politike.” (Mëngjeset në Kafe Rostand).

“Për të parë filma erotikë të stacioneve private italiane, njerëzit thyenin këmbët e duart duke u kacavjerrë nëpër pullaze për të vënë gjithfarë antenash që u ngjanin tiganëve, oturakëve, fuzhnjës së peshkimit ose kurorës me gjemba të Krishtit. Të tjera ngjasonin me pirunë, shishqebapë, vegla të abortit e dreqi e dinte çfarë. Thoshin se iu qepeshin pullazeve pleqtë me kyçet e mbërthyer nga reumatizma, të damllosurit, madje edhe veteranët e dyzetënjëshit, ata që kishin themeluar partinë.” (Hija).

“Lopa ... S’ishte e rastit që në letërsinë shqiptare të së kaluarës kishte aq skena të dhimbshme për të. Ju e dini, shoku Ramiz, prozën e famshme të Migjenit, ku malësorët në një natë të acartë e afrojnë lopën te zjarri dhe një foshnjë ngrin për shkak të saj. Ju e dini si këndohet në baladat e lashta “Kau i zi” ... (Nga një dhjetor në tjetrin).

Librin “Satirë dhe Sarkazëm Kadareane” nuk mund të mos e lezetonte edhe majaja humoristiko-satirike e krijimtarisë së vetë asaj që, siç thuhet në hyrje të kësaj Parafjale, u bë kumbara dhe shkasi për realizimin e vëllimit, shkrimtares Helena Kadare. Kjo majë e rrallë shpërfaqet këndshëm sidomos në librat e saj: “Kohë e pamjaftueshme” dhe “Një grua nga Tirana”.

Vëllimi, porsiq qershi mbi tortë përmbillet me ciklin “Humor mençuror miqësor”. Bëhet fjalë për jo pak dialogë të shkathët e të natyrshëm, si dhe për batuta hidhepritëse.

Disa prej satirave dhe sarkazmave, të deklamuara prej meje para shkrimtarit Kadare, janë: “Çifti Kadare mysafir te çifti Bosquet”, “Vetmi pranë pemës së Krishtlindjes”, “Këpuca e kinezit Ping”, “Kosherja”, “Panajot Pano”, “Ç’ti dojë zemra” etj. Dëshira e tij ishte, “të tjerat m’i bëj surprizë kur të botohet libri.”

Studimi "Poezia e Kosovës në tri kontekste" i autores Mimoza Hasani Pllana ka për qëllim të analizojë në mënyrë kritike poezinë në Kosovë gjatë viteve 1990-1999 dhe autorët emblematikë të asaj periudhe. Për të arritur qëllimin, studiuesja evidenton dhe analizon veçoritë e autorëve dhe veprës së tyre, por edhe raportin mes poetit dhe audiencës së tij, duke filluar me identifikimin e veprave të botuara; identifikimin e poetëve të brezit të ri në periudhën e përzgjedhur; analizën e zhvillimit të përgjithshëm të poezisë gjatë kësaj periudhe; identifikimin e dukurive të reja; përcaktimin e rrethanave politike dhe kulturore për periudhën; analizën e poezive; zbulimin dhe analizën e vlerësimit kritik të përkthimeve në bullgarisht dhe rumanisht; popullarizimin e poezisë shqipe nga Kosova në Bullgari.

Kërkimet e pikave të përmebduara arrihen me zbatimin e disa metodave paralelisht, duke bërë me dije se për shkak të specifikave të një studimi letrar humanitar nuk mund të zbatohen metoda të sakta dhe interpretimi varet gjithmonë nga perceptimi subjektiv i kritikut letrar. Para së gjithash, si qasje për analizë zgjidhet qasja strukturaliste, ku zbatimi i saj synon të shikojë formën dhe strukturën e veprave, pasi elementë të strukturës së brendshme janë fjala, vargu, strofa, ritmi dhe rima, ndërsa struktura e jashtme pasqyron idetë e poetit. Qasja e dytë e adoptuar është ajo fenomenologjike, e cila e lidh tekstin letrar me përvojën dhe njohuritë e mëparshme të lexuesit. Në mënyrë shumë të përshtatshme zbatohet edhe qasja letrare-historike, nadaj autorja me të drejtë beson se ajo siguron lidhjen ndërmjet rrethanave historike dhe politike dhe shfaqjes së një vale të re të poezisë shqipe në Kosovë, veçanërisht kur bëhet fjalë për poezinë sociale. Metoda e letërsisë krahasuese është një mjet analize kur bëhet fjalë për poezinë emigruese dhe vlerësimin kritik të autorëve dhe veprave në shqyrtim. Ndjekja e katër metodave në zhvillim jep rezultate shumë të mira.

Poezia e Kosovës në tri kontekste strukturohet në tre grupe poetësh. Në grupin e parë përfshihen poetë që tashmë janë vendosur në dekadën në shqyrtim, por debutuan në vitet 1960 dhe 1970, duke kaluar në shekullin e 21-të. Përveç periodikisht, grupimi i tyre bazohet në një karakteristikë të përbashkët poetike - puna e tyre fokusohet në trashëgiminë kulturore dhe shpirtërore. Autorët paraqiten në shumë kënde - nga njëra anë në lidhje me ngjarjet specifike që pasqyrohen në temë, dhe nga ana tjetër - përmes veçorive strukturore të veprave dhe mënyrave në të cilat faktorët e jashtëm ndërthuren me botën e brendshme të poetëve. Identifikohen edhe tema dhe komplete panevropiane, si çështja e Hamletit, por edhe tema tipike shqiptare, si besa. Gjithastu janë cituar opinione të kritikës letrare shqiptare dhe të huaj, por autorja mbështetet kryesisht në analizën e saj, gjë që e bën këtë pjesë origjinale dhe të frytshme.

Në këtë grup bëjnë pjesë edhe poetet, pasi poezia e krijuar nga gratë është një fenomen krejtësisht i ri. Gruaja nga muza bëhet artiste dhe kjo lidhet me fenomenin e përgjithshëm të emancipimit dhe pavarësisë së gruas. Pikërisht, dekada e fundit e shekullit të 20-të ishte periudha në të cilën poezia e grave u shfaq si një risi në letërsi. Në shoqërinë patriarkale shqiptare, gratë protestojnë kundër pozitës së tyre vartëse në shoqëri, por sjellin edhe nuanca të reja të buta në poezi. Një tjetër fenomen interesant - "letërsia e burgut", kontribuon në specifikat e periudhës. Në këtë grup përfshihen poetët e përndjekur politikë që shkruanë poezinë në burg. Punimet e tyre kanë qenë prej kohësh të panjohura për publikun dhe u bënë të disponueshme

STUDIMET PËR POEZINË SHQIPE NË KUADËR TË STUDIMEVE BALLKANIKE

Prof. Dr. Ekaterina Tarpomanova
Universiteti i Sofjes "Shën Klimenti i Ohrit", Bullgari



vetëm më vonë, në vitet '90.

Në grupin e dytë renditen autorët nga diaspora. Meqenëse shumë intelektualë detyrohen të largohen nga Kosova, ky grup është thelbësor për zhvillimin e përgjithshëm të poezisë kosovare. Krahas përvojave personale të autorëve në rrethana të vështira jetësore, poezitë ngrënë pyetje universale si kundërvënja midis së mirës dhe së keqes, së shëmtuarës dhe së bukurës, errësirës dhe dritës. Poezia e emigracionit është ilustruar me përmbledhjet poetike të Beqë Cufajt, të cilat pasqyrojnë temën e njeriut modern, por edhe temën e atdheut, motivet shoqërore dhe natyrore.

Grupi i tretë përfshin poetët kosovarë që përkthehen në gjuhë të tjera ballkanike. Si një vend me një traditë të vonë të shkruar

dhe të izoluar prej kohësh nga pjesa tjetër e botës, përkthimi i poezisë nga Kosova është lënë pas dore dhe është vonuar. Këtu nënvizohet roli kyç i qendrave akademike dhe universitare për prezantimin e poezisë kosovare para publikut bullgar. Autorja fokusohet kryesisht në përkthimet e Sabri Hamitit dhe Sali Bashotës.

Duhet theksuar se kjo qasje e strukturuar ndaj poezisë shqipe nga Kosova në fund të shekullit të 20-të jep një pasqyrë shumë të mirë të proceseve, dukurive dhe autorëve të periudhës së përzgjedhur.

Poetet përmes të cilëve Mimoza Hasani Pllana ilustron prirjet e letërsisë shqipe në Kosovë për atë periudhë dhe veprat e të cilëve ajo analizon janë si më poshtë:

Azem Shkreli: Nata e papagajve (1990), Lirikë me shi (1994), Zogj dhe gurë (1997).

Ali Podrimja: Zari (1990), Në bisht të sorrës (1994), Buzëqeshja në kafaz (1994), Ishulli Albania (1998).

Abdullah Konushevci: Të qenët të mosqenë (1990).

Beqë Cufaj, Balada budallaqe, Rilindja, Prishtinë, 1994.

Beqë Cufaj, 205, Dukagjini, Pejë, 1996.

Libri i lirisë. Zëri. Prishtinë

Din Mehmeti: Gjaku që këndon (1993), Prap fillimi (1996), Lumturia është mashtrim (1999).

Edi Shukriu: Zogu i zi (1995), Nënqielli (1990).

Fakete Rexha, Mal me Frymë, Rilindja, Prishtinë, 1990.

Fahredin Gunga: Shtrezet e fatësimi (1990), Gramatika e gjëllimit (1996).

M. Avdyli, I. Sylja, H. Hyseni, J. Januzaj, B. Kosumi, Libri i Lirisë, Zëri., Prishtinë, 1991.

Naime Beqiraj, Mbi Siparunt, Rilindja, Prishtinë, 1990.

Sabri Hamiti: Kaosmos, Melankolia, ABC.

Rrahman Dedaj: Dreqi nuk plaket (1991), Kryqëzim Hijesh (1997).

Xheraldina Buçinca Vula, A Street Cat, Sînga, Prishtinë, 1999.

Sipas autores Mimoza Hasani-Pllana, nga ky studim del se cilësitë e përbashkëta të të gjithë poetëve dhe veprave të paraqitura gërshtetohen për shkak të pranisë së situatave konfliktuale dhe kundërshtimeve publike, të cilat çojnë në krijimin e një emocionaliteti specifik. Ndryshimet vihen re jo aq në strukturë dhe stilistikë sa në tematikë të punimeve. Veçanërisht vihet theksi tek ndikimi socio-politik pas ndryshimeve në Jugosllavi. Sa i përket kontekstit ballkanik në të cilin krijohet poezia në Kosovë, autorja nënvizon se ajo tregon ngjashmëri, por edhe dallime domethënëse në krahasim me poezinë e vendeve të tjera të Ballkanit.

Si përfundim, studimi për poezinë e Kosovës në tri kontekste përmbledhë tendencat dhe dukuritë e letërsisë shqipe në Kosovë në fund të shekullit të 20-të. Për poetët e brezit tashmë të formuar doktorantja konstaton se për nga forma mbizotëron vargu i lirë dhe temat tradicionale dhe universale. Nga ana tjetër, poetët që debutuan në vitet '90 sjellin tema dhe imazhe të reja në poezi.

Edhe një herë poezia e gruas theksohet si një fenomen i ri jo vetëm në letërsi, por edhe si i lidhur me krijimin e një kauze të re dhe ndryshimin në jetën publike. Autorë emigrantë, poetët e përkthyer në dy vende ballkanike plotësojnë tablonë e përgjithshme të poezisë gjatë dekadës.

Mimoza Hasani-Pllana

POEZIA E KOSOVËS NË TRI KONTEKSTE (1990-1999)



Onufri

Ribotimi i romanit “Gryka e kohës: Nji histori mbulue me shall” është një lajm i mirë për letërsinë e tashme shqipe. Është lajm i mirë, sepse lexuesit të sotëm i rikthehet në tavolinën shpirtërore një roman i botuar në vitin 1994, i shkruar bukur, por për të cilin mund të mos ketë dëgjuar aq shumë.

“Gryka e kohës: një histori mbulue me shall” është romani i parë dhe i vetëm i Migjen Kelmendit, shkrimtar, përkthyes, publicist e solist, një nga ikonat më të vlershme kulturore të qytetit të Prishtinës. Një figurë poliedrike që i ka munguar zhvillimeve aktuale në fushën e artit të shkruar bukur.

Romani në fjalë për herë të parë u botua nga shtëpia botuese “Dukagjini” në shqipen e njësuar, ndërsa ribotimi i tij nga “UET press” i Tiranës vjen në dialektin e gegshqipes, madje me një përdorim tejet personal të dialektit nga autori dhe një gjë e tillë në zhargonin e gjuhësisë quhet idiolekt.

“Gryka...” është një roman për kohën, kujtesën, ndryshimet shoqërore e kulturore, identitetin dhe përballjen e njeriut me mundësitë e vogla dhe telashet e mëdha. Është një roman që të rrëmben dhe nuk të lë të qetë deri në sekuencën e fundit. Një rrëfim që t’i shpalosë befasitë e njëpasnjëshme, aq goditëse e aq të skalitura me një strukturë mjeshtërore të ndërtimit të situatave dhe karaktereve. Gjuha lakonike dhe përzjerja e reales me imagjinare i japin këtij romani një dimension të një vepre të veçantë letrare me një identitet të formësuar artistik.

Rugova, si zonë gjeografike dhe etnokulturore shqiptare, dhe shalli na shfaqen që në fillim të romanit, si dy shenja nistore prej nga nis jetë romani. Gryka është e Rugovës, koha e rugovasëve, shalli po ashtu. Rugovasi e romanit e kanë kohën që e masin sipas mënyrës së tyre dhe pas Luftës së Dytë Botërore ata sfidohen njëmendësisht nga koha e të tjerëve dhe koha e tyre sikur merr kuptim tjetër. Shalli është shenjë etnografike shqiptare, që e bartin burrat e kësaj zone, që përpos mbulojë e kokës është edhe qefin me të cilin mbështillet i vdekuri. Shalli është shenjë identitare e malësorëve, që tregon për relacionin e tyre me vdekjen, me kohën dhe jetën. Duke i pasur këto përbërës, ky roman i Kelmendit mund të cilësohet edhe si roman për Rugovën, vëndoriginin e tij, dhe një rrëfim idealizues për rugovasi.

Personazhi kryesor i romanit “Gryka...” është Arifi, një rugovas i rënë në Pejë, i shpërngulur nga malësia në qytet, në një ambient më ndryshe në të cilin koha nuk matet njëjtë si në grykën e malësorëve dhe shalli nuk mbetet gjithnjë i bardhë. Arifi përballet me ecejaket ekzistenciale të një njeriu të pamësuar aq mirë me një ambient në të cilin gjërat zhvillohen dhe ndryshojnë shpejtë, ku e bardha mund të mos jetë edhe aq e bardhë. Arifi është boshti i rrëfimit në këtë roman, si një njeri që pa vullnetin e tij i bie t’i shoh dhe t’i përjetojë ndryshimet e mëdha shoqërore që ndodhën në Pejë dhe Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore (LDB). Si një njeri që ka nevojë për punë dhe mbështetje ekzistenciale, punësohet te Menduh Ali Begi, pasunari më i madh i qytetit dhe njeri me kulturë të madhe, që i njihnte dhe kishte udhëtuar në vende të ndryshme të botës. Përmes portretizimit të figurës

“GRYKA...” E MIGJENIT

Nga Adil Olluri



së Menduh Ali Begit, “Gryka...” na shfaq aristocracinë e kohës në qytetin e Pejës para LDB, konkretisht para se të triumfonte revolucionit i kuq, viktimë e të cilit ishte Begi, që pushkatohet publikisht nga aradhet partizane, që ndryshojnë çdo gjë në këtë qytet. Një personazh episodik, por mjaft i veçantë, në këtë roman është e bija e Menduh Begit, Sofija. Ajo është figurë e vajzës së emancipuar dhe emancipuese, që përmes letrave që ua dërgonte qytetarëve të Pejës rriste ndikimin e saj për një jetë më të lirë e më të njerëzishme. Përmes personazhit të Sofijes, romani na flet për një elitë e aristokraci të kohës, që përpos kamjes, kishte edhe synime humane, që marrin fund me ardhjen e revolucionit komunist. Nga ky revolucion pëson edhe Arifi, i cili e kishte një dyqan të vogël (“bakallhane”), të marrë me qira nga Menduh Begi. Në syrin e pushtetarëve partizanë, ai shihet si një “kullak”, gjë që shkakton situatë absurde dhe paradoksale në vetvete.


“Kur pat mbërrirë revolucionin në Pejë, gjyshin tim e kish pas nxanë tue dashtë me e pague ratën e fundit të dugajës” (f.8).

Kështu fillon romani i Migjen Kelmendit dhe është një nga hyrjet më interesante në letërsinë e sotme shqipe. Një hyrje që ngjanë me ftohtësinë e absurdit dhe habinë me rëndomtësinë e çrëndomtësuar të njeriut përballë ndryshimeve dhe vlimeve të madhe kohore që ndryshojnë epokën me një të rënë të shpatës.

Ndryshimet e mëdha shoqërore shpjegohen si një lojë e bukur fjalësh me një lehtësi që të befason dhe të tërheq. Një shpjegim i tillë i ndryshimeve të tilla në këtë roman ndodh edhe përmes lojës së dy ekipeve të futbollit nga qyteti i Pejës, ndërmjet “Dukagjinit” dhe “Buduçnostit”. Para LDB-së gjithnjë fitonte ekipi i “Dukagjinit” dhe ishte mbizotërues i derbit të qytetit, ndërsa me ardhjen e komunistëve fiton “Buduçnosti”, madje për fitoren e këtij të fundit gëzohen edhe lojtarët e “Dukagjinit”, klub që i vihet dryni meqë konsiderohet si skuadër reaksionarësh. Një gjetje e bukur për të na shpalosur në mënyrë artistike ndryshimet shoqërore dhe politike me një

gjuhë të këndshme e tërheqëse.

Një kapitull i ri në këtë ribotim është rrëfimi për shpërnguljen e familjes së Shyqyri Gjakovës në Turqi, Izmir, menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (LDB), meqë, si të papërshtatshëm për revolucionarët e rinj, nuk kanë më të ardhme të ndritur e mirëqenie të natyrshme në Kosovë. Është një rrëfim për dramën e kosovarëve të persekutuar nga pushtetarët e kuq, të cilët kur arrijnë në Izmir detyrohen ta ndryshojnë mbiemrin e tyre dhe ta vendosin një mbiemër turk, pra të heqin dorë nga identiteti i tyre parak. Në kuadër të këtij kapitull është një rrëfim për dy gungaçët, episodik për roman, por mjaft i veçantë dhe tronditës për lexuesin. Dy fëmijë të Shyqyri Gjakovës, vëlla e motër, kanë gunga në shpinë dhe përmes letrave që ata ia dërgojnë njëri-tjetrit rrëfejnë për hjekinat, përqeshjet dhe përballjen e tyre me rrethin shoqëror. Rrëfimi për dy gungaçët mund ta prodhojë një roman të ri, meqë është i ngjizur si fryt të “Gryka...”, që është një gurrë për rrëfime të ndryshme e të larmishme që mund të dalin prej saj.



Hoteli Bahnhof, që përdorej tërësisht për refugjatët, ndodhej, siç e tregonte vetë emri, menjëherë në të dalë të stacionit të trenit të qytetit të huaj. Tingëllonte bukur, "Bahnhof" (çka të kujtonte edhe futbolistin e njohur Bonhof), po hoteli mund edhe të mos quhej ashtu dhe kjo nuk do të ndryshonte gjë në botë. Ai emër sikur rrekej ta fshihte blanën refugjatëse si petali një bubuzhel. Sidoqoftë, një hotel përfiton herë-herë një mundësi për më shumë kur emri "Grand" rri fshehur prapa derës, prapa të shkuarës më të lavdishme në kohë më aristokratike dhe më dekorative të lagjeve të qyteteve të mëdha. Çka nuk mund të thuhet për kushërinjtë e tij provincialë, *Asylheim*-et e shpërndara kudo, pothuaj nga një për çdo fshat gjermanishtfolës, edhe pse ato e përmbanin fjalën "shtëpi" në kuptimin më të ngrohtë të saj: *Heim*. Ishte emri i trishtuar "azil", kjo martesë e murrme mes Azisë dhe fjalës "rezil", që sillte diçka prej pleqërie kokallash dhe kolle mëngjesesh me çermë. Pleqëria nuk mënonte t'i futej tinëz edhe emrit hotel, megjithatë, duke iu bashkëngjitur pabesisht nga pas, kur ai s'e kish mendjen, në formën parazitare "pension", padrejtësisht ç'është e vërteta, sepse bujtësit e hotel-pensionit të refugjatëve te stacioni i trenit mund të ishin çdo gjë, po jo pleq. Po të mos llogaritje Ganiun nga Shqipëria, i cili po i riniste për të pestën herë procedurat për azil, në shtetin e katërt, ku herën e parë ish paraqitur si shqiptar nga Kosova. Por edhe Ganiu nuk ishte plak me vite, po me ajër. Ndoshta të qarët nëpër zyrat e intervistave e plakin vërtet njeriun, me helmin ngashënjes të zgjimit të mëshirës tek të tjerët. Ndarja e shqiptarëve në disa shtete ishte padrejtësi historike, po nuk mund të thoshe se nuk kishte edhe përparësitë e veta në çalltisjet azilore. Perëndia me një dorë të hedh, me tjetrën të pret, thoshte Ganiu.

Hoteli kishte tre kate, në të parin ishte një mence për mëngjesin dhe "zyrat", ku nuk vinte askush (pronarët e tij ishin vërtet të padukshëm), ndërsa në dy katet lart ishin dhomat e refugjatëve. Po hoteli mund të ish edhe pesë, apo edhe dykatësh, dhe kjo nuk do të ndryshonte gjësend në rendin e përbotshëm. Sikurse edhe bujtësit mund të ishin sa rumunë, po aq edhe shqiptarë, jugosllavë, turq apo moldavë, pa ndikuar një grimë në matricën gri teutone përjashta.

Shumica e trupave njerëzore do ta kenë diçka problematike, mjaft t'u japësh kohë, një veshkë të dhembur, një mëlçi të sëmurë, një zemër që përpëlitet apo mushkëri që lebetitet. Po njëlloj, shumica e qyteteve të Perëndimit kanë një zonë azilore, si sëmundje të fshehtë. Mosdëshira e tyre për ta përmendur atë plagëzonë është aq e ngjashme me diskrecionin mjekësor për sëmundjet.

E vetmja gjë jo e rastit në atë mes, ishte fakti që refugjatët, të cilët e mbanin këtë përcaktim si ushtari uniformë, pavarësisht motit dhe gjendjes shpirtërore, ishin një përfaqësim besnik i pjesës së botës që i prodhonte ata. Historia, dikur e diku, i zë vendin rastësisë. Mjaft t'i japësh popullatë të mjaftë. Dhe, meqë historia i ka zët përkufizimet, "refugjat" ishte një përcaktim që nuk pranonte të futej në asnjë përkufizim, duke iu bashkuar kësajsoj artit dhe dashurisë.

Industri që përplas qysh në emër (*hospitality*) mikpritjen me mjekimin, hoteleria konkurron me prostitucionin për nga vjetërsia. Një garë miqësore kjo, kurrë antagoniste, kurorëzuar nga përbashkimi ngadhënjes i tyre në shtëpinë publike, e cila e mban përcaktorin e vet social, "publike", përpara çdo njësie tjetër sado bamirëse qoftë kjo, strehë vorfnore, befotrof, kullë ngujimi, shtëpi fëmijësh apo shtëpi pleqsh. Asnjë zhvillim tregëtues, stërhollim në mbarështim, sofistikim në organizimin tashmë kibernetik me algoritme, inteligjencë artificiale, përcaktim çmimesh në kohë reale, fushatë reklamuese modeluar pas metodave më të përparuara të ekonomisë, apo sistem i integruar emrash, zinxhirësh të markave të njohura, nuk e ka zbehur karakterin parak të bujtinës dhe hanit, shtëpisë së mikut bujtës, *Gasthaus*-it, ku në fund të fundit më shumë se akomodimi, paguhet ndjenja e shtëpisë.

Nuk dihet cila specie ndërtoi strokullën e parë. Ai lloj me siguri është zhdukur tashmë, për të lënë një vazhdë të pakëputur filli Ariane që ndjek evolucionin në labirinthe e veta, në formën e lloj-lloj zgavrave, kufjeve të ngurtësuar të drurëve të pakohë, tuneleve me dy hyrje, ngrehinave më të ndërlikuara se Babeli të lloj-lloj insekteve, bletë, milingona, termite, mbledhjen dhe ngjeshjen e kashtave prej kumtri në krahë e sqetulla pemësh, fole për vezë të vjetra çprej dinozaurëve, përzierjen me baltë në raporte të përkryera ndërtimore në qoshe ballkonësh që lajmërojnë ardhjen e pranverës më mirë se çdo vëzhgues qielli... Ama dihet se specia që e shndërroi gjithë sa më sipër nga tregues natyre në biznes e zeje të ekonomizuar jemi ne, njerëzit. Ne mund pra të përcaktohem edhe si lloji që e shndërroi strofkën në bujtinë me pagesë. Nga bujtina fillestare, dhoma apo shpella e parë pa banor të përhershëm, po me një të huaj të përkohshëm me virytin e domosdoshëm të paguesit, e deri te zinxhirët e sotëm të emrave dhe markave të njohura të hotelierisë, Holiday Inn, Crowne Plaza, Hilton, Ramada, një pafundësi emrash që regëtojnë ftues në muzgjet udhëtimtare, ndanë autostradave, fshatrave të humbura, qytezave të drojtura apo metropoleve arrogante, aeroportëve të zhurmshme apo qyteteve të argëtimit mes shkretëtirave, shpirti tregëtar i zejes nuk humbi dhe as u transformua. Ata zinxhirë e kaplojnë planetin më

fragment nga romani i ri

HOTEL BAHNHOF

Nga Shkëlqim Çela

mirë se rrjeta e paraleleve dhe meridianëve. Si rryma elektrike alternative që gjallon mes dy poleve, në gjithë këtë rrjet me përmasa mamuthore, pulson energjia e gjeneruar nga dy nocionet që luajnë me ndjenjën njerëzore në një furkëzim dialektik: strehë dhe shtëpi, duke u përkëmbyer në një vibrim pa fund, pak njëra e pak tjetra, kurrë veç njëra apo veç tjetra, një fushë materiale drithërime, siç është tek e fundit e gjithë bota jonë.

Hoteli është një orvatje e dështuar për shtëpi, dhe një hotel refugjatësh e hidhtëson dështimin.

JC-ja ishte shtrirë në shtratin e dhomës së tij, nga ku dukej pjesërisht emri i hotelit, i ndërprerë nga drejtëndëshi i dritares – vetëm katër germa "l Bah", që sipas gjendjes shpirtërore, i vinin herë si fuga të Bach-ut, e herë si pasthirmë në shqipe. Kishte një gjysmë ore që rrinte i palëvizur, me letrën e parë nga Shqipëria në gjoks, letër nga e ëma, me bukurshkrimin e një brezi të vjetër që mund të shkruhej vetëm në papiruse. Nuk e kishte mbaruar dot letrën, kishte ngecur në frazën "nuk kam për kë gatuj më imam bajëlli tani", gjella e tij e parapëlqyer. Kurrëgjë tjetër nuk do ta dëftente më hidhtas vetminë sesa ai rresht. Armët e varura në mure të heronjve të vdekur, rrobat e tyre në musandra, nishanet e tujet e mbetura pas, gjithë ai xixëllim folklori dhe letërsie, nuk mbarnte dot në kthinat e murrmit as një të qindtën e pikëllimit amvisor e kulinar të asaj shkrete enësh gatimi, jamakesh e pirostish e magjesh e xhezvesh të zbrazëta, më të thata se një fyt beduini. E kishte parandjerë goditjen qëkur e ëma i dëftente se si i ati shkonte tek shtrati i tij dhe i merrte erë jastëkut që e ruante me fanatizëm erën e të birit, dhe se si ajo nuk e lëvizte librin që ai e kishte lënë te faqja 123, ndanë "jastëkut me erë", me shpresën se ai libër do të vazhdonte të lexohej më vonë, sigurisht, sigurisht, sigurisht, po të gjitha këto nuk e kishin dhimbjen e mprehtë prej ekzekutimi të fjalisë së shkruar ashtu si pa të keq. "Ti e di që babai është me pehriz, dhe unë nuk kam për kë gatuj më imam bajëlli tani." Një mijë tenxhere të aluminta, të hekurta, prej balte, të bakërta, kallajgërryera e vazhëzhitura, praktikisht e gjithë historia e zhvillimit dhe epokave njerëzore, duke kapërcyer bronzin statujor, u rrëzuan me rrapëllimë në ca dysheme fatale me igrasi kapilare, që quheshin thjesht "çimento", me rrezikun e vazhdueshëm për reumatizma, pra mbi të cilat nuk duhej shkuar zbatuar, po që tani bëheshin edhe dyshemetë e skenës më tragjike në botë, pa skena e dilema, pa të rrosh a të mos rrosh, vetëm furnella të këputura me fitilat njomur me lot në vend të vajgurit, ngaqë flaka s'duhej më. Ishte një zjarr primitiv që ishte shuar dhe që

nuk do ndizej dot më. Do të duhej të vinte vetë Prometeu! Me mëlçinë e shqyer. Prapë.

Të qarën e ndjeu më shumë se çdo herë tjetër në jetë, po të përjashtoj një e qarë në moshën më të vogël të mundshme për kujtesë, e qarë pellazge me mugull kombi në fyt, kur e ëma kishte ikur në punë tinëz tij, dhe ai e kish kuptuar këtë pak minuta më vonë, pasi e kishin gabuar me një rrotë biçiklete të të jatit që rrotullohej hipnotikisht e xixëllimthi mes telave mbajtës të hollë, tamam rrotë fati, dhe pastaj të kujtuarit e beftë për mungesën e së ëmës, ndjenja e prerjes në besë, një jetimëri e llojit të vet, e plotë edhe pse e shkurtër dhe jo e vërtetë. Ndërsa tani, pas atyre rrahëve të tepsive e tavave pa të ëmën, si pas vetëmashtrimit të saj në kthimet e tij vona nga "xhiroja" e traditës tiranase, kur imam bajëllia ngrohej tri herë, pas parandjenjës "ja, zëre se ka ardhur", parandjenjë që vërtetohej gjithnjë e dikur prej shpeshëtisë së ngrohjes së gjellës, pra thjesht prej ligjit të numrave të mëdhenj, duke harruar natyrisht herët e porealizuara më parë, për ta mbajtur gjallë bestytinën e shtrenjtë dhe shpërbluese: "Djalit tim e ndiej unë kur afron tek rruga e shtëpisë."

Ishte në këtë jerm kur te dera e dhomës së tij u dha Jari, i cili e pa një hop me dyshim, e pastaj u kujtua që kish diçka më të rëndësishme se pandehmat për shprehjen e fytyrës së tjetrit:

"Dua të më ndihmosh. Ti di anglisht?"

"Si është puna? Ndonjë dokument?"

"Jo, jo."

"Po çfarë?"

"Është njëra. Po ma luan rëndshëm. Këtu te stacioni. U çka duke parë. Më tha diçka, po s'e mora vesh. I thashë të më presë, edhe erdha vrap këtu."

"Po si i the? Ti vetë po thua që s'ia di gjuhën... Po a ia vlen të paktën?" murmuriti me përtim e sëkëlldi JC-ja.

"Off, është derr p... Hajde tani, se mos ikën."

"Nuk ikën ajo, jo. Ku do iki pa ty!"

"E ka kunj, po mbase i vjen treni."

"Po si rastise në të? Çfarë është, ku punon?" tha JC-ja duke mbyllur derën.

"Po ku e di unë, o burrë i dheut. Plus, çka më duhet mua çfarë është e ku punon. Unë s'jam shef kuadri."

Stacioni kishte fare pak lëvizje.

"Ja ku është," tha i emocionuar Jari duke ia bërë me dorë një vajze me fytyrë komunikuese dhe sy të zgjuar.

U afruan. Jari jepej herë i zhvidhosur e herë i shtrënguar fort në të gjitha pikat çerniere të skeletit.

"Këto vdesin për brunat," tha duke ruajtur fytyrën buzëqeshëse për vajzën dhe duke i përdorur duart më shumë se normalisht. Kur tha "këto" u drejtua me përkulje nga vajza, e cila po shikonte me një kureshti të përkorë.

"Ai të pëlqen ty," i tha JC-ja vajzës gjënë e vetme që iu duk se kish kuptim në atë situatë.

"Çfarë i the?" pyeti Jari gjithë i buzëqeshur.

"I thashë që të pëlqen."

"Thuaji që do me të q... ky shoku im," vazhdoi Jari me sigurinë e atij që e di se tjetri do ta nxjerrë matanë.

"Shoku im thotë se ti i pëlqen," tha prapë JC-ja, të vetmen gjë që mund të prodhonte në atë situatë.

"Kam pasur disa përvoja jo të mira me turqit," tha vajza.

"Ne nuk jemi turq," sqaroi me nxitim JC-ja, ndërsa në mend i vetëtiu që Jari ishte vërtet më brun se të tjerët. Domethënë, më ezmer.

"Çfarë tha, çfarë tha", pyeti Jari.

"Edhe me kurdë," plotësoi vajza.

"Nuk jemi as kurdë. Jemi shqiptarë."

Sqarimi nga JC-ja erdhi më i vendosur nga ç'e priste edhe ai vetë. Mundësia e përvojave të këqija me serbë priste pas gëmushës. Grekët ishin të pagjasë, po jo të pamundur. Një OKB e vërtetë përvojash të zonës juglindore me gadishuj të prapë.

"Albania, Albania," tha Jari duke bërë me dorë shenjën e lavdërimit, gishtat mbledhur bashkë me pëllëmbën kthyer lart. "Birinxi," shtoi me sa duket duke u përpjekur të thoshte në gjuhë të huaj fjalën "për së mbari".

"Mos thuaj ashtu, se sapo tha që ka qenë me turq, dhe s'ka kujtime të mira prej tyre. Edhe mbase e di atë fjalën që sapo përdore."

"No problem, no problem," shpejtoi të plotësojë Jari duke e shtuar buzëqeshjen në kufirin e dhembjes.

Një tren erdhi si shpëtim. U kuptua që ky ishte treni i saj.

"Thuaji që nesër po këtu. Këtu. Kjo orë."

"Mos ma trego orën mua, se di shqip," tha JC-ja i bezdisur.

E pyeti vajzën e huaj nëse ajo do të ishte përsëri të nesërmen aty.

"Po, këtë rrugë e bëj për ditë," tha ajo.

Duart e Jarit thanë më shumë se goja e tij që ai të nesërmen do të ishte prapë aty. Aty. Aty. Nesër. Krahët dëftenin kohëhapësirën në pantomimën me të lektisur të atij stacioni treni. Kurbat më të rëndësishme të gravitetit. Që shpjegojnë më thjesht relativitetin.

"E gatitme njëqind përqind," tha teksa po ktheheshin në hotel. "E murrme fund! E pe?"

Një imam bajëlli filloi të avullonte në mënyrë pavetore. Domethënë, pavendore. Patëllxhanë të çarë që tani u ngjanin vaginave. Mbushur me të përbrendshme në fermentim. Hallall, i erdhi JC-së në mendje fjala diversioniste, kundër dëshirës dhe pa e ditur se kujt po i drejtohej me vete. *Hall all.*

SHKËLQIM ÇELA

Hotel Bahnhof



Onufri Roman

ULËRIMA

Ai vinte gjithmonë në të njëjtën kohë. Tamam kur “dielli - balonë mbushur me lëng të kuq trëndafilash diku çahet majave të Kepit” dhe kur “Ylli i Mbrëmjes me et toreadori si me pelerinë të kuqe ndilte demin - hënë” (kështu shkruaja në një poezi të atëhershme). Domethënë Ai vinte kur dielli ikte. Sikur donte t’ia zinte vendin. I hirtë, i pa formë, tinëzar vinte nga kushedi se ku, kaptonte Kepin dhe i vërsulej fshatit të vogël struktur nën sjetullat e maleve. Unë dhe miku im e ndjenim të parët afrimin e Tij. Ndoshta sepse vetëm ne ishim të pagjumë në këtë fshat të largët. Ndoshta sepse kishim muaj të tërë larg të dashurve tanë. Ndoshta për një mijë e një arsye të tjera të panjohura prej nesh.

“Të ikim se erdhi Ai”, thoshte miku im.

Po ku të fshiheshim? Ai ishte si ajri, si mjegulla: hynte gjithkund dhe na gjente. Mandej peshonte mbi mushkëritë. Më i rëndë se malet përreth. Atëherë shfityroheshim të dy. Sidomos miku im.

“Ulërij”, më thoshte, “nxisrë ankthin përjashta, se ndryshe do të çmendesh”, dhe vetë ulërinte më fort se bisha e zënë në çark.

Unë heshtja më pranë çmendurisë se kurrë.

“Ulërij!”, thërriste miku im.

“Nuk di”, përgjigjesha unë.

“Ulërij!”

“Nuk mundem”.

“Ulërij!!!”

“Nuk më lënë”.

Mandej Ai ikte dhe ne merrnim frymë thellë, sikur në atë çast të kishim dalë nga fundi i oqeanit.

Vite më vonë fillova edhe unë të ulërij. Veçse sipas mënyrës sime: duke shkruar tregime.

1992

BORXHI

Para disa kohësh i mora pak pará hua shitësit në qoshe të rrugës sime. Të nesërmen shkova ta laj borxhin, por shitësi nuk ndodhej aty. Ditën tjetër shitësi ndodhej aty, por unë s’i kisha paratë me vete.

“Nuk prish punë”, tha ai, “kur t’i kesh”.

Ditën e tretë shitësi ndodhej aty dhe unë i kisha me vete paratë, por ato mu deshën. Ditën e katërt shitësi ndodhej aty, paratë që i kisha me vete nuk më duheshin gjë, por mu duk krejt absurde t’ia shlyeja një borxh të vogël atij që fitonte miliona.

Ditën e pestë dhe më pas, sa herë që i afrohem qoshes, ndërroj rrugë.

Dhe vonohem për aty ku jam nisur.

ZINXHIRI KËPUTUR

Dita ishte e kthjellët dhe të gjithë thanë se nata do të ishte me hënë.

Hëna kishte një unazë si prej platinë rreth vetes dhe shumëkush tha se të nesërmen do të binte shi.

Të nesërmen ra shi dhe peshkatarët thanë se do të kishin gjueti të mbarë.

Peshkatarët dolën në det të hapur dhe askush nuk qe i sigurt për kthimin e tyre.

PËRRALLA

Ashtu si çdo natë, edhe mbrëmë im bir, Erosi, më kërkoi një përrallë. Unë që kisha lexuar një mijë libra me përralla (të paktën), unë që fitoja çmime për përrallat që u rrëfeja të tjerëve, u ndodha keq në ato çaste: nuk më kujtohej asnjë përrallë, asnjë për bé. Kisha njëqind net që mbrëmje për mbrëmje i tregoja nga një përrallë Erosit tim dhe tash gjendesha krejt bosh: si guaskë perlë-vjedhur, si minierë e shfrytëzuar etj., etj. Ndërsa im bir priste, unë gërmoja në kujtesë, gërmoja mundimshëm, por më kot: asgjë nuk nxirra prej aty. Kujtesa ime ishte një pllajë e ngrirë, e hirtë, ku asgjë nuk gjallonte.

Atëherë thashë të sajoj vetë një përrallë, siç kisha bërë në jo pak raste gjatë njëqind netëve të kaluara. Gjeta Fabulën, përcaktova Personazhet kryesorë që do ta vinin në lëvizje atë, dhe u bëra gati t’ia filloja Rrëfimit. Por dështova përsëri: diçka e rëndësishme, serioze dhe, ndoshta, e pariparueshme qe ndryshkur brenda meje. Atëherë vendosa të përdor djallëzinë, siç bëjmë gjithmonë kur ndjejmë dështimin pranë: i propozova tim biri ndërrim rolesh: domethënë ai të tregonte një përrallë, ndërsa unë të dëgjoja.

Ashtu siç edhe pritej, im bir ra në kurthin e ngritur prej

HISTORI TË THJESHTA, KREJT TË THJESHTA

Nga Ridvan Dibra

meje dhe gjithçka shkoi mirë e bukur. Ai demonstroi një kujtesë fenomenale dhe një talent të mrekullueshëm në rrëfim.

Veçse të nesërmen, me t’u ngritur nga gjumi, shkova në bibliotekën time dhe tërhoqa një libër të trashë përrallash. Ndërsa në vendin bosh vura do libra të Kafkës dhe të Niçes, të cilët i kisha mbajtur njëqind net nën jastëk.

Nuk e di se kur do t’ua ndërroj përsëri vendin librave: domethënë kur do të heq prej nën-jastëku librin e trashë të përrallave dhe të vë aty Kafkën e Niçen.

Ndoshta nesër.

Ndoshta kurrë.

NË DISKO

Në disko, nën ritmin e muzikës (si nën një breshër vjeshte), të gjithë ndihemi të barabartë: edhe unë i mbytur në mëkate (pa dyshim!), edhe adoleshentja e pa puthur (ndoshta?).

Në të hyrë,

fill mbas derës,

kemi zbatuar shpirtrat.

SHIGJETA

Shigjeta, me objektiv zemrën, tashmë është nisur drejt teje. Natyrisht, ti nuk e sheh atë, por e ndjen afrimin e saj përmes do dridhjeve të lehta të ajrit. Provon t’i largohesh, t’i fshihesh asaj nëpër do tunele të ftohtë e të lagësht që i ngre vetë brenda një nate, por shpejt e kupton se mbrojtje të tilla janë krejt të pasigurta, krejt iluzione: shigjeta e ka të paracaktuar objektivin e saj - zemrën tënde, dhe asgjë s’mund ta ndalojë për të arritur në cak.

Nxjerrja e këtij përfundimi qe fatale për ty. Tashmë të gjithë njerëzit që afrohen drejt teje kanë trajtën e shigjetës.



Ajo të shfaqet çdo natë nëpër ëndrra dhe gjumin ta kthen në torturë.

Hapësira bëhet për ty një arenë e madhe ku shkojnë e vijnë vetëm shigjeta, të gjitha me caqe të paracaktuara. Dhe ndodh të dendësohen aq shumë, sa ta zënë edhe diellin. Përitur, tamam atëherë kur nuk e pret, të vihen në ndihmë do aleatë të cilët ti, pak kohë më parë, jo vetëm që s’i kishe konsideruar si të tillë por, për disa arsye krejt jashtë teje, i kishe futur në radhët e armiqve të tu. Fjala është për gjëra krejt të thjeshta e të përditshme:

një zog në fluturim;

një përhëndetje nga një i panjohur;

një dorë e ngritur fëmije;

një puthje femre;

një kafe me një mik të dikurshëm... e të tjera që në çast nuk të kujtohen.

Ti vë re i mahnitur se këto gjëra të brishta e të pafuqishme kanë efekt mbi shigjetën tënde më shumë se tunelet e betonit, brenda të cilëve provove të ndryshme për shumë kohë.

Natyrisht, ti nuk pretendon që gjërat e thjeshta e të brishta ta rrëzojnë përdhë shigjetën dhe as ta shmangin nga caku. Por thjesht t’i bëjnë një farë qëndrese, ta vonojnë sadopak mbërritjen e saj. Që ti të kesh kohë e mundësi të shpresosh në arritjen e disa objektivave, të cilat para disa kohësh, domethënë atëherë kur konstatove praninë e shigjetës, të dukeshin krejt të pamundura.

Fjala është për do objektiva krejt të thjeshta:

sajimi i një ëndrre;

një natë me gjumë pa ëndrra me shigjeta... e të tjera që në çast nuk të kujtohen.

ZOGU

Që në verë i kam premtuar tim biri se me të rënë dëbora e parë do t’i zë një zog të bukur e të rrallë.

Erdhi dimri dhe ra dëbora e parë. Me të filluar ajo, im bir ma kujton premtimin e dhënë, çka do të thotë se ai qe përpjekur ndoshta çdo ditë ta zinte vetë zogun e premtuar, por s’ia kishte arritur. Tashti të gjitha shpresat i ka varur tek unë. Unë pastroj dëborën para shtëpisë, hedh disa kokrra misri në tokën e zezë, vë trinën përsipër një shkopi, lidh spangon dhe përgjoj që pas dritares. Pranë kam djalin, zemra e të cilit është zogu i premtuar. Në dorë mbaj spangon dhe pres çastin e dëshiruar. Ai nuk vonon: një zog pushon për pak çaste mbi trinë, mandej ulet në tokën e zezë dhe çukit kokrrat e verdha. Është tamam momenti! Tërheq me vrull spangon dhe trina bie mbi zogun. Është zogu i premtuar.

Zogu i rritur në gjoksin e djalit tim. Së bashku me të dalim me vrap përjashta dhe i afrohem trinës. Pak pa e prekur atë, zogu gjen një vrimë dhe del jashtë. Ne ndjekim fluturimin e tij derisa bëhet njollë e hirtë dhe zhduket në hapësirë. Duke tërhequr këmbët zvarrë, unë dhe im bir hymë brenda në shtëpi. Gruaja afrohet dhe më thotë:

- E pe? Një zog i bukur dhe i rrallë sapo doli jashtë nga dhoma e djalit.

MËNGJES

Është një mëngjes i bezdisshëm si grip. Dhe kaq. Kur, befas, shoh në trotuarin përballë një vajzë të bukur me të cilën jam njohur dikur.

Pres rrugën dhe i dal përpara. Por vajza kalon pa më vënë re. Unë ndihem njëloj si dje kur kërkova në të gjithë shtëpinë dhe s’gjeta asnjë kokërr aspirinë.

Dhe kaq.

SFERA

Sapo u zgjove dhe hape sytë, ti e pe veten brenda një sfere prej një materiali të papërcaktuar por, fatmirësisht, të tejdukshëm. Ti s’mund të dilje jashtë saj, ashtu siç nuk mund të hynte brenda ndokush tjetër. Shpejt ti konstatove se sfera nuk i ruante përherë të njëjtat përmasa. Në më të shumtën e rasteve ajo e kishte diametrin sa lartësia jote, por ndodhte dhe që rritej pambarimisht. Atëherë ty të krijohet ndjesia sikur, më në fund, kishe dalë jashtë sferës së mallkuar. Por shpejt e kuptoje se bëhej fjalë thjesht për iluzione, rob i të cilëve kishe dëshirë të bije. Sepse rrallimin e ajrit brenda saj e dëshmonin zogjtë e hutuar që shkapeteshin njëri me tjetrin, lulet që vyshkeshin në stinën e çeljes, e plot shenja të tjera të cilat ti, hëpërhë, nuk ishe në gjendje t’i dalloje.

Tashmë ke filluar të mësohesh me sferën tënde. Për të kujtohesh vetëm atëherë kur dëgjohet një si tringëllimë e qelqtë, çka dëshmon se ajo është përplasur me një tjetër sferë.

URA PREJ DRITE

Nga Visar Zhiti

Duke lexuar librin më të ri të poetit Ndue Ukaj, poezia më përhitet si një urë rrezëllitëse në ajër, që bashkon brigjet e ngjarjeve me të emocioneve, që të çon nga një e dikurshme tronditëse te një shpresë e paqtë, nga një trishtim plot me lule te një e shtunë me lojna fëmijësh, nga një humbje te një stinë me kambana, nga një dhembje në një ringjallje, nga një tjetër dhembje te një tjetër dhembje, nga vetja te tjetri, nga tjetri te vetja, një udhëtim metaforik nga vetja për te vetja, që janë të ndryshme. Se njëra p.sh. e përjeton poezinë e jetës dhe tjetra e shkruan atë.

Në mesin e kësaj ure prej drite duket sikur bashkohen dy vetvetet, të nisura nga brigjet përkundraill njëri tjetrit. Prandaj dhe shkruajmë:

*Që kur u dashurova me letërsinë,
kam provuar të shkruaj një poezi a tregim
të mbrothur me personazhe të hijshme dhe të urta
që flasin vetëm për gjëra të bukura e horizonte të reja
dhe s'duan të dëgjojnë për shëmti, rrengje, mërzi.*

Kjo është dhe *credo*-ja e poetit. Zanafilla është dashuri. Pa të cilën nuk mund të shkruhet. Po kur e ndjeu? Si, ku? S'ka rëndësi, në fëmijëri apo në rininë e parë, nën yje a ndanë plagëve, tani... a nesër...? Teksa braktiste romantizmin, duke mbetur romantik i trullit amë, duke ngjitur shkallë e duke mbërritur në agshole. E sigurtë është që kjo dashuri ka qenë para se të lindësh.

Dhe të shkruarit, sipas poetit, është *provë*. Kështu besoj dhe unë, është një provë pa mbarim, një dëshirë që nuk të ndahet, se nuk përmbushet dhe ashtu duhet të jetë, një e folur për të bukurën dhe risitë e saj, të ngjashme me avitjet e horizonteve duke iu shmangur të dëgjuarit për shëmti, rrengje, kujë e jo më të vepruarit asisoj.

Një refuzim ky që ka brenda pranimin e detyruar dhe përkushtimin qytetar. Na vërsulet realiteti dhe me të këqijat e veta, që duhen përballuar. Dhe duhet punuar që realitetin ta mbushë e mira...

E në fund të fundit dëshmi e kësaj përpjekje a vetë përpjekja është të shkruarit: *një poezi a tregim*. A një urë mes tyre...

I.

Në vazhdim të traditës më të mirë të letrave në Kosovë, të poezisë që lëvrohet, sa kombëtare po aq dhe europiane, të prozës me arritje të begata, Ndue Ukaj, do të thosha sikur bën më ndjeshëm *provën* e një bashkimi, sa modern, po aq dhe parak, të poezisë me prozën, ku autori ka origjinalitetin e tij.

Ashtu siç e shtrir vargun në formën e rreshtit, nga që e ndjen se ka për të thënë, flet dhe me ritmet e prozës, por më shumë të përditshmërisë meditative dhe tregon një ngjarje që ka ndodhur, po ndodh ose do të ndodhë, nuk e përfundon, duket sikur i lë aty në mesin e urës prej drite, por të ndërthurur me ndjesi të tjera, ku urtësia përzihet me shqetësimin, metafora me gjurmët e hapave, një zog me fatin e atdheut, etj, etj.

Përgjithësisht poezia ka një frymë biblike, të kujton diçka uitmaniane dhe vazhdimet, stilin e poetëve moderne bashkëkohore europiane e amerikane, poezi e shekullit XXI, qëndresë estetike e hapur ndaj tjetërsimit duke e përcjellë me fladët e dijes mbi gjendjet në rrethana të ndryshme të ditës, të natës dhe të së gjithmontës.

Poezi shqipe me kumtet e vendlindjes...

II.

Ajo që më duket thelbësore në këtë përmbledhje, është ndjesia e fortë e rrëfimit, si një domosdoshmëri, si në një altar. Dhe ky altar, aq sa është prej guri e druri të vendit, po aq është dhe vetvetja ose lexuesi, njëllor intime janë për poetin...

Ai i gëzohet jetës, bashkë me natyrën përreth. Jeta është në natyrë dhe natyra është në jetë:

*zgjohem si një pemë e gjallëruar ku cicërojnë zogj të gëzuar.

Dhe cakërojnë një gotë për ditën e re,
për zgjimin e ri me muzikë të përzgjedhur dhe
parfum natyre.*

Poeti gjen shumë paralele ngazëllimi dhe harmonie dhe shkrirje me një si peng e brengë. Duhet kërkuar në kujtesën kolektive. Ka variacione mbi temat, përsëritje që s'janë përsëritje dhe poezia e re duket sikur vazhdon një tjetër që sapo e lexove, është përjetimi që i bën të tilla, një poemë, ku i besohet përjetimit dhe në antiteza, edhe kur ka ironi, gjithmonë për mirë.

...dhe kam mësuar se në vetmi s'vezullon asgjë.

Asgjë e mirë nuk vjen pa një besim të madh te e mira, pa dashurinë, e cila, siç thotë dhe shenjtja jonë Nënë Tereza, fillon te shtëpia jote. Poeti i këndon gruas, fëmijëve, ëndrrës, i këndon këngës, teksa ecën në urën prej drite.

III.

Në poezinë e Ndue Ukajt gjej një frymë të shëndetshme katolike, e shpërndarë dhe e kthyer në përdëllim, në porosi dhe identitet. Patjetër dhe në dashuri e përndritje.

Poezia shqipe, sidomos kjo e reja, e ka të ndjeshme një mungesë të tillë, thënë hapur, frymë katolike. Për rrethana të kohës, në fillimet e rilindjes së vonë kombëtare, u ngrit me të drejtë si fe shqiptarizma, megjithëse letrat shqipe kanë në gjenezë dhe

fragment nga libri i ri

RETË PREJ
DRITE

Nga Ndue Ukaj

një shkrimtar si Pjetër Bogdani me *Cuneus Prophetarum*, "Çeta e Profetëve". Po kështu te poezia e Naim Frashërit është besimi, Zoti, patjetër dhe heronjtë e bektashizmit, së cilës dhe i përkiste, ndërsa te At' Gjergj Fishta, më shumë se te Naimi, ka vepra të tëra letrare, me frymë fetare katolike. Te Lasgushi ka misticizëm, ndërsa poezia shqipe e gjysmës së dytë të Shekullit XX, e shtrënguar në metodën e socrealizmit, u bë, guxoj të them, e pa shpirt, dha një ateizëm mizor, ndërkaq i shpalli luftë Krijuesit të madh, që paradoksalisht do të thotë se e pranonte që ishte. Kultura kristiane është njëra nga kolonat kryesore ku është mbështetur Bashkim i Europian, ndërsa kolona tjetër është kultura e antikitetit grek dhe romak, ajo demokraci e drejtpërdrejtë dhe konceptet e një drejtësie themeltare.

Poezia në vetvete është e përshtatshme, dhembje dhe drejtësi shpirti, madje ka frymën e lutjes, është një lloj lutjeve ashtu si lutjet që janë dhe poezi, kam shkruar diku. Dhe predikimet e Krishtit kanë magjepsjen e poezisë, aq sa Noli në një botim të tijin në anglisht "The Poet of Nazareth" e quan poet të madh Krishtin dhe thënie të tij i ka trajtuar si poezi.

Poezia gjithësesi është ringjallje, atë frymë sjell, të pavdirë. Në poezinë e Ndue Ukajt ka një rrekje kësisoj, një rikthim poetik te kjo vlerë, te kristianizmi i hershëm i shqiptarëve, në formë të re ashtu si arkitektura modern në disa kisha sot.

*...vargjet dhe poezitë i hedh në ajër
si prifti temjanin para një meshe solemne të dashurisë.*

Është misioni i shenjtë i poetit. Prandaj në poezinë Ndue Ukajt gjetëm si kishte altar. Ka shenjtër, Adam, gjarpër të Evës, Mesi, por dhe Kain, pashkë, Via Dolorosa e katedrale, shkëlqim të Gjergj Kastriot, kambanat e përzishme të 17 Janarit dhe Pal Engjëll dhe bekim të gjuhës shqipe.

Ndërkaq shqiptarët janë populli emblemantik i harmonisë fetare. Gjë që konvertohet dhe në poezi. Poezia është kryqi ku mbërthehet poeti.

O kryq që duron kaq shumë mëkate të gozhdohen në ty.

Në vazhdim të rrëfimit në altarin e poezisë, poeti nuk nguron të flasë për mëkat, që më shumë është i realitetit djallëzor, i shpërndarë nëpër të tjerë dhe ai e ndjen si të tijin siç ndjehet i botës dhe vetë. Poeti është dhe kryqi i vetvetes.

Duke shfletuar këtë libër, i ndjejmë ato psherëtimet e rënkime, rishohim plagët, të cilat nata bën që të përzejen me yjet, teksa trupi i rënduar bie poshtë, në baltën amë, ndërsa qiejve lart ikën shpirti. Poezia. Ura prej drite që bashkon Tokën me Qiellin.

*Bloomindale, Chicago,
fundvere 2020*



Gjithçka duket e bardhë

Mëngjesi i bardhë,
me ëndrra të bardha,
lule të bardha
re të bardha
kopsht të bardhë
pëllumba të bardhë.

Në mes,
tavolina e bardhë
fleta e bardhë
dhe lapsi shumëngjyrësh.

Korbi në dritare
dhe mërzitë e zeza.

Llurbë fjalësh.
Llurbë mendimesh.
Unë gërmoj diçka.
Ç'të shkruaj?

Një batanije me ngjyra
është përpara meje
Kë të mbështjell unë me të?
Ç'të shkruaj?
Oh qiell,
qiell i hutuar dhe dritëplotë
dhe ju lumenj të mrekullueshëm
ku jeni nisë
në këto orë të vona të kalendarit të pështjelluar?

Gjërat janë pak më mirë seç duket,
livadhet janë pak më të gjelbra seç thuhet
edhe frute ka pak më shumë seç flitet.
Por ti këmbëngul dhe thua
gjithçka ka pak,
përveç frikës që është shumë.
Kjo aromë algësh deti
tregon se anijet e fatit janë të trazuara
dhe nesër duhet të planifikojmë stinën e stuhisë.

Agoni

Dita e fundit e muajit maj,
për miliona ishte e zakonshme
dhe e pazakonshme për shumë të tjerë,
siç janë vërtet shumë gjëra në jetë.
U zgjova prej gjumi i drobitur
dhe u ndala nën pemën e dashurisë.
Mes gjethesh dhe aromash mahnitëse,
u përdroddha,
piva vërë dhe hëngra ullinj.
Pastaj grimcova histori dhe ëndrra të shumta.
Të gjitha i grimcova si thnegla
dhe i lashë gati për darkën kremtore.

Sepse e gjithë historia në copëza të vogla është grimcuar.

Por ajo ditë u vonua.
Më parë erdhi shiu,
stuhia e qetë dhe u lava në të,
si në ujëra të turbullta kohësh.

Pastaj toka u mbush me fruta të zinj
që u shpërndanë në kopshtin tim,
siç shpërndahet furishëm vetëtimat dhe mërzia.

Kur goditi rrufeja
isha në këshqjellën e fjalëve,
mes harqesh të bukura dhe dekorimesh mjeshtërore
dëgjova tingujt e një koncerti me piano.

Veshët s'munda t'i mbyllja. Kishte hukamë.
S'mund të mos dëgjoja krrokamat e korbave të zi.
Agonia zgjati gjatë.

Si dikur edhe sot

Ka njerëz që dergjen në ferr
bluhën nga politika
të tillë që udhëtojnë nëpër qiejt e haresë
dhe të tillë që lidhen në litarin e pushtetit
e tërhiqen drejt botës së skëterrës.
Ka të tillë që presin para kontinentit të shpresës
dhe frikësohen t'i hapin portat e mbyllura.
Sepse frikësohen nga paqartësitë, të papriturat.
Unë pas kaq shumë vitesh bredhesh

i shastisur shoh gjethet e mia vjeshtake
si duart e një dashurie përvëluese.

Po ç'bëhet me baltën tjetër,
atë të ndërgjegjes së atyre
që kanë lidhë litarët e mashtrimit
dhe tërheqin zvarrë nga stina në stinë.
Ata që kanë mësuar artin e ulërimave,
lavdi kërkuesit që krrokatin si korba të zinj.
Ato korba i hanë gjethet e kësaj stine;
i hanë edhe sytë e kohës - O Zot!

"Kam etje" - tha Krishti para se të vdiste në kryq.
Por atij askush s'i dha ujë.
Atij i dhanë helm.
Sa shumë helm na japin,
përditë,
o Imzot!

Mos u mërzit me këtë mjegull

Që vërtitet nëpër qiell tash e sa kohë,
si i hutuari që humb rrugë në një pyll
të trazuar ndjenjash dhe s'di kah ia mban.

Pa shtigje është koha, pa shtigje jemi unë e ti.
Vijmë dhe s'dimë kah shkojmë.
Në këtë zbrazëti ku krijohen mirazhe paqartësi që s'i dua.
Jo, s'i do as ti.
Është mjegull, por ti s'duhet të mërzitesh.
Gjërat do të ndryshojnë
dhe faqet e zeza të këtij libri do të kalohen.
Edhe pylli do të pastrohet
dhe ne do të ecim dorë për dorë e të gëzuar si kurrë më
parë.

Në gishtat mund të mbetet ndonjë njollë,
por shiu i pastrimit do të bjerë shpejt
dhe mund të shlyejë gjithçka që duket.

Por çka të bëj me ato që s'duken - thashë
dhe të këqyra në sy të ëmbël ku zbutet pezmi im,
dhe përnjëherë hapen shtigje, siç hapet qielli kur davariten
retë.

Ku të arratisem unë?
E mbaj veten si fëmijën e porsa mësuar me hapat e parë të
jetës.
Më duhet ta shtrëngo, j
të mos enden ndjenjat e mia si re të zeza në këtë shtegtim
nate.

Trupi im është i lodhur nga bredhja.
Më duket vetja si ai burri në rrëfimet e biblike
që donte të hynte në tokën e premtuar
dhe të fillonte rrëfimin e ri.

Kah t'ia mbaj në këtë stinë zbrazëti,
kur rrugët ndahen si hija e mendimeve
në një mëngjes amorf.

Në orën e muzikës

Mësuesja e muzikës duart i ka të buta.
Ajo s'është balerinë, por lëviz si në një shfaqje baleti.
Dhe sa herë i lëviz sytë nëpër duart e mia,
ato i përshkon një diell i fortë.

Ajo kishte mësuar prej nënës së saj
se dritaret e hapura të sjellin fat
dhe perandorinë madhështore të tingujve,
ndaj i donte zogjtë dhe muzikën e tyre.

Por në stinën tonë - i them unë - njerëzit kanë frikë nga zogjtë
dhe tingujt e tyre të pafajshëm.

Është vjeshtë dhe njerëzit vyshken.

Por mësuesja e muzikës i shpërfill mendimet e mia
dhe krijon tingujt e një simfoni gazmore,
që në dhomë shkakton tërmet lumturie.

Unë i tregoj se gishtat e mi i ka thy një kohë e keqe
dhe dridhen. Por ajo më lut të mësoj gjuhën e pianos,
sepse perandorinë e zogjve dhe të muzikës
s'mund t'i pushtojë askush.

fragment nga libri i ri

QORTIMET E ZOTIT SHYTI

Nga Ardian Vehbiu

Z. SHYTI NUK PRANON ESENCËN E VET KOMIKE

Kur mbarova leksionin mbrëmë tek Universiteti i Bushatllinjve, tha z. Shyti, m'u afrua një tip nga publiku dhe më tha: na kënaq, z. Shyti, me humorin e hollë. Dhe nuk është hera e parë që më ndodh kështu. Edhe në Durrës, kur mbajta fjalën e hapjes te galeria *Interklub*, më thanë: rrofsh, z. Shyti, se kishim kohë pa qeshur kështu.

Njerëzit të duan, z. Shyti, thamë ne. Njerëzit, njerëzit, shfryu z. Shyti, ç'a më duan njerëzit - unë nuk vete në këto ngjarje për t'i zbavitur njerëzit, as për karagjozllëqe; kam gjëra serioze dhe problematike për të diskutuar, gjëra të tilla që marrin në pyetje themelet e dijes. Ndërsa këta më thonë: gallatë e madhe, u shqyem gazit, z. Shyti, nuk ka si ti. Më ngatërrojnë me ndonjë aktor estrade më duket.

Humori dhe dija ecin ndonjëherë të kapur për dorë, thamë ne. Ndonjëherë e më të rrallë, tha z. Shyti, por mua nuk më pëlqen, kur të tjerët qeshin, pa e kuptuar unë pse. Më lind dyshimi: mos më ka dalë gjë nami si komik dhe tani ka hajvanë që nuk e mbajnë dot gazin, sapo më shohin? Dhe sikur ky dyshim të mos mjaftonte, tani që kam frikë se mos më marrin për shakaxhi, po filloj të kujdesem që t'i heq të gjitha ironitë, të gjithë thumbat, të gjitha hokat nga leksionet dhe fjalimet e mia: dua të më marrin seriozisht deri në fund dhe të vrasin mendjen thellë për çfarë po u them. Ashtu edhe po më ikën shija e vetes. Mos e tepron pak tani, z. Shyti, thamë ne; një orator i mirë gjithnjë e ka merak që edhe ta dëfryjë publikun dhe, duke e dëfryer, t'ua përcjellë mesazhin. Flisni kot, tha z. Shyti, madje nuk e keni idenë se çfarë po më ndodh: javës që shkoi, kur dola të lexoj eulogjinë për poetin Pastel Zuko, që u nda prej nesh kaq i ri, të pranishmit në ceremoni filluan të kukurisen pa e nisur unë mirë fjalën. Duke qenë i vdekuri aty, dy hapa larg. Të shkretët, thamë ne, kanë nevojë të shfryhen në këto kohë stresi. Jo, jo, tha z. Shyti, këtë rol të lolos le t'ia japin ndonjë tjetri: unë madje po mendoj t'i kufizoj fare daljet në publik, se, kur zgërdhien të tjerët me mua, më ikën krejt humori. Mbase duhet të provosh të kundërtën, z. Shyti, sugjeruam ne: mbingarko fjalimet me shaka, lojëra fjalësh, qyfyre, kalambure, qesëndi, mahi, aluzione, rrokulla, madje fillo të qeshësh vetë, me të madhe, dhe shih se ç'do të ndodhë. Ashtu, edhe po të qeshin të tjerët, të paktën do të qeshin sepse do të të marrin seriozisht. Le pastaj, ç'më thonë se shkruhet për mua në *Facebook*: z. Shyti edhe këtë herë na la pa frymë, me artin e tij komedik të vetvetishëm. Dhe kjo, për një takim te rrethi postlakanian i Tiranës, ku kisha folur gjatë për Frojdin

e dëbuar nga eposi: ku është arti komedik këtu?

Rrjetet sociale i kanë marrë njerëzit më qafë, thamë ne, aq sa tani nuk reagojnë dot ndryshe, përveçse duke hapur dhëmbët. Por këtë duhet ta marrësh si shenjë interesimi, z. Shyti, shtuam ne: publiku ende reason ndaj teje dhe sot aftësia për të argëtuar turmat mbahet si shenjë inteligjence: këtë edhe ti vetë e ke argumentuar njëherë, më duket se në Fushë-Krujë. Unë nuk kam punë me turmat, tha z. Shyti; unë u flas gjithnjë individëve, edhe kur këta qëllon të mblidhen bashkë. Shumë të forta i ke këto, z. Shyti, thamë ne.

Z. SHYTI S'E HEQ DOT QAFE NARRATIVËN ZERO

Më fal se po të thom, Shyti, tha Lluka, mësues letërsie në shkollën 8-vjeçare përbri, beqar, akuarelist, pak okultist dhe astrolog në kohën e lirë; arsyeja që ti ke dështuar, deri më tash, është se ti nuk ke një narrativë tënden. Me këto fjalë, Lluka nxori një faqore që kish parë ditë më të mira, hoqi një gllënjë, pastaj ia zgjati edhe zotit Shyti. Ja, ma thuaj ti më mirë, vazhdoi Lluka: cila është narrativa jote?

Do të të thoja që për mua janë shkruar dy libra, së shpejti del edhe një i tretë, tha z. Shyti, spekulativ. Por ti nuk do të më kuptoje dot, edhe pse je i letërsisë. Çfarë ke parasysh me narrativë ti, tamam? Po ja, tha Lluka, siç tregojnë për Robert Alimerkon, pllakatistin e kohës së Xhaxhit, që kur ishte në burg, i mbushte muret me portretet e udhëheqjes, të cilat pastaj vinin dhe ia fshinin rojet, duke u rënë sipër me gëlqere. Ose për rapsodin Arban Ndoja, për të cilin të gjithë kujtonin se ishte virgjineshë. Ose për gazetarin Arafat Goga, për të cilin u tha se e la të shoqen në bixhoz, kur në fakt ishte e shoqja që e kish lënë, edhe pse jo në bixhoz. Për këto lloj narrativash e kam fjalën, Shyti, tha Lluka dhe hoqi një gllënjë tjetër nga faqorja. Po ti vetë ç'narrativë ke? - pyeti Shyti. Që vuan nga konjunktiviti? Apo që nuk të punon teleskopi? Unë kam qenë ca kohë i shtruar në psikiatri, u përgjigj Lluka; te kronikët. Unë jam ai që nuk rregullohet më. Jam ai me një bulon mangët.

Jam ai që "s'i paske pi ilaçet sot, plako". Ashtu edhe arrij t'ia shes horoskopin tim dy gazetave të përditshme dhe katër portaleve. Astrologu i çmendur godet sërish në shenjë, bla-bla-bla! Ndërsa për ty, Shyti, kur bie fjala me njerëzit më të rrallë, thonë, ah, z. Shyti, po, ai tipi kot që rri atje te kafja. Por të rrih në kafe s'është narrativë - e shumta është hyrje për një narrativë. Prolog. Për shembull

- E ke parasysh atë Shytin që rri gjithnjë te kafja? E paskan arrestuar për shfrytëzim prostitucioni... Në këtë kuptim. Duhet një shembje, një shkëputje, një frakturë, një çarje në continuum, e tillë që ta bëjë tjetrin të pyesë: po pastaj? Se ti, Shyti, vazhdoi Lluka, mund të shkosh edhe të përrallisësh në televizion, por vetëm për të luajtur rolin zero; të personit që nuk i ka ndodhur asgjë. Po atë që unë paskam dështuar, nga e nxore? - Pyeti z. Shyti. Me çfarë e mat dështimin e tjetrit ti? Po rri, o Shyti, tha Lluka, me tonin e kujt nuk po e kuptojnë: Jeta jote është e hekurosur, si pantallonat e oficerit. Autostradë pa kthesa është. Ja, thuajti vëllait, ta ka shuar ty kurrë ndonjë baxhellë cigaren në kërtizë, si mua?

Dhe këtu Lluka tërhoqi këmbëshën lart dhe shfaqti palën e hollë të barkut, me një vurratë të rrumbullakët mavi, mu rrëzë kërtizës së kërcyer. Jo, pranoi z. Shyti - kërtizës sime kjo nuk i ka ndodhur kurrë. Hë pra, tha Lluka, këtu ta kam llafin. Që ty kërtizë nuk të është rrezikuar kurrë...

Ç'më ngatërroon kot me histori kërtizash e lavresh! - u nxeh z. Shyti. Meqë e zure në gojë narrativën, më lër të ta shpjegoj një herë e mirë: edhe të mos kesh narrativë, është narrativë. Ja, merr dy boksierë që ndeshen mes tyre për titullin - të dy me narrativa për t'ua pasur zili: njëri i hyri sportit për t'i shpëtuar drogës, tjetri u kthye në ring për të shlyer borxhet. Të dy me autobiografi të botuara.

Merr edhe gjyqtarin, burrë i leshtë, pater familias, që nuk ka narrativë. Por ndeshja e boksit pa gjyqtarin nuk bëhet dot. Prandaj edhe narrativa e këtij, po të duam, është që ky e bën ndeshjen të ndodhë - çfarë do tjetër ti? Sofizma, sofizma, tha Lluka. Teorira sistemesh. Kur them narrativë, unë kam parasysh, fjala vjen, që gjyqtarin ta kenë kërcënuar me jetë, për ta shitur ndeshjen. Ose që njëri nga boksierët të nxehet dhe t'ia thejë turinjtë këtij gjyqtarit tënd...

Që pastaj për të të thonë: ah, ai që shiti atë ndeshjen dhe e rrasën pastaj brenda; ose ah, i vetmi gjyqtar boksi që e humbi vetë ndeshjen. Z. Shyti e nxori frymën me zhurmë, si autobus që frenon. Më thuaj, pra, o mik, çfarë u dashka të bëj, që të kem edhe unë një narrativë sipas Llukës? Filloje me mua, tha Lluka. Mu këtu ku jemi. Më godit fort me grusht, meqë fole për boksin: ti je Migjeni, unë jam mali që s'bëzan! Ti je Marshi i Barabbajt, unë jam Poema e Mjerimit. M'i zberthe vargjet si lidhëset e këpucëve të Van Gogen-it, më dëbo këmbëzbathur në mëhallat e botës! Njerëzit do të thonë: ja z. Shyti, ai që rrahu atë akuarelistin e shkretë, atë astrologun me dy pare shpirt, atë Llukën a si i thonë. Në mes të ditës, kushedi pse. Çfarë do t'i ketë thënë Lluka, që e detyroi të dalë nga roli... Z. Shyti tundti kokën, i pezmatuar. S'më the, gjë, o Lluka: kjo trapë do të jetë narrativa jote, jo imja. Kështu do t'i shpëtoj dështimit unë, duke më pranuar ti në deliret e tua? Unë jam Poema e Mjerimit, thotë! -murmuriti z. Shyti, gjithë mëri me Llukën. Ç'na gjeti, o Fate, tha duke u kthyer me fytyrë nga banaku, për pak simpati; por Fatja nuk ishte aty.



Mora parasysh se ai edhe mund të lëndohej në sedër. Megjithatë, i kërkova, madje pa përdorur ndonjë nga ato shprehjet e thjeshta të mirësjelljes, të përqendrohej mirë dhe t'i kthehej historisë nga fillimi. Ishte e shtunë paradite, që do të thoshte se kohën e kishim të ngeshme dhe gjendeshim në dhomën e ndenjjes në shtëpinë time, ku nuk do të vinte askush për të na e ndërprerë bisedën. Ai më përfshiu fluturimthi me një vështrim të çuditur. Ndoshta kishte edhe pak trembje në vështrimin e tij.

- Nuk kuptova asgjë, - shtova ftohtë. - Nuk kuptova asgjë prej gjëje.

- Keni të drejtë, - m'u përgjig ai shpejt e shpejt duke shtrembëruar fytyrën me njëfarë keqardhjeje misterioze. Ai sikur ishte gati të më kërkonte falje pse po ma merrte pa të drejtë ditën time të pushimit. Ose sikur po më lutej ta mirëkuptoja për rrëmujën që kishte në kokë. Nuk ishte i mësuar me biseda të tilla. Ose ndoshta ishte keqardhje për veten e vet pse ishte katandisur kështu.

Ose le të themi se ky ishte kuptimi që i dhashë unë ngërdheshjes së shtrirë për së gjeri në fytyrën e tij të rrumbullakët e të tultë si bukë e grunjte. Qysh herën e parë kur isha njohur me të, fytyra e tij më kishte ngjarë menjëherë me atë bukën e grunjte që gatuante dikur nëna ime të dielave. Ndoshta edhe dritat kishin ndikuar në përfytyrimin tim. Dhe nuk do të ndahej kjo përshtypje.

Takimi ynë i parë kishte ndodhur një mbrëmje vonë, afër mesnatës. Unë po dilja nga një emision i drejtpërdrejtë me Patrick Poivre d'Arvor në një nga televizionet kryesore franceze. Kisha qenë për afro dy orë në një studio të ndriçuar krejt ndryshe nga mjediset e mia të zakonshme të punës apo të çlodhjes. Ai po më priste në buzë të rrugës, aty ku përzihej ndriçimi i ardhur nga hollit i ndërtesës së televizionit me ndriçimin e jashtëm të trotuarit. Sytë e mi po përpëliteshin ende në përpjekjen për t'u përshtatur me ndryshimin e dritës.

Dy rojat e sigurisë në hyrje të televizionit e kishin vënë re qysh herët atë burrë të vetmuar rreth të pesëdhjetave, që ishte ngulur papritur përballë derës rrotulluese. Pas pak ata i kishin lejuar vetes ta merrnin në pyetje dhe ai u kishte treguar pa ndonjë kundërshtim, madje me një qetësi të madhe, se po priste të takohej me mua, duke përmendur fillimisht emrin, mandej, për t'u siguruar që rojat do ta kuptonin për kë ishte fjala, kishte përmendur edhe funksionin tim. Keni lënë takim? Jo. Ata ishin shqetësuar pak. Edhe pse në studiot e tyre isha i ftuar si shkrimtar, për dy rojat e sigurisë në përditshmërinë time unë isha ambasador. Për më tepër ambasador i një vendi, i cili sapo kishte dalë nga një regjim krejt i mbyllur komunist, fakt ky që në kokën e dy rojave, përveçse "regjim i dhunshëm", përkthehej edhe "regjim enigmatik". Ata nuk dinin ç'të bënin. Burri i panjohur priste në trotuar, pa bërë asgjë të qortueshme në drejtim të objektit që ata mbronin. Nuk kishin asnjë të drejtë të ndërhyjnë. Mund t'i kërkonin të largohej, por kjo nuk ishte zgjidhja. Ai do të shtyhej pak më tutje, qoftë edhe në trotuarin përballë e përsëri ta mbante nën vëzhgim derën nga do të dilte ambasadori. Ose të lajmëronin policinë, duke shpjeguar edhe rrethanat e dyshimit të tyre. Kështu do të bënin. Por më parë vendosën të vinin në dijeni shoferin tim, i cili priste, si zakonisht, pak më tutje, brenda në veturë.

Shoferit tim, të cilit i binte gjithë kohën vend e pa vend një kabanë alarmi lidhur me rreziqet që më kërcënonin mua, shenja e dhënë nga rojat e sigurisë të televizionit i gjëmoi sakaq si bubullimë. Ai kishte futur dorën e djathtë nën setër duke përngjasuar mbajtjen e një revolveri dhe ishte afruar pa ngurrim tek i panjohuri. Pa i rënë rrotull e rrotull, e kishte pyetur kush ishte. Frëngjishtja e sakatosur e bënte të dukej edhe më i tendosur, më kërcënues. Me të marrë vesh se tjetri ishte shqiptar nga Shkupi, por që jetonte prej shumë kohësh në Paris, ai e kishte vazhduar bisedën në shqip. Por pa u qetësuar menjëherë. Dy rojat e televizionit, të kujdesshëm për të qëndruar brenda caqeve të ligjshme të detyrës, ishin tërhequr pak hapa nën hijen e strehës së zgjatur përmbi hyrjen e ndërtesës, për të qenë, sido që të vinte puna, në territorin e tyre. Ata e dinin se, së bashku me ta, takimin e shoferit tim me të panjohurin po e ndiqnin edhe dy kamera sigurie, të cilave nuk do t'u shpëtonte asnjë hollësi. Edhe në shqip shoferi im kishte shkëmbyer fare pak fjalë me të panjohurin.

Dy rojat e televizionit kishin mbetur pa gojë. Shoferi im po e kontrollonte të panjohurin për armë. Ai jo vetëm nuk e kishte një të drejtë të tillë, por as nuk dinte ta bënte një punë të tillë. Dukej qartë që nuk ishte i stërvitur. Nga ana e vet, i panjohuri, gjithnjë i qetë, nuk kishte dhënë asnjë shenjë kundërshtimi. Dy rojat e sigurisë të televizionit do të kishin dashur ta ndihmonin shoferin tim, por ata, si punonjës të një policie private, do të shkelnin ligjin po t'i bënin një kontroll të tillë një kalimtar në trotuar. Kamerat e sigurisë ishin aty, mbi kokën e tyre. Ata nuk mund ta largonin dyshimin se i panjohuri i ishte bindur aq lehtësisht urdhrit të shoferit tim për të ngritur duart lart pikërisht pse kishte pikasur që ai

fragment nga novela

FAJTORI

Nga Besnik
Mustafaj

nuk ishte profesionist dhe nuk do ta gjente armën në trupin e tij. Në rast se do t'i ndodhte gjë ambasadorit në dalje nga emisioni, dy rojat, edhe pse polici private, do të ishin në një mënyrë a në një tjetër përgjegjës para ligjit. Dreq o punë! Si të bënin? Për më keq, ishte edhe mesnatë. Rruga ishte krejt e zbrazur. Dy rojat po e shihnin sakaq veten në hallin më të madh të jetës së tyre. Ata nuk ishin të përgatitur për ngarkesa të tilla psikologjike.

Në këtë çast dola më në fund unë i shoqëruar nga asistentja e Patrick Poivre d'Arvor. Shoferi im, i cili nuk e kishte përfunduar kontrollin për armë, shtrëngoi instinktivisht me të dy krahët trupin e të panjohurit, në mënyrë që duart e tij të pengoheshin për të vepruar. Dy rojat e sigurisë të televizionit më dolën rrëmbimthi përpara, për të mbuluar me trupat e tyre pamjen që mund të kishte i panjohuri në drejtimin tim. Unë nuk po kuptoja asgjë. Gjithçka po lëvizte rrotull meje si në një sekuençë filmi. Ktheva vështrimin nga asistentja e drejtuesit të emisionit, një vajzë e re, e imët, prej së cilës, kuptohet, nuk mund të prisja asnjë ndihmë në ato rrethana. Edhe ajo kishte ca sy të prishur nga një frikë e papritur. Kjo rrëmujë e vogël, megjithatë, nuk zgjati. I panjohuri më thirri në emër. Pa asnjë titull e madje edhe pa mbiemrin. Siç do t'i lejohej vetëm dikujt që më njihje mirë e që ia kisha dhënë medeoemos unë vetë një afërsi të tillë. Unë isha ambasador dhe ne gjendeshim në Paris, ku ambasadori (Shkëlqesia) qëndron zakonisht në një lartësi protokollare vështirë të arritshme nga të tjerët. Unë, që nuk e dija ende ç'po ndodhte, për më tepër me sytë që po mësoheshin fort ngadalë me ndryshimin e ndriçimit dhe, sidomos, pa ndonjë refleks instinktiv rreziku, iu përgjigja menjëherë thirrjes me një ngritje dore, sipas meje për ta përsëritur, por edhe për t'i thënë se nuk isha shumë i gatshëm për ta takuar. Dy rojat e sigurisë të televizionit bashkë me shoferin tim u shtendosën sakaq. Dëgjova asistenten e sjellshme të Patrick Poivre Arvor të më thoshte:

- Shkëlqesi, po nuk patët më nevojë për mua, më duhet t'ju them mirupafshim deri kur të botoni librin tjetër. Ishte nder dhe kënaqësi për mua.

- Po, sigurisht, sigurisht, zonzushë, - iu ktheva duke i zgjatur dorën. - Faleminderit për të gjitha. Mirupafshim!

- Edhe unë si shkrimtar do të doja t'ju takoja, - m'u drejtua në shqip i panjohuri. - E di që është shumë vonë. Por nuk ju mbaj gjatë. Ju jap fjalën e nderit. Sa t'ju shoh nga

afër, t'ju jap dorën dhe t'ju përsëritës.


- Patjetër, - iu përgjigja po në shqip.

Dy rojat e sigurisë të televizionit, duke parë shoferin tim që i hapi rrugën të panjohurit të afrohej drejt meje, u shtynë gjithashtu në të dyja anët e mia, por pa e fshehur pakënaqësinë. Ata do të kishin dashur që unë të hipja në veturën time dhe të largohesha menjëherë nga territori i tyre. Ata nuk mund të vepronin si asistentja e Patrick Poivre d'Arvor. Ata ishin dy burra me uniformë, ndoshta edhe të armatosur. Dashje pa dashjen e tyre, përgjegjësia e tyre në shërbim ishte e zgjeruar në këto rrethana për sa kohë unë do të isha brenda rrezes së shikimit të tyre. Për më keq që tani unë do të vazhdoja të flisja me të panjohurin në një gjuhë krejtësisht të pakuptueshme për ta, duke ua vështirësuar edhe më tej kryerjen e detyrës. Ata u përpoqën më kot ta afrojnë pranë vetes shoferin tim, në mënyrë që ai t'u përkthente çfarë po thuhej. Shoferi im ishte gjithashtu me mendjen rrëmujë. Edhe pse e njihje gjuhën, në të cilën po flisja unë me të panjohurin, ai nuk arrinte ta kuptonte çfarë po i dëgjonin veshët. Ky burrë me sjellje të pashembullt gjendej në fillim të mbrëmjes në shtëpinë e vet duke ngrënë darkë si zakonisht me të shoqen. Më kishte parë krejt rastësisht në televizor.

Me të mësuar se emisioni ishte në direkt, ai kishte thirrur me telefon një taksit dhe, pa i dhënë ndonjë shpjegim të qartë së shoqes, kishte rendur të më priste në dalje me shpresën se do të më shihte nga afër dhe, mundësisht, do të më shtrëngonte dorën. Nuk kishte asgjë të veçantë për të më thënë. As që kishte menduar se ky takim do të ndodhte pothuaj në mesnatë. Kisha përpara dikë, i cili kishte lënë darkën në mes dhe kishte rendur rrugëve të Parisit vetëm për të më parë nga afër. Ajo pjesa e lavdisë së kotë, të cilën edhe unë e kam me siguri në sedër si shumica e shkrimtarëve shqiptarë, do të duhej të përkëdhelej sadopak në një rrethanë të tillë. Nuk ndodhi kështu. Madje m'u duk krejt çmenduri ajo që kishte bërë ai burrë. Nuk ndjeva, megjithatë, ndonjë farë shtytjeje për ta vënë në dyshim sinqeritetin e tij. Nuk do të ishte e denjë, pra, ta lëndoja duke e shpërfillur. Sapo bëra një hap drejt tij dhe ai doli mirë në dritë përballë meje, fytyra e tij rrumbullake, e tultë, më ngjau me një nga ato bukët e grunjta që gatuante nëna ime të dielave, kur isha i vogël.

Teksa i shtrëngoja dorën, nuk u përmbajta dot pa i thënë, gjithsesi, se mund të kishte zgjedhur një kohë tjetër, herëdokur, por ditën dhe të vinte drejt në zyrë. Do të kisha qenë edhe më i ngeshëm për ta dëgjuar e për ta sajdisur me një kafe. Me sa dukej, jashtë vullnetit tim, unë gjithsesi e kisha paragjykuar. Po prisja që ai të më kërkonte patjetër diçka, domethënë, ai duhej të kishte ndonjë nevojë të rëndësishme, që lidhej me shërbimet e ambasadës ose me lidhjet e mia në Tiranë.

- Jo, - m'u përgjigja ai pa ngurrim, - jo. Në zyrë do të kisha takuar ambasadorin. Faleminderit. Nuk kam punë me ambasadorin. Unë doja të takoja vetëm shkrimtarin dhe mendova se nuk do të kisha rast tjetër më të mirë. Ju sapo keni dalë nga një bisedë e gjatë televizive për librat tuaj dhe, dashje pa dashje, jeni ende në lëkurën e shkrimtarit. Unë kështu mendova. - Pastaj u kujtua për rrethanat e pazakonshme, kur po më zinte rrugën dhe nxori, me majat e buzëve, pa ndonjë zell të madh, një kërkesë për ndjesë.



fragment nga romani

HIJE NË SHTRATIN E MORTIT

Nga Josif Papagjoni

Gruaja rrinte shtrirë mbi një dyshek të vjetër. Këmbët e kishte paksa të hapura. Lëkura e skuqur, blana-blana, ngjante si një shëgë e kalbur, e çarë. Prej saj kullonte dhimbje. Aroma e epshit të zbratur mashkullor vinte si e athët. Mbathje s'kishte, as sutjena. Veç një fustan që ia mbulonte disi trupin. Dhe "turpin". Turp e trup, të dy nën një cohë të hollë vere. Indi i plaguar rrëzë barkut nxinte shpërfillshëm, sikur të mos qe vendi ku burri bleronte, zjarrmonte, grindej e çmendej, por një tokë e djegur mbushur hi e blozë, ku ai qante në heshtje. Dhe përbetohej. Dhe shkulte flokët. Dhe ulërinte. Sepse kur atë vendth ia pështynin, ai qe dyfish i pështyrë. Dhe koka i merrte flakë, ndërsa një plumb lëvizte me shpejtësi para apo pas saj. Atëherë i lutej qiellit që mos ta shkallonte përfare nga trutë, sepse pa u hakmarrë nuk do të merrte dot frymë...

Ku je?...

Po, ku ishte ai?

Ca lëng i trashë e viskoz prej farës mashkullore po thahej tek ai vendth i qullët femre, moskokëçarës, ngjitur pas lëkurës së lëshuar dhe qimeve të buta. Nga cepi i syrit të burrit ra një pikë lot. Loti e lagu atë vendth. E dogji.

Ajo hapi sytë. Ku je?

Loti kishte marrë zjarr. Gruaja vuri dorën te vendthi mes shalëve. Gishti i dogji, por loti s'ishte më aty. Ishte bërë frymë, zjarrmi. Dhe trup e turp u bënë bashkë si mençuria me çmendurinë, si dëlirësia me ndotësinë, të cilat, në një natë të furishme dashurie i bashkonte përdëllimi, ndërsa në një tjetër natë, djegur në seks të egër e të pacipë, i ndante urrejtja. Veç një zhvendosje e gërmës 'r' te fjalët trup-turp dhe ato ndryshonin thelb: turpi mundues bëhej besim, ndërsa trupi i lakuriqtë bëhej tundim. I pari etje për shpagë, i dyti etje për dashuri.

Brrrrrrrrr...

Trupi i lakuriqtë i gruas lëvizi sikur ta pickonte grerëza. Sytë e saj u hapën tej mase. Ku je, klithi për herë të tretë ajo. Por imazhi qe tretur sakaq, lëpirë mes territ. Në jerm, syshqyer, ajo i fërkoj të dy pëllëmbët e squllura me lëngun e trashë të farës mashkullore. Mandej, habitshëm, qeshi. Një e qeshur si prej idioteje. Eja, shpirt! Buzët iu hapën sikur dikë të puthte. A ta puthnin. Në beft të sekondës u pre dysh dhe rihumbi në një kllapi terri dhe drite njëherësh. Asiherë trup e turp humbën cak. Koha rishtazi u zhbë.

Rrinin të dy bashkë asaj nate, strukur tek ajo grua, sybishtnuar, gërmuqur tëposhtë hapësirës së pafaj të mishit, aty ku femra dhuronte kënaqësi dhe falte jetë. Por kur syrin e rrëmbente sërish hiçi i bardhë i lëngut të heroinës që i kishin futur në deje, as trupi e as turpi s'kishin më peshë, aromë, ngjyrë e domethënie. Qenë veçse ca gërmadha në ndërmjetmen mes jetës dhe vdekjes. Trupi i saj ngjante njësoj si ato qytetet e rroposura, pa frymë njeriu, pas një tërmeti a bombardimi. Droga e tretur në gjakun e saj krijonte vegime asilloj, ku lumturia dhe kllapia fqinjëronin duke i bërë bashkë ëndrrën me

zhgëndrrën, kuajt krifëlëshuar në vrapin e çmendur lëndinave malore me kuajt e vdekur të fushave të luftës. Flokët i qenë hapërndarë si nga një shtjellë e hazdisur ere. Një tufë i kishte rënë mbi njëren faqe duke ia mbuluar syrin e djathtë, ndërsa syri i majtë, te cepi, kishte hapur një hullizë loti të porsatharë si ata lumenjtë e shkretëtirave që i gëlltiste rëra.

Jashtë qielli qe ngopur me avuj shiu. Mes tyre fluturonin ca urdhra. Gruaja nuk i dinte, por po t'i dinte me siguri ata urdhra do t'i ngjanin si turinj çakejsh e ujqerish, kur shihte ëndrra dhe çohoj vrik nga shtrati, apo ndoshta si minj të mëdhenj llagëmesh. Paçka se avionët fluturonin qiejve secili në linjën e vet, paçka se njerëz, kafshë e shpezë gjëllinin nën/në/mbi tokë e ujëra të ëmbla a të shëllirta, paçka se erërat shtilleshin secila shtegut të vet të horizonteve, diku përtej qiellit, tokës, erës dhe ujërave, futur thellë në ca fije të holla teli e qarqesh prej lënde kompakte, aty mbi cipën e një mikroçipi të satelitit me numër 666/999/CBAabc, grindeshin dy zëra:

Zëri II: Mbërritët?

Zëri I: Po.

Zëri II: Ju pa kush?

Zëri I: Askush.

Zëri II: Pse hyre në rrugën malore?

Zëri I: Përpara kishte patrullë policie, më lajmëroi Gimi në celular...

Zëri II: Derr... mos përmend emra!

Ra një heshtje e mbarsur me frikë. Nga lënda elektromagnetike dhe cipa e ndjeshme e mikroçipit, humbur barkut plot qarqe të satelitit 666/999/CBAabc, ndiheshin dy mushkëri që lëshonin frymë si me gulç: njëra hukaste, tjetra drithëronte. Heshtja zgjati. Në rrëmbat e saj kafshonte vdekja. Zoti asaj grime flinte. As ëngjëjt s'dëgjuan kurrëgjë se çfarë u tha. Valët eletromagnetike në lëndën e rrallë të atij mikroçipi, nxjerrë nga baltërat e Kinës, u rikthyen në zëra njerëzorë që diku nga një rrëzomë mali vinin. Rrëzoma ndodhej në pjesën veriore të një vendi rrëmujë, që quhej Shqipëri.



BOTOHET NË SPANJË ROMANI "VAJZAT E MJEGULLËS" I NAMIK DOKLES

Para pak ditësh, shtëpia botuese Ginger Ape Books & films, në Spanjë, botoi romanin "Vajzat e mjegullës" të shkrimtarit Namik Dokle. Romani është përkthyer nga María Rocés Gonzales, përkthyes tashmë shumë e njohur me përkthimet në spanjisht të veprave të Kadaresë, Fatos Kongolit, Bashkim Shehut etj.

Në shënimet përcjellëse për librin nga botuesi, shkruhet:

"Sikur të ishte një version komunist i legjendës mitologjike romake të "rëmbimit të Sabinave", vajzat e fshatit Bukojna rrëmbehen nga "aksioni", një mobilizim i urdhëruar nga partia, dyfish i rëndë për to, sepse ndodh para festës së Shën Gjergjit dhe ritualit të miqësismit, dashurisë e më pas edhe të martesave të tyre.


Nisur nga kjo ngjarje, vështrimi i protagonistit rrëfimtari të romanit, një djalë 13 vjeçar, evokon dekadën e viteve pesëdhjetë në krahinën e Gorës, të jetuar nën peshën e rëndë të diktaturës së Enver Hoxhës. Rini e prerë me sëpatë, ashtu si edhe vetë gjeografia, thaujse imagjinare, e Gorës, e ndarë nga fuqitë e mëdha në tre shtete: Shqipëria, Maqedonia dhe Serbia e kohës jugosllave. Falë romanit VAJZAT E MJEGULLËS, që përshfaqet si një baladë e mrekullueshme, në sytë e lexuesit Bukojna magjike e shtatë portave reziston përballë represionit të pamëshirshëm në kohërat e dashurisë për Stalinin.

Dhe kështu, në këtë enklavë të krijuar nga ngulimet mesjetare të heretikëve bogomilë dhe bashkimi i ardhësve vllahë, hebrenj dhe malësorë, dielli lind dy herë çdo ditë dhe hëna perendon dy herë çdo natë e Vdekja i përcjellë të vdekurit në varreza, mbështjellur me qefin prej mjegulle, përveç rastit, kur ajo i ka harruar apo nuk i ka gjetur ende, të

humbur në bjeshkët e Kallabakut, si Majka, plaka magjistare 300 vjeçare, bartësja besnike e traditës së fuqishme gojore ballkanike, e mbushur me mite, legjenda dhe këngë epike, që mbijetojnë ngulmueshëm në këtë roman."

NAMIK DOKLE

Las hijas de la niebla



Padre e bija en Okol, en el valle de Shala, Giuseppe Massani (1940)

TRADUCCIÓN: María Rocés González
TÍTULO ORIGINAL: Vajzat e mjegullës (2015)
EDITADO POR: 2Sicilias Reino Editorial y Botimet Toena
ISBN: 978-84-125482-0-4
D.L.: AL 3196-2022
THEMA: FRA



MESI I NATËS po afronte, ndërkohë ai ia kishte ngulur sytë akrepave në mur sikur kushedi çka do të ndodhte. Mbi tavolinë dukeshin libra nga Goethe, Chamisso, Bürger, Mary Shelley, Oscar Wilde, Stevenson, Bram Stoker, disa libra me përralla, libra studimorë mbi përrallat, disa fleta të shkarravitura, me shkronja dhe vizatime, një shishe e madhe konjak *Skënderbeu* dhe një gotë e vogël rakie, që e kishte blerë pranë Xhamisë Blu në Stamboll.

Jeta e tij gjithmonë kishte qenë një vetmi shqetësuese. Një vetmi që nuk i zhdukej as kur ndodhej mes njerëzish. Në ndeja dhe biseda me të tjerët, shpesh i binte "skllopa", e humbte kontaktin: nuk e shihte atë që kishte përpara, nuk e dëgjonte, nuk ishte aty. Shkonte në shpellën e tij, në shpellën e shpalljeve, aty ku i shpallëshin e ku i shkruante veprat. Nëçaste të tilla përhumbjeje, nuk kishte askënd për ta pickuar.

Ngado që shkonte, s'kishte rëndësi si vishej e si dukej, përderisa krahëve kishte hedhur mantelin e vetmisë. Çuditëj kur dëgjonte të tjerët që me aq lehtësi thoshin se e njihnin, përderisa ai ende s'kishte arritur ta njihje vetveten. Çdo mëngjes zgjohej i përtërirë dhe qeshte me veten e tij të një dite më parë. Ai ishte njeriu që ia nxirrte gjuhën hijes së vet, vetes së tij.

Aty, në shpellën e tij, kishte ëndrrat dhe ankthet e shpellarit të parë. Ishte një genie që dridhej nga mundësia për të qenë i mosqenë. Kishte frikë, kishte kureshtje. Ai ankth të cilin e përjetoi njëherë një fëmijë në një shpellë toskane, duke shikuar herë para, herë mbrapa, derisa, me zemrën që i dridhej si një trumcak, hodhi hapin drejt territ, sot bunte te ky person. E shqetësonte secila shpallje. Koka rritej e shpella zvogëlohej. Dora mblidhej, hapi hidhej. Le të dalë ku të dalë!

fragment nga libri

KËSULKUQJA

Nga Ag Apolloni

Në zemër të territ kishte vetëm një vijë drite që ndriçonte dorën e tij të djathtë, kur ideja si një avion në qiell linte trajektoren e zezë mbi fletën e bardhë.

Një erë e lehtë po ia trazonte fletët.

Ai nuk lëvizte, vetëm ora në mur bënte tik-tak, tik-tak, tik-tak. Kur akrepat u bashkuan, ra zilja. Meqë në atë ndërtesë, ai nuk ishte pijaneci i vetëm, mendoi se do ta ketë prekur dikush gabimisht, prandaj nuk lëvizti. Kur e pa që zilja s'po pushonte, mendoi se kjo ishte edhe një arsye më shumë për të mos e hapur. E çoi eks gotën, u gëzoi, përvoi mëngët dhe u nis drejt derës. Vuri syrin te "syri magjik", por andej dukej vetëm diçka e kaltër si sfungjer. Vendosi të mos e hapte. Mund të ishte ndonjë hajdut. Por, zilja nuk pushonte. Asnjë fqinj nuk po dilte. Duket se të gjithë kishin fjetur me pulat. Më në fund, e bëri zemrën gur, dhe e rrotulloi çelësin. Para tij u shfaq vajza me kapelë të kuqe, me një dyshek të mbledhur rrotull në shpinë dhe një saks me lule gojë-ujku në dorë.

- A është kjo shpella e Ujku?, - pyeti ajo duke buzëqeshur.

Ai e shikoi atë. Shikoi anash. S'po kuptonte asgjë.

- Kam dëgjuar se Ujku është i sëmurë, dhe

erdha të kujdesem për të, - tha ajo.

- Mendoj se..., - nisi të thoshte ai.

Ajo e la atë duke menduar dhe u fut brenda duke sjellë me vete të gjitha ngjyrat që i mungonin shpellës së tij. Dukej sikur një film bardhezi po kthehej në film me ngjyra. Ajo shkoi drejt e në sallon, sikur të kishte jetuar aty prej kohësh. Kur ai e mbylli derën dhe u kthye, ajo e kishte lënë lulen në ballkon, ishte ulur në divan dhe po shikonte dhomën përplot me libra në të gjitha anët. Libra të mëdhenj, të vegjël, me lidhje të forta, me lidhje të buta, kopertina njëngjyrëshe, kopertina shumëngjyrëshe, shumica vertikale, pjesa tjetër horizontale; emra që i kishte dëgjuar dhe emra që s'i kishte dëgjuar; tituj që i kishte lexuar dhe tituj që s'i kishte lexuar. Po ashtu, tavolina përplot libra, fletore, fletë të mëdha e të vogla, të shkruara e të shkarravitura.

- Uau, sa i rëndë!, - tha, duke mbajtur në duar *Malin magjik*.

- Ka edhe më të rëndë se ai, - tha dhe ia dha *Prufrokun*.

Ajo e mori si shaka, por ai thjesht ia bëri me dije se tashmë kishte hyrë në një botë ku fjalët ndryshonin kuptim. Dytësorja bëhej parësore.

Ajo shikoi për një copë herë librat rreth e rrotull.

- Duket si një shpellë magjike.

- Ashtu është, - tha ai. - Mjafton ta pish lëngun e librave dhe do ta vësh se si do të transformohesh.

- Do të ma bësh një listë se dua të transformohem. Cilin do të ma sugjerosh të parin?

- Si aktore që je, mendoj se duhet ta fillosh me *Paradoksin e aktorit*.

Ajo e shfletoi dhe e la prapë në raft.

- Tjetër?

- Pse, kaq shpejt e lexove?, - u tall ai.

- Ma hang'sh, - tha ajo.

Atij iu duk sikur i ra shuplakë. Nuk njiheshin aq sa për të përdorur fjalë të tilla. Ia nguli sytë, ndërsa ajo krejt e qetë po shëtiste gishtat nëpër rafte.

- Më fal, - tha ai, si për t'ia kujtuar asaj që duhej të kërkonte falje.

- Mos e merr si sharje, - ia ktheu ajo. - Ishte urim.

Ai nuk dinte a të qeshte a të çmendej me këtë vajzë.

- Gjithashtu, ta sugjeroj *Kandidin*, - i tha asaj sa për ta ndërruar rrjedhën e bisedës së sikletshme, dhe e mori librin nga rafti.

- E pse këtë?

- Sepse është Volteri, - ia preu shkurt, pa hyrë në sqarime të tjera.

- Cila është ideja e këtij libri?, - insistoi ajo.

- Parodizohet ideja e një filozofi gjerman që mendonte se çdo e keqe vjen për të mirë.

- Nuk mendoj se jam e keqe, dhe ndoshta nuk kam ardhë për mirë, - tha ajo duke e shfletuar librin.

- Nuk e mendova ashtu. Në fakt, e mendova se ishte sëmundja që më njohu me ty.

- Si?

- Po të isha shëndosh, nuk do të shkoja në park. Po të mos shkoja në park, s'do të të takoja ty.

- Tani je më mirë?

- Eh, aspak, por pak rëndësi ka kjo.

- Çka tjetër ka rëndësi, nëse jo shëndeti?

- Libri që po e shkruaj.


Ai shkoi në kuzhinë t'i bënte dy kafe. Ajo nisi të merrej me telefonin e saj. I shkruante dikujt dhe qeshte. Kujt i shkruante? Me çfarë po qeshte? Kushedi. Nuk ishte as kurioz, as xheloz për këtë. Nuk njiheshin ende.



ag apolloni

kësulëkuqja

përrallë për të rritur



botim i ri

SFINGA E GJALLË

Nga Rexhep Qosja

“Sfinga e gjallë”, si metadramë, Smanifeston të gjitha elementet e rëndësishme të poetikës së teatrit postmodern, përfshirë këtu intertekstin, pastishin, fragmentaritetin e karaktereve, teatralitetin, ironinë, paradoksin, kodin e dyfishtë etj. Interteksti e bën atë të shihet si nyje në një rrjet prej kryeveprash botërore; pastishi shfaq imitimin e modeleve të dramës bashkëkohore; fragmentariteti i karaktereve përjashton mundësinë e ndërtimit të biografive të personazheve, duke sugjeruar që personazhet të shihen si figura, jo si njerëz; teatraliteti shkaktohet nga gjuha metaforike dhe intelektualiste, si dhe nga disa veprime artificiale (veprimet e fqinjëve dhe vallëzimi); ironia në ballafaqim me temën e madhe prodhon parodinë; paradoksi zbulohet me fqinjët që janë një lloj kori që bën aminin, pa e kuptuar lutjen, ndërsa kodi i dyfishtë përmban dy linjat e dramës, një nënëpërmjet tensionit dramatik që shfaq kuptimi semantik, kurse tjetrën nëpërmjet provokimit intelektual që fsheh kuptimi semiotik.

Pasi teatri postmodernist, metadramatik, karakterizohet nga vënia e së vërtetës në pikëpyetje, duke u artikuluar përgjithësisht si dramë sugjeshive që ngre pyetje dhe si dramë që pastishizon tekstet dhe kanonet tradicionale, edhe Sfinga e gjallë refuzon të vërtetën kanunore, primitive dhe ndërton të vërtetën moderne, intelektuale.

Fragment nga libri:

AKTI I PARË

Një dhomë e madhe, dukshëm më e gjatë se e gjerë. Në murin e majtë është varur një pushkë e vjetër, kurse në murin e djathtë një pushkë e re. Kabili e mbulon me beze të zezë një bust, që qëndron në fund të dhomës. Kur e mbulon bustin, hyn Hinda, dukshëm e frikësuar. Kabili kthehet dhe e shikon me hidhërim.

Skena e parë

HINDA

Kuku për mua! Çka do të më gjejë! Më ka dalë djali duarsh! Nuk më rri natën në shtëpi! Nuk e shoh kur del, as kur vjen! Nuk e di ku ka shkuar sonte! Kuku për mua!

KABILI
Në mos di ti, e di ai vetë.

HINDA

E di ai, e di ti, por duhet ta di edhe unë; aq më takon në këtë shtëpi.

KABILI

Ndeze një pishë të madhe, dil rrugëve dhe oborreve, lype qosheve dhe dhomave, e diku mund të ketë hyrë! I kanë dalë qimet e burrërisë, do të dijë çfarë burri do të jetë!

HINDA

E ke fjalën e rëndë, më të rëndë se gurët e bjeshkës!
Dhe kurrë të lehtë s'e ke pasur!

KABILI

Prej se ke ardhur në këtë shtëpi, vetëm kujën tënde e dëgjoj! Kur do të pushosh një herë?!

HINDA

(duke qarë)
Kurrë nuk do të pushoj!

KABILI

(pisket)
Pusho! Pusho!

HINDA

Mos bërtit me të madhe se po dëgjojnë fqinjët dhe thonë se ke luajtur mendsh!

KABILI


Prej tyre të ruhem dhe mos të flas siç dua?! E ata kur bërtasin a i dëgjojmë këtu?

HINDA

Ata s'dëgjohej asnjëherë.

KABILI

I ke futur veshët në lesh, nuk dëgjon asgjë, nuk sheh asgjë, nuk do të dish asgjë; kënaqesh me bukën e gojës dhe me rrobat e trupit...



Të flasësh për romanet më duket temë shumë e gjerë dhe e përgjithshme për të filluar, prandaj po e bëj më konkrete: romancierët. Ato janë të dukshëm dhe të prekshëm, dhe për këtë arsye është më e lehtë të flasësh për ta. Ka përjashtime, sigurisht, por nga ajo që kam parë, shumica e romancierëve s'mund të quhen të dashur dhe të paanshëm. Nuk janë as nga ata që normalisht do të shiheshin si modele të mira: prirjen të jenë të pazakonshëm, kurse mënyra e jetesës dhe sjellja e përgjithshme është e çuditshme. Gati të gjithë (hamendësoj nëntëdhjetë e dy për qind, duke përfshirë edhe veten) jetojnë me bindjen e pashprehur se "unë jam në rrugën e duhur, ndërsa të gjithë shkrimtarët e tjerë janë në rrugën e gabuar". Dyshoj se shumë prej nesh do të dëshironin të kishin kontakte me njerëz të tillë, qofshin fqinj apo, Zot na ruaj, miq.

Kur dëgjoj se dy shkrimtarë janë shokë të mirë, prirem të mos e besoj shumë. Sigurisht, mendoj se miqësi të tilla mund të ndodhin, por një miqësi vërtet e ngushtë e këtij lloji s'mund të zgjasë shumë. Shkrimtarët janë në thelb një racë egoiste, krenare dhe shumë konkurruese. Vendosi dy prej tyre në të njëjtën dhomë dhe rezultati, më shumë gjasa, do të jetë zhgënjyes. Më besoni, kam qenë shumë herë në një situatë të tillë.

Një shembull i famshëm ishte darka e vitit 1922 në Paris që bëri bashkë Marsel Prustin dhe Xhejms Xhojsin. Ishin ulur afër njëri-tjetrit dhe të gjithë mbajtën frymën për të dëgjuar se çfarë do të thoshin dy personalitete të mëdha të letërsisë së shekullit të 20-të. Megjithatë, në fund pritshmëritë e të gjithëve dolën huq, sepse të rrallë folën me njëri-tjetrin. Mendoj se vetëvlerësimi ishte një pengesë shumë e madhe për t'u kapërcyer nga të dy.

Haruki Murakami

ROMANCIERËT JANË BUJARË ME SHKRIMTARËT E RINJ

Përktheu nga anglishtja Granit Zela

Libri më i fundit i autorit japonez Haruki Murakami, "Me zanatin romancier", (Bond Street Books), përshkruan se si është të jesh shkrimtar. Për më shumë se katër dekada, Murakami ka fituar vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare për romanet dhe tregimet. Veprat më të shitura të shkrimtarit 73-vjeçar janë përkthyer në më shumë se 50 gjuhë, janë përshtatur në filma dhe kanë krijuar shumë adhurues në mbarë botën. Në këtë libër Murakami tregon për karrierën si shkrimtar, hulumton se çfarë nevojitet të qenë romancier dhe pse thënia "kushdo mund të shkruajë një roman" nuk është kritikë nënvlerësuese, por lavdërim. Shkrimi u botua në "The Globe and Mail", 27 tetor 2022.

Megjithatë, nëse flasim për qëndrime përjashtuese, për instinktin e ruajtjes së territoreve që kanë bashkësitë e prifesiobëve të ndryshme, kam përshtypjen se pak prej tyre janë aq bujar dhe mikpritës sa romancierët, nëse janë të tillë. Në të vërtetë, mendoj se ky mund të jetë një nga virtytet e pakta që zotërojnë

romancierët.

Më lejoni të jem pak më konkret.

Le të hamendësojmë sikur një romancier i bekuar me një zë të mirë bën debutimin si këngëtar, ose një romancier me aftësi për art që ekspozon piktura. Pa dyshim, do të përballëshin me mospranim, madje edhe me tallje. Kritikët e artit do ta


qeshnin me të madhe. "Më mirë, merru me atë që di!" do ta përqeshnin disa prej tyre. Të tjerë dot thërrisnin: "Një shfaqje amatore, s'ka as aftësi dhe as talent". Këngëtarët dhe artistët profesionistë ka të ngjarë ta presin shumë ftohtë. Komentet madje mund të bëhen me qëllim të keq. Në çdo rast, një përhëndetje nxitëse "Mirë se erdhe në klub!" do të ishte e rrallë në të dyja rastet. Nëse ofrohej një pritje e ngrohtë, ajo do të ishte e rrallë dhe në një mjedis shumë të të kufizuar.

Krahas letërsisë që shkruaj, kam botuar edhe përkthime të letërsisë amerikane për 30 vjet me radhë, por në fillim (dhe ndoshta edhe tani) jam marrë në pyetje nga profesionistët të fushës së pse e bëja. "Përkthimi letrar nuk është për amatorë", bërtiste një kor zërash. "Shkrimtarët që provojnë dorën në përkthime një kokëçarje e vërtetë".

Pak a shumë kështu më ndodhi edhe kur botova librin "Metroja", u përballa me kritika të ashpra të shkrimtarëve profesionistë të letërsisë artistike: "një shfaqje e padijes për rregullat bazë të letërsisë artistike"; "të bën të përlolesh, jo shaka"; "vepër diletanti". Unë nuk kisha provuar të shkruaja libër joletrar; përkundrazi, kisha provuar të krijoja një vepër që s'kishte zhanër të përcaktuar e cila merrej me lëndë "joletrare". Megjithatë, u kisha shkelur bishtin e tigrave që ruajnë faltoren e shenjtë të letërsisë artistike dhe ata ishin të zemëruar. S'e dija që ekzistonin ose se kishte rregulla të rrepta që duheshin ndjekur për një libër të tillë, kështu që në fillim u hutova.

Sipas përvojës time, specialistët në një fushë të caktuar prirjen të rrudhin vetullat ndaj kujtdo që për çfarëdo arsye, u del përpara. Ashtu si qelizat e bardha të gjakut që mbrojnë trupin tonë nga pushtuesit e huaj, zmbropsin të gjitha trupat "e huaja". Ata që vazhdojnë të patrembur mund të zbulojnë, në fund, se autoritetet zbuten dhe se prania e tyre është miratuar në heshtje ... por të paktën në fillim rruga do të jetë e vështirë. Kam kuptuar se sa më e ngushtë dhe më e specializuar të jetë fusha, aq më krenarë prirjen të jenë autoritetet dhe aq më e fortë është antipatia e tyre ndaj të huajve.

Por, ç'mund të themi për rastin e kundërt, kur këngëtarë ose artistë, përkthyes ose shkrimtarë të veprave joletrare të nxjerrin një roman? A vrenjten në fytyrë romancierët? Nga përvoja ime, jo. Përkundrazi, ne priremi t'i shikojmë rezultatet pozitivisht dhe madje të nxisim autorët e tyre. Sigurisht, s'kam parë kurrë një romancier të njohur të shfryjë ndaj një shkrimtari të ri me një zemërim të llojit: "Çfarë drejtin mendon se po bën?!" S'kam dëgjuar as që ata të jenë fyer apo tallur apo t'u jetë punuar ndonjë rreng me keqdashje nga vëllezërit e tyre më me përvojë. Në vend të kësaj, ka të ngjarë që shkrimtarët e vjetër kureshtarë



t'i ftojnë të diskutojnë veprën e tyre dhe ndoshta t'u ofrojnë këshilla dhe t'i nxisin. Natyrisht, s'do të thotë që romancierët nuk thonë privatisht gjëra negative për romanet e para, por e bëjnë këtë edhe për veprat e njëri-tjetrit, gjatë gjithë kohës: në të vërtetë, kritika të tilla janë normë në të gjitha vendet e punës dhe s'kanë asnjë lidhje me dëshirën për të zbrapsur pushtuesit e jashtëm. Romancierët kanë shumë të meta, por kjo nuk është njëra prej tyre: si rregull, janë zemërgjerë me ata që shkelin në terrenin e tyre dhe i presin me bujari.

Pse ndodh kështu?

Mendoj se kam një ide shumë të mirë. Gjëja që i bën romanet të ndryshëm është se praktikisht çdokush mund ta shkruajë një të tillë nëse e ndan mendjen për ta bërë këtë. Një pianist ose një balerinë duhet të kalojë një proces trajnimit të vështirë dhe intensiv që nga fëmijëria derisa, më në fund, të jenë në gjendje të bëjnë debutimin e tyre; një artist duhet të jetë i pajisur me të paktën disa njohuri dhe aftësi themelore, për të mos përmendur veglat muzikore dhe njohuri të tjera. Për t'u bërë alpinist kërkohet fuqi e madhe fizike, stërvitje dhe guxim.

Një romancier aspirant, krejt ndryshe nga ata, ka nevojë vetëm për aftësinë themelore për të shkruar (shumica e njerëzve e kanë), një stilolaps, fletë të bardhë dhe aftësinë për të krijuar një histori e cila del si diçka që i ngjan një romani, nëse ka ndjekur një studim të specializuar është çështje tjetër. S'ka nevojë të studiosh letërsi në nivel universitar. Shkëlqyeshëm nëse ke marrë pjesë në një kurs të shkrimit krijues, por edhe nëse s'e ke ndjekur nuk ka problem.

Një person që boton për herë të parë mund të shkruajë një roman të mirë nëse është i bekuar me vetëm me pak talent. Kur unë fillova të shkruaja, për shembull, niveli i specializimit tim në letërsi ishte zero. Është e vërtetë, isha diplomuar për dramë dhe film në universitet, por kjo kishte ndodhur në fund të viteve 1960, dhe kisha bërë shumë mungesa në orët e mësimit. Mbaja flokë të gjatë, mjekër gjithë zhul, dhe sillesha lart e poshtë me rroba që nuk ishin të pastra. S'kisha plane të veçanta për t'u bërë shkrimtar, as nuk isha përpjekur të shkruaja diçka për t'u praktikuar derisa një ditë insekti më kafshoi papritur dhe shkrova romanin tim të parë (nëse doni ta quani kështu), "Dëgjo erën që këndon", i cili përfundoi duke fituar çmimin të një reviste letrare për shkrimtarë të rinj. Vazhdova rrugën për t'u bërë shkrimtar profesionist pa pasur nevojë të studioja zanatin. "A mund të bëhet vërtetë kështu?" pyesja veten duke tundur kokën me habi. Gjithçka dukej shumë e lehtë.

Kjo mund të zemërojë disa njerëz. Mund t'i dëgjoj duke u ankuar, "Çfarë drejtin di ti për letërsinë?" Thjesht po përpiqem të rrëfej ashtu siç ka ndodhur me mua. Njerëzit mund



të teorizojnë gjithçka që duan, por kur e provon vetë, sheh se gjinia e romanit është jashtëzakonisht e gjerë. Pikërisht kjo gjerësi është ajo që ndihmon për të krijuar forcën e tij mahnitëse, krejtësisht praktike. Në pozitën time, thënia "Çdokush mund të shkruajë një roman" nuk është kritikë nënvlerësuese, por lavdërim.

Me pak fjalë, bota e romancierit është si një arenë profesionistësh mundjeje që mirëpret këdo që ka dëshirë ta provojë. Hapësira ndërmjet litarëve anësorë është mjaft e madhe për t'u përshkuar, dhe duhet një hap për ta bërë hyrjen tënde më të lehtë. Ringu është i gjerë. Asnjë roje sigure s'ta bllokoi rrugën dhe arbitri nuk të ulëret që të largohesh. Mundësitë që janë tashmë aty, me fjalë të tjera, romancierët e njohur, e kanë pranuar si të pashmangshme shfaqjen tënde aty: "Pa merak, eja dhe bëj ndeshjen tënde më të mirë" është qëndrimi i tyre. Ringu është - si të them? - një mjedis i ajrosur, i lehtë, i rehatshëm, krejtësisht i qetë.

Ndërsa hyrja në ring mund të jetë e lehtë, megjithatë, të qëndrosh atje për një kohë të gjatë është e vështirë. Natyrisht, ne romancierët jemi të vetëdijshëm për këtë. Nuk është aq e vështirë të shkruash një roman, ndoshta edhe dy. Por është krejt tjetër gjë të vazhdosh të shkruash romane,

dhe krejt tjetër të nxjerrësh jetesën me shkrimet e tua, të mbijetosh. Kjo është një detyrë herkuliane. Është e drejtë të thuhet se pak ia dalin. Për ta arritur, njeriu ka nevojë për diçka të veçantë. Talenti është i rëndësishëm, natyrisht, dhe forca e karakterit. Si shumë gjëra në jetë, shansi dhe fati luajnë një rol të madh. Por duhet diçka tjetër, një lloj kualifikimi. Disa e kanë dhe disa jo. Disa e zotërojnë që nga lindja, ndërsa të tjerët luftojnë fort për ta fituar.

Nuk dihet shumë për këtë kualifikim, në të vërtetë, për të flitet rrallë në publik. Më së shumti ndodh ngaqë është praktikisht e pamundur ta përfytyrosh si pamje ose ta shprehësh me fjalë. Megjithatë, romancierët janë shumë të vetëdijshëm për rëndësinë e tij dhe se sa e nevojshme është për të nxënë zanatin - mund ta ndiejnë me intuitë.

Mendoj se kjo është arsyeja pse romancierët priren të jenë kaq bujarë me të huajt që hapin litarët dhe hyjnë në ring për të bërë debutimin e tyre romanor. "Futu brenda" do të thonë disa, ndërsa të tjerë duket se nuk e vënë re të riun në ring. Kur i sapoardhuri kërcen jashtë ose largohet vullnetarisht (shumica do të jenë në njërin nga këto dy kategori), të vjetrit do të thonë "Sa keq, more çun" ose "Të ectë mbarë!". Nëse dikush arrin të rrijë aty për një kohë

të gjatë, ata romancierë do të ndiejnë një respekt që është fituar me meritë. Ky respekt do të shfaqet me të drejtë dhe siç duhet (ose kështu do të doja të besoja unë).

Një tjetër arsye pse romancierët mund të jenë kaq bujar është se e kuptojnë që aktiviteti letrar nuk është një lojë me shumë zero. Me fjalë të tjera, fakti që një shkrimtar i ri shfaqet në ring gati asnjëherë s'do të thotë se dikush që është aty do të duhet të largohet. Në dukje, të paktën, një gjë e tillë nuk ndodh. Në këtë kuptim, bota e shkrimtarëve dhe bota e sportistëve profesionistë janë diametralisht të kundërta. Në sportet me profesionistë, kur një fillestar bëhet pjesë e ekipit, një lojtar i vjetër ose një lojtar tjetër i ri, i cili s'ka arritur të bëjë përshtypje, merr letrat e largimit ose zhvendoset në stolin e lojtarëve rezervë. S'ka asnjë paralele të tillë në botën letrare. Në të njëjtën mënyrë, kur një roman i ri shitet 100.000 kopje, kjo shifër nuk zbritet nga shitjet totale të veprave të tjera. Përkundrazi, një libër shumë i shitur nga një shkrimtar i ri mund t'i japë një shtysë të gjithë industrisë botuese.

Megjithatë, nëse e shohim më gjerë, përtej këtij krahasimi, edhe këtu ka një lloj përzgjedhjeje të natyrshme. Ringu mund të jetë i madh, por ende duket se ka një numër të mundshëm shkrimtarësh brenda tij. E tillë, të paktën, është përshtypja ime.

Në një mënyrë apo tjetër unë kam qenë romancier profesionist për më shumë se 35 vjet, deri në vitin 2015, kur e shkrova këtë libër. Shkurtimisht, kam qenë në ring gjatë gjithë asaj kohe, "duke nxjerrë bukën me letërsi", nëse përdorim shprehjen e vjetër. Kjo, mendoj, mund të shihet si një arritje e vërtetë në kuptimin e ngushtë të fjalës.

Gjatë kësaj kohe kam parë debutimin e shkrimtarëve të rinj. Shumë janë ngritur në qiell për veprat e tyre. Kanë marrë lëvdatat më të zjarrta nga kritika, janë vlerësuar me çmime të ndryshme letrare, është folur për ta nga publiku dhe kanë shitur shumë libra. Shpresa të ndritshme dukeshin në horizontin e të ardhmes së tyre. Me fjalë të tjera, ata janë ngjitur në ring nën dritat e prozhektorëve të vëmendjes, ku rreth tyre dëgjohej muzika e tyre tematike.


Megjithatë, sa nga ata shkrimtarë të rinj që debutuan 20 apo 30 vjet më parë janë aktivë si romancierë sot? Jo shumë. Shumë pak, për të qenë më të saktë. Pjesa tjetër kanë dalë në heshtje nga ringu. Në shumë raste, ndoshta në shumicën e tyre, ata janë tërhequr në fusha të tjera, pasi janë lodhur nga shkrimi i romaneve; ose ndoshta thjesht u doli të jetë zanat me shumë telashe. Po romanet e para që morën kaq shumë vëmendje? Ndoshta është e vështirë t'i gjejmë në librari sot. Megjithatë numri i mundshëm i romancierëve mund të jetë i pakufishëm, sasia e hapësirës në raft është me siguri e kufizuar!

“Ka aq shumë thurje, ndërthurje, mbi-dhe-nëthurje brenda thurimës së tekstit, mes reales, absurdes, imagjinatës vullkanike, onirikes, surreales dhe hiperreales, në një sfond filozofie marramendëse sa duhet se s’bën një lexim i dytë përpos atij përpirës për të shijuar çdo detaj”.

– Mira Meksi

ANDREAS DUSHI

në besë të
tatuazhit tënd



OnufriRoman